

ENTI RREGULLATOR I UJIT I SHQIPËRISË

Raporti i Performancës për Shoqëritë Ujësajellës Kanalizime

2022



Publikuar nga Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë (ERRU)
Rr. "VIKTOR EFTIMIU" Nd. 1, Njësia Administrative Nr.5, 1022
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel: +355 42 258 046
Faqja e internetit: www.erru.al
©Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Qershor 2023

PËRMBAJTJA

Shkurtime.....	2
Përmbledhje	3
Parathënie.....	10
1 Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca	13
1.1 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin	13
1.1.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)	14
1.1.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe i Kostos Totale	15
1.1.3 Norma e Arkëtimit	19
1.1.4 Niveli i Matjes	20
1.1.5 Efiçenca e Stafit	20
1.1.6 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë.....	21
1.1.7 Mbulimi me Shërbimet e FU dhe të KUN	21
1.1.8 Efiçenca e Energjisë	22
1.1.9 Ankesat e Klientëve	22
1.2 Rezultatet Financiare të Sektorit.....	23
1.2.1 Të Ardhurat nga Aktivitetet dhe Subvencionet.....	23
1.2.2 Investimet në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimit të Ujërave të Ndotura	26
1.3 Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave të Raportuara nga Shoqëritë UK	30
2 Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime	31
2.1 Ndarja sipas Grupimeve të Shoqërive UK.....	31
2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU	33
2.3 Treguesit Kryesorë të Performancës	34
2.3.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)	34
2.3.2 Mbulimi i Kostove O&M	39
2.3.3 Mbulimi i Kostove Totale	47
2.3.4 Norma e Arkëtimit	49
2.3.5 Niveli i Matjes	54
2.3.6 Efiçenca e Stafit	59
2.3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë.....	66
2.3.8 Mbulimi me Kanalizime	71
2.3.9 Efiçenca Energjisë.....	77
2.3.10 Ankesat e Klientëve	79
Renditja e Shoqërive UK Sipas Performancës	81
3 Reforma në Sektorin UK Sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022	81
4 Konkluzione dhe Rekomandime	84
5 Tema e Veçantë: Metodologjia e Miratimi të Tarifave të Shërbimeve UK dhe Ndikimi i Saj në Reformën në Sektor.....	85
6 Anekse: Të dhënat Kryesore të Sektorit	90

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjellës Kanalizime
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KM	Këshilli i Ministrave
QQ	Qeveria Qendrore
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUM	Agjencia Kombëtare Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmarking
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
TKP	Treguesit Kryesor të Performancës
SKP	Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
FU	Furnizimi me Ujë
KUN	Kanalizime të Ujërave të Ndotura
O&M	Operim dhe Mirëmbajtje
NAP	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme
NAK	Norma e Arkëtimit Korrente
UPA	Uji Pa të Ardhura
ERRE	Enti Rregullator i Energjisë
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Përmbledhje

Raporti i Performancës, si Instrument Analize, Informimi dhe Transparencë i Sektorit UK

Raporti i Performancës së sektorit UK hartuar nga ERRU tashmë për të 12-in vit radhazi është një instrument informimi dhe transparencë ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit dhe mbetet një dokument unik në sektor, sa i përket vlerësimit të performancës së sektorit në tërësi dhe të secilës shoqëri UK në veçanti. Raporti jep një pasqyrë të sektorit krahasuar me vitin paraardhës (benchmarking) dhe tendencën e performancës së sektorit të UK në Shqipëri. Raporti analizon performancën e të gjithë shoqërive UK për vitin 2022 duke nxjerrë në pah problematikat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomik të tyre. Me anë të këtij Raporti ERRU jep vlerësimin si institucion i pavarur në pozita asnjëse në lidhje me performancën e sektorit UK.

Viti 2022 është shoqëruar me ndryshime të rëndësishme në sektorin e ujit në Shqipëri, duke e agreguar sektorin UK në 15 shoqëri UK rajonale nga 58 shoqëri UK që ofrojnë shërbimin në 61 bashki të vendit, por duke qenë se ndryshimet në sektor si rezultat i reformës kanë ndodhur në fund të vitit 2022, për efekt krahasimi me vitin paraardhës, analiza e shoqërive në këtë raport është paraqitur referuar 58 shoqërive UK ekzistuese duke ruajtur të njëjtën strukturë krahasimi pasi efektet e ndryshimit fillojnë në janar të vitit 2023 dhe bilancet financiare të shoqërive për vitin 2022, janë mbyllur të veçanta për secilën prej tyre.

Treguesit Kryesorë të Performancës së Sektorit UK, Viti 2022

Treguesit Kryesorë të Performancës (TKP) për vitin 2022 për vlerësimin e performancës së shoqërive UK jepen në tabelën e mëposhtme nr.1.

Tabela nr.1. Treguesit Kryesorë të Performancës për Vitet 2021-2022

Nr.	Treguesit Kryesorë të Performancës	2021	2022	Tendenca	Performancë e Mirë (ERRU)
1	Uji Pa të Ardhura (%)	64.8	63.7	↗	30
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	103.4	90.3	↘	100
3	Mbulimi i Kostos Totale (%)	73.9	66.8	↘	80
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	92.3	97.3	↗	82
5	Norma e Arkëtimit Korrente(%)	77.6	81.4	↗	82
6	Niveli i Matjes (%)	80.7	82.8	↗	85
7	Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	4.9	4.73	↗	4/6/10
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	15.4	16.3	↗	18
9	Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	52	54.2	↗	75
10	Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	76.8	78	↗	n/a
11	Efiçenca e Energjisë FU (kwh/m ³)*	n/a	0.65	-	-
12	Ankesat e Klientëve (%)*	n/a	2.8	-	-

Burimi: ERRU

*Tregues të vendosur për tu marrë në analizë për herë të parë gjatë vitit 2022.

Treguesit Kryesorë të Performancës për vitin 2022 paraqiten të përmirësuar pothuajse në të gjithë treguesit me përjashtim të treguesve financiar Mbulimi i Kostove O&M dhe Totale të cilët kanë një rënie të ndjeshme përkatësisht me (-13.1%) dhe (-7.1%) dhe që lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK.

Kostot e O&M kanë një rritje me rreth 18% që ka ardhur kryesisht nga rritja e konsiderueshme e kostove të energjisë elektrike me rreth 40% dhe atyre të punës me rreth 8%, ndërsa Kostot Totale kanë një rritje me 14%, që vjen kryesisht nga rritja e kostove të amortizimit me 5%. Kjo situatë tregon se sektori ka akoma nevojë të subvencionohet nga qeveria qendrore pasi vetëm 13 shoqëri nga 58 arrijnë të mbulojnë 100% kostot e O&M.

Pjesa tjetër e TKP, të cilët lidhen direkt me rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe mirë-menaxhimit të shoqërive UK, janë përmirësuar për vitin 2022, përkatësisht : UPA me 1,1%, NAK me 3,8%, NAP me 5%, Niveli i Matjes me 2,1%, Mbulimi me FU me 1,2%, Mbulimi me KUN me 2,2% dhe Kohëzgjatja e FU nga 15,4 orë/ditë në 16.3 orë/ditë, si dhe i efikasitetit të stafit nga 4,9 që ishte në vitin paraardhës në 4.73 staf/1000 lidhje UK.

Treguesi “Eficienca e Stafit” në nivelin 4.73 punonjës për 1000 lidhje UK i cili përfshin vetëm punonjësit e vetë shoqërive, paraqitet i përmirësuar për vitin 2022 pasi numri i punonjësve është reduktuar me 101 punonjës ndërkohë që edhe numri i lidhjeve është rritur me 23,970 lidhje Ujë dhe 22,558 lidhje KUN, por kjo nuk ka influencuar pozitivisht në uljen e kostove të punës të cilat janë rritur me 8% si rezultat i ndryshimit të pagës minimale e cila ka ndryshuar dy herë brenda vitit 2022, përkatësisht në prill nga 30.000 lekë në 32.000 lekë dhe në shtator në 34.000 lekë. Theksohet fakti se Kostot e Punës zënë 43% të kostove të O&M të shoqërisë.

Mjaft pozitiv është fakti që treguesit e NAK dhe NAP të cilat lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë kanë patur një tendencë pozitive edhe në vitin 2022. Gjithashtu “Kohëzgjatjen e FU” në nivelin e 16.3 orë/ditë, paraqet një përmirësim të dukshëm me rreth 1 orë/ditë duke dhënë ndikim pozitiv në cilësinë e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve.

Treguesi “UPA” në nivelin e 63.7% edhe pse nga viti në vit vijon të ketë përmirësim të lehtë, përsëri mbetet në nivele shumë të larta dhe shumë larg objektivit të vendosur nga ERRU. Me trend pozitiv ndër vite paraqiten edhe Treguesit “Niveli i Matjes” 82.8% i cili lidhet me faturimin e saktë të konsumatorëve për sasinë e ujit që konsumojnë si dhe treguesit e “Mbulimit me FU dhe KUN”.

ERRU në përputhje me kërkesat e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK dhe të rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve i ka dhënë një rëndësi të veçantë përcaktimit dhe vlerësimit të TKP. Kjo është reflektuar edhe në metodologjinë e re të tarifave, ku cilësia e raportimit të të dhënave dhe arritja e objektivave të vendosura nga ERRU për realizimin e TKP janë lidhur direkt me vendimin për tarifën e propozuar nga shoqëritë UK. Në varësi të cilësisë së informacionit dhe realizimit të objektivave për TKP, ERRU aplikon korrigjime financiare (bonus ose penalizim) në tarifën që ajo aprovon përfundimisht për shoqëritë UK.

Bilanci Financiar i Sektorit UK

Performanca financiare e sektorit UK për vitet 2021 dhe 2022 (në 000 lekë) jepet në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme nr.2

Tabela nr.2. Performanca financiare e sektorit UK për vitet 2021 dhe 2022

Nr.	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022	Diferenca 2022/2021	
1	Kostot Operim & Mirëmbajtjes	9,660,482	11,394,237	1,733,754	18%
2	Kostot Kapitale	3,862,892	4,000,720	137,828	4%
3	Kostot Totale	13,523,374	15,394,956	1,871,582	14%
4	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	9,987,507	10,290,998	303,491	3%
5	Të Ardhurat nga Subvencionet	380,000	360,000	-20,000	-5%
6	Totali i të Ardhurave	10,367,507	10,650,998	283,491	3%
7	Mbulimi i Kostove O&M	107%	94%		-14%
8	Mbulimi i Kostove Totale	77%	69%		-8%

Burimi: ERRU

Për vitin 2022 janë realizuar 10 290 milion lekë të ardhura nga aktiviteti i shoqërive UK, të cilat krahasuar me vitin paraardhës janë rritur me 303 milion lekë.

Për vitin 2022 janë 13 shoqëri nga 58 shoqëri që operojnë në të gjithë vendin, të cilat i mbulojnë mbi 100% Kostot e O&M. Niveli i mbulimit të kostove të O&M, krahasuar me

vitin e mëparshëm ka pësuar rënie për të gjithë sektorin, ku për shoqëritë e Grupit të I-rë ka një rënie të konsiderueshme nga 113.2% në vitin 2021, në 96.4% në vitin 2022, për shoqëritë e Grupit të II-të nga 70.4% në 67.8%, dhe për shoqëritë e Grupit të III-të, një rënie më të lehtë nga 60.1% në 59.3%.

Të ardhurat nga aktiviteti kanë pësuar rritje për arsye se vëllimi i ujit të faturuar për vitin 2022, krahasuar me vitin 2021 është rritur me 2.8 milion m³ ujë. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes me rreth 24 mijë lidhje të reja të FU, me 23 mijë të numrit të lidhjeve KUN, si dhe rritjes së orëve të furnizimit me ujë.

Sektori me të ardhurat e gjeneruara për vitin 2022 arrin të mbulojë kostot e O&M në nivelin 90.3%. Në sektor janë akoma 45 shoqëri UK që nuk mbulojnë kostot e O&M (disa edhe nën 50%) dhe që janë subvencionuar nga qeveria qendrore.

Subvencionimi i Sektorit UK nga Qeveria Qendrore

Gjatë vitit 2022 qeveria qendrore, nëpërmjet AKUM ka shpërndarë 360 milion lekë subvencione që krahasuar me një vit më parë janë ulur me 20 milion lekë. Për këtë vit, subvencione kanë përfituar vetëm 12 shoqëritë UK Rajonale, të cilat kanë filluar procesin e riorganizimit me nga 30 milion lekë secila **me përjashtim të 3 shoqërive Rajonale të parashikuara në reformë, përkatësisht shoqëritë rajonale: UK Shkodër (Shkodër, Fushë Arrëz, Pukë, Vau Dejës, Malësi e Madhe), UK Tiranë (Tiranë, Kamëz, Vorë), dhe UK Vlorë, (Vlorë, Selenicë, Himarë), të cilat nuk e kanë përfunduar këtë proces brenda vitit 2022.** Kjo lidhet edhe me strategjinë e qeverisë qendrore e cila i ka dhënë prioritet me mbështetje financiare shoqërive UK të cilat janë bërë pjesë e reformës sipas VKM nr. 302. Sektori me të ardhurat e gjeneruara arrin të mbulojë kostot e O&M në nivelin 90.3%, ku vetëm 13 shoqëri UK arrijnë ti mbulojnë ato në masën 100%, ndërsa 4 shoqëri i mbulojnë mbi 90%. Ndërkohë, 10 shoqëri UK (në grupin e dytë dhe të tretë) nuk arrijnë të mbulojnë as 50% të kostove të O&M.

Destinacioni i subvencioneve të akorduara, ndryshe nga viti kaluar që ishte vetëm për energjinë, për vitin 2022 ka qenë **38.9% për mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 13.6% për tatim taksa, 4.8% për paga, 26.1% për energji elektrike, si dhe 16.7% si incentiva për performancë të mirë.** Këtë të fundit e kanë përfituar vetëm dy shoqëri UK Rajonale Korçë dhe Pogradec. **Ndërkohë nevoja reale për subvencione, për mbulimin e kostove O&M për të gjithë sektorin është 2 840 milion lekë, por, realisht janë shpërndarë 360 milion lekë që përbëjnë vetëm 12.7% të nevojës së sektorit për subvencione.**

Reforma në Sektorin UK dhe Sfida e Shoqërive në drejtim të unifikimit tarifor

Në maj 2022, KM miratoi vendimin nr. 302, "Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të FU dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të UN", që parashikon riorganizimin e sektorit nga 58 shoqëri UK në 15 Shoqëri UK Rajonale me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. VKM parashikon rajonalizimin e sektorit në baza vullnetare, por në shoqëritë rajonale 51% të totalit të aksioneve do të zotërohen nga QQ, ndërsa bashkitë përkatëse 49% të tyre.

Deri në fund të vitit 2022 janë krijuar 12 shoqëri UK Rajonale nga 15 të parashikuara sipas reformës dhe që përfshijnë 50 bashki. Shoqëritë e reja Rajonale të krijuara janë **UK Korçë, UK Pogradec, UK Durrës, UK Lezhë, UK Dibër, UK Kukës, UK Berat, UK Elbasan, UK Gjirokastër, UK Fier, UK Lushnje dhe UK Sarandë.** Mbeten akoma 11 bashki të cilat sipas parashikimeve të reformës në sektor do të jenë pjesë e 3 shoqërive UK Rajonale, përkatësisht: UK Shkodër (bashkitë Shkodër, Vau Dejës, Malësi e Madhe, Fushë Arrëz, Pukë) UK Tiranë (bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë) dhe UK Vlorë (bashkitë Vlorë, Selenicë, Himarë).

ERRU ka luajtur një rol proaktiv në procesin e zbatimit të reformës duke ndërmarrë vendimet e nevojshme në drejtim të licencave dhe tarifave të cilat i shërbejnë përshejtimit dhe ecurisë së këtij procesi. KKRR me vendimin Nr. 420, datë, 29.09.2022 "Për licencat dhe tarifën e shërbimit të operatorëve rajonalë UK në zbatim të reformës",

ka lehtësuar ecurinë e këtij procesi duke thjeshtësuar burokracinë e licencimit të përdorimit të tarifave nga shoqëritë rajonale deri në miratimin e propozimeve të reja pranë ERRU-së.

Një ndër sfidat kryesore me të cilën do të përballen shoqëritë UK Rajonale si rezultat i agregimit është **Unifikimi Tarifor**, pasi format rregullatore synojnë struktura tarifore drejt unifikimit të tyre në zonën përkatëse të shërbimit. Bashkimi i shoqërive UK të veçuara me performancë të mirë dhe të dobët në shoqëri rajonale si rezultat i ekonomisë së shkallës, rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe financiare, në rezultatin final pritet të sjellë zhvillim dhe rritje të performancës të sektorit UK. Për një pjesë të shoqërive të formuara rajonale tarifave janë të përafërta nga zona në zonë, si rrjedhojë unifikimi tarifor është i mundshëm për to në të gjithë zonën e shërbimit, prandaj ERRU do ta nxisë dhe do ta asistojë këtë proces për t'a lehtësuar drejt arritjes sa më parë të rezultateve pozitive të performancës financiare dhe rritjes së cilësisë së shërbimit.

Për disa shoqëri rajonale unifikimi tarifor paraqet problematika duke qenë se diferencat e tarifave aktuale ndërmjet zonave janë të mëdha, për shkak të kostove mjaft të ndryshme të operimit dhe të cilësisë së shërbimit në njësitë përbërëse të tyre. Unifikimi i tarifave për to mund të realizohet në bashkërendim të ngushtë në nivel strategjik me qeverinë qendrore dhe ERRU-në për të parashikuar një politikë të përshtatshme subvencionimi në vlerë dhe kohë, në mënyrë që unifikimi të bëhet gradualisht dhe i pranueshëm për konsumatorët. Një unifikim i sforcuar i tarifave në të gjithë zonën e shërbimit që sjell një rritje të menjëhershme të tyre në njësitë me tarifa relativisht të ulta, mund të sjellë reaksione të forta nga konsumatorët me pasojë ulje të normës së arkëtimit dhe ulje të aftësive likuiduese financiare të shoqërisë. Duke qenë se metodologjia ofron mundësinë e planifikimit tarifor me rritje graduale nga viti në vit, unifikimi i tyre rekomandohet të realizohet në dy faza, së pari unifikimin për ato njësi që kanë tarifë të përafërt dhe më pas gradualisht deri në unifikimin e plotë të tyre.

Licencimi i Shoqërive UK nga ERRU

Gjatë vitit 2022 procesi i licencimit të shoqërive UK nga ERRU ka vijuar normalisht, si për shoqëritë e agreguara në përputhje me vendimin nr.302, datë 11.05.2022 për rajonalizimin e tyre, edhe për shoqëritë e veçuara kur ka qenë e domosdoshme.

Pranë ERRU-së gjatë vitit 2022 kanë paraqitur kërkesën për licencim 20 shoqëri UK, nga të cilat 17 për rilicensim si shoqëri të paagreguara dhe 3 të riorganizuara si Shoqëri UK Rajonale. ERRU ka miratuar në total 17 licenca për shoqëri UK nga të cilat 15 shoqëri UK ekzistuese të parajonalizuara dhe 2 Shoqëri UK Rajonale, përkatësisht UK Korçë dhe UK Lezhë, ndërsa shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a nuk u pajis me licencë brenda vitit 2022 për mungesë dokumentacioni dhe pritet licencimi i saj në fillim të vitit 2023.

Deri në fund të vitit 2022 mbeten akoma 9 shoqëri UK pa licencë, konkretisht UK Tropojë, Klos, Rrogozhinë, Patos, Divjakë, Pustec, Përmet, Dropull dhe Libohovë, të cilat pritët të aplikojnë për licencim në përbërje të shoqërive të reja rajonale.

Miratimi i Tarifave të Reja për Shoqëritë UK

Gjatë vitit 2022, ERRU, ka shqyrtuar dhe ka marrë vendimet përfundimtare për tarifa të reja për 5 shoqëri UK ekzistuese (të parajonalizuara), përkatësisht UK Kukës, UK Konispol, UK Bulqizë, UK Durrës dhe UK Elbasan.

UK Bulqizë ka aplikuar pas një periudhe 10 vjeçare dhe me tarifave të miratuara synohet mbulimi 100% i kostove të O&M dhe amortizimit vjetor.

UK Kukës ka aplikuar për tarifa të reja duke përfshirë për herë të parë dhe tarifën fikse. Tarifave të reja të miratuara synojnë mbulimin 100% të kostove të O&M me objektiv kryesor përmirësimin e treguesit të normës së arkëtimit.

UK Konispol ka aplikuar për herë të parë pasi u licencua në dhjetor 2021, për të miratuar tarifave volumetrike vetëm për shërbimin e FU, pasi nuk ofron shërbim të KUN. Me tarifave të reja përmbushet kushti ligjor që shoqëria duhet të operojë me tarifa të rregulluara dhe miratuara nga ERRU.

UK Durrës ka aplikuar për të miratuar vetëm tarifat e shitjes së ujit me shumicë për UK Kurbin dhe UK Vorë, pasi pas krijimit të shoqërisë rajonale UK Durrës klientët e këtyre zonave nuk do të jenë më pjesë e zonës së saj të shërbimit.

UK Elbasan ka aplikuar për të miratuar tarifa të unifikuara për të gjithë zonën, pasi është bashkuar me Elbasanin fshat që më parë ka qenë shoqëri më vete duke synuar mbulimin e kostove të energjisë elektrike edhe pas rritjes së çmimit nga ERRE.

Efiçenca e Energjisë Elektrike, Sfidë e sektorit UK

Kosto e energjisë elektrike edhe për vitin 2022 mbetet zëri i dytë pas kostove të punës me peshën më të madhe në kostot O&M të shoqërive UK me rreth 34% të totalit të tyre. Gjatë vitit 2022 për shkak të krizës së energjisë elektrike u rrit çmimi për njësi i energjisë elektrike nga 11.5 lekë/kwh në 18.8 lekë/kwh, gjë që solli një rritje të kostove të energjisë elektrike në sektor me 40%, pavarësisht zvogëlimit të vëllimit të ujit të prodhuar në sektor me 2.68 milion m³ dhe sasisë së konsumit të energjisë elektrike me 6.7 milion KW. Për vetë natyrën specifike të sistemeve të furnizimit me ujë në UK Durrës, ndikimin kryesor në rritjen e kostove të energjisë e ka dhënë kjo shoqëri me një rritje rreth 37% të totalit të rritjes së kostove të energjisë elektrike të sektorit.

Për sa më sipër, si dhe faktit që sektori ka patur një rritje të orëve të furnizimit me ujë gjatë vitit 2022, konstatohet një tendencë pozitive në menaxhimin e konsumit të energjisë elektrike në sektor.

Në fund të viti 2022 rreth 45 shoqëri UK nuk arrijnë ti mbulojnë kostot O&M, si rrjedhojë detyrimet e prapambetura që shoqëritë kanë ndaj OSHEE-së vazhdojnë më tej të rriten. Detyrimet e shoqërive UK ndaj OSHEE në mbyllje të vitit 2022 rezultojnë rreth 14 miliard lekë ose (122.4 milion Euro). ERRU në studimin e saj të realizuar në vitin 2021 mbi efiçencën e energjisë konstatoi se qasja për zgjidhjen e kësaj problematike qëndron në rritjen e efiçencës së përdorimit të energjisë elektrike dhe të përmirësimit në tërësi të TKP-ve të shoqërive UK. Gjithsesi këto masa që duhet të ndërmerren nga shoqëritë UK dhe me planet e veprimit përkatëse, duhet të shoqërohen paralelisht me një plan të rritjes së tarifave dhe vazhdimin e subvencionimit të tyre të paktën për një periudhë tranzitore nga buxheti i shtetit.

Metodologjia e re e Vendosjes së Tarifave

Sipas metodologjisë së re të tarifave e cila ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2022, shoqëritë UK duhet të bazohen në objektivin e mbulimit të kostove për të përcaktuar se cilën metodë aplikimi do të duhet të zbatojnë Metodën “Kosto Plus” ose atë të “Çmimi Tavan”.

Metoda “**Kosto Plus**” zbatohet për shoqëritë që kanë për objektiv mbulimin deri në 100% të kostove O&M dhe për një periudhë rregullatore deri në 3 vite. Kuptohet, në këtë metodë nuk përfshihet në tarifat e reja përballimi i kostove financiare të nevojave për investime fizike në sistemet e FU dhe KUN.

Gjithsesi metoda presupozon vendosjen nga ERRU për shoqërinë UK të objektivave të përmirësimit të TKP, financiarë dhe të cilësisë së shërbimit, të cilat monitorohen dhe realizimi i tyre kushtëzon dhënien e një bonusi (incentive) ose të penalizimit në rast të mosrealizimit të tyre. Në këtë mënyrë, ERRU nxit shoqëritë UK të jenë më të përgjegjshme për të arritur objektivat që planifikohen.

Metoda “**Çmimi Tavan**” zbatohet për shoqëritë që mbulojnë kostot e O&M mbi 100% dhe planifikojnë edhe mbulimin pjesor ose total të nevojave për investime për një periudhë rregullatore 5 vjeçare. Kusht kryesor për aplikimin dhe justifikimin e tarifave të propozuara nga shoqëria UK është se aplikimi duhet të jetë i mbështetur detyrimisht me Plan Biznesi 5-vjeçar. Me këtë metodë nevojat për të ardhura llogariten duke patur parasysh kostot e pranuar të O&M (OPEX), kostot kapitale (CAPEX) dhe kostot e kthimit mbi kapitalin e investuar.

Në metodologjinë e re një rëndësi e veçantë i është kushtuar **ngritjes së sistemeve të informacionit dhe të saktësisë së të dhënave të raportuara nga shoqëritë UK pranë ERRU-së**, ku procesi i mbajtjes së të dhënave duhet të bazohet në dokumente që mund

të kontrollohen nga ERRU. Vlerësimi nga ERRU i saktësisë së të dhënave të raportuara shoqërohet sipas rastit me korigjimin financiar përkatës të tarifave të propozuara. Në të dy rastet e metodologjisë, ERRU, merr parasysh zbatimin e kriterit të përballeshmërisë së tarifave të vendosura prej saj.

Investimet në Sektorin UK

Investimet në sektorin UK për vitin 2022 nëpërmjet AKUM jepen në tabelën nr.3

Tabela nr.3. Investimet në Sektorin UK për vitin 2022

Nr.	Zërat	Vlera (në lekë pa TVSH-në)	Vlera (në % mbi totalin)
1	Totali i investimeve fizike	6,028,719,075	77.05%
2	Totali i Studim-Projekti-Supervizion punimesh	147,401,057	1.88%
3	Totali Financimi i huaj	994,321,882	12.71%
4	Totali Kosto Lokale	654,022,868	8.36%
5	Totali i Përgjithshëm(Pa TVSH)	7,824,464,882 Lekë (rreth 65 milion Euro)	

Burimi AKUM

Në total janë investuar **7,824,464,882 Lekë (ose rreth 65 milion Euro)**, nga të cilat **6,830,143,000 Lekë janë financuar nga Qeveria Shqiptare (rreth 87.3% të totalit) dhe 994,321,882 Lekë nga donatorët e huaj (rreth 12,7%)**.

Referuar tabelës vërehet se zëri i financimeve studim-projektim-supervizion punimesh përbën 1,88% të totalit të përgjithshëm. Kjo vlerë duhet të jetë ndërmjet 5%-20% të vlerës së totalit të investimeve fizike e kushtëzuar nga madhësia e vlerës së investimit si dhe kompleksitetit dhe vështirësisë inxhinjerike të zbatimit të tij. Kjo përqindje konsiderohet e ulët gjë e cila në mjaft raste mund të mbartë rrezikun e cënimit të cilësisë së hartimit të projektit, dhe të cilësisë së mbikëqyrjes së punimeve gjatë zbatimit të tij.

Shpërndarja e fondeve të disbursuara ka qenë e zhdrejtë nga 0% fonde për projektet e planifikuara në bashkinë Memaliaj deri në 10.35% fonde për projektet e planifikuara në bashkinë Mat. **Shoqëritë/bashkitë më të financuara gjatë vitit 2022 të shprehura në përqindje kundrejt fondit total, janë përkatësisht Mat (10,35%), Kolonjë (6,44%), Pogradec (5,81%), Dibër (5,71%), Durrës (5,46%), Kamëz (4,83%), Finiq (3,80%), dhe Kurbin (3,49%).**

Vlera e konsiderueshme e investimeve për këto shoqëri ka ardhur si rezultat i kompleksitetit të projektit për të zgjidhur përfundimisht problemet e FU në bashkitë përkatëse bazuar në planin strategjik të qeverisë shqiptare për FU 24 orë/ditë për qendrat urbane, edhe të nevojës në zonat që përgjithësisht kanë përfituar më pak investime, si bashkitë Dibër, Mat dhe Kolonjë. Përfituese kanë qenë edhe zonat me prioritet turizmin si Durrësi e Pogradeci, por edhe zonat ku projektet që po zhvillohen kanë impakt të lartë në mbulimin e popullsisë me shërbim si p.sh. në bashkinë Kamëz.

Theksohet fakti se në sektorin e UK financohen mjaft projekte, kryesisht në zona rurale, edhe nga agjencia tjetër zbatuese Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), të cilat nuk janë subjekt i këtij raporti. Në Aneks 16 jepet Tabela 54, e cila përmban të dhëna të plota për çdo shoqëri UK të bashkive përkatëse, ku përfshihen detaje të secilit projekt, autoritetin kontraktues, vlerën e financiar, si dhe periudhën e zbatimit të punimeve.

Renditja e Shoqërive UK Sipas Performancës (Benchmarking)

Për të vlerësuar arritjet në performancën e shoqërive UK në sektor edhe gjatë vitit 2022 u përzgjedhën po të njëjtët Tregues Kryesorë të Performancës, të cilët lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive, si dhe të cilësisë së shërbimit që ato i ofrojnë konsumatorëve, respektivisht, *Mbulimi i Kostove të O&M, NKA, UPA dhe Vazhdimësia (Orët) e Furnizimit me Ujë*.

Bazuar në mesataren e renditjes të katër treguesve të mësipërm, në klasifikimin e përgjithshëm shoqëria me performancën më të mirë për vitin 2022 u rendit Shoqëria UK Korçë, e ndjekur nga shoqëritë UK Lezhë dhe UK Kolonjë. Ndërsa, shoqëritë me performancë më të dobët u klasifikuan shoqëritë UK Kurbin, UK Has, dhe UK Krujë (shih Aneks 6, tabela 45).

Konkluzione & Rekomandime

- Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara pranë ERRU-së, për mjaft shoqëri UK, vijon të ketë probleme. Shoqëritë UK duhet të punojnë në drejtim të rritjes së profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë për saktësinë e të dhënave të raportuara duke respektuar procedurat për shkallën e saktësisë së tyre të përcaktuara në metodologjinë e re të vendosjes së tarifave të shërbimeve UK.
- Efiçenca e energjisë duhet të jetë në fokus të shoqërive UK, pasi ky zë shpenzimesh mbetet si kryesor dhe pritshmëria është që mund të ketë akoma rritje për shkak të situatës energjitike në rang global dhe të ndryshimit të kushteve të klimës. Fokusi duhet të jenë kryesisht shoqëritë që pjesën më të madhe të sistemeve të FU e kanë me ngritje mekanike. Këto shoqëri duhet të studiojnë mundësitë për burime alternative të pavarura furnizimi me energji elektrike të rinovueshme.
- Në zbatim të reformës në sektor synohet një përmirësim i dukshëm financiar i operimit të shoqërive rajonale, pra që ato të mund të mbulojnë mbi 100% të kostove të O&M. Në këtë kuadër të mundësohet nga vetë shoqëritë, donatorët ose QQ financimi dhe asistenca e nevojshme për hartimin e Planeve 5 Vjeçare të Biznesit për këto shoqëri që është kusht i domosdoshëm për aplikimin pranë ERRU-së për tarifa të reja, dhe që konsiderohet si instrumenti bazë i vizionit të menaxhimit të shoqërisë për përmirësimin e performancës financiare dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve.
- Shoqëritë rajonale duhet të hartojnë Planet e Menaxhimit të Aseteve si instrumenti bazë që justifikon kërkesat dhe nevojat për financimin e investimeve fizike, si dhe efikasitetin e pritshëm të tyre në operimin e shoqërisë dhe uljen e kostove të tyre.
- Uji Pa të Ardhura në nivelin e 63.7%, vazhdon të jetë në nivele mjaft të larta dhe të papranueshme pavarësisht një përmirësimi të lehtë të këtij treguesi. Shoqëritë rajonale duhet të kenë në fokusin e tyre kryesor reduktimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme dhe të humbjeve fizike. Nga ana tjetër për një vlerësim real të gjendjes së humbjeve dhe të hartimit nga shoqëritë të bilanceve të ujit sa më të sakta, mbetet e një rëndësie të veçantë financimi dhe instalimi i matësve të mëdhenj të ujit në burim dhe ato individualë tek konsumatorët privat dhe familjarë. Bilancet e ujit përcaktojnë gjendjen reale të kërkesës për ujë dhe shërbejnë si bazë për hartimin e planeve për reduktimin e humbjeve dhe mbrojtjen e burimeve nga mbikonsumi i pajustificuar.
- Kostot e punës zënë aktualisht 43% në kostot O&M të shoqërisë. Treguesi i efiçencës së stafit në nivelin 4.73 punonjës për 1000 lidhje UK tregon se ka mjaft hapësirë për reduktimin e tij nga punonjësit e tepërt në numër dhe pozicione të pajustificuara. Shoqëritë UK në kuadër edhe të riorganizimit si rezultat i reformës duhet të rishikojnë organigramën dhe pozicionet e punës bazuar në një analizë të detajuar për të justifikuar numrin e punonjësve në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të saj, kërkesë e cila theksohet në veçanti nga ERRU kur shoqëritë UK aplikojnë për tarifa të reja.
- Shoqëritë UK të cilat nuk janë riorganizuar akoma si shoqëri UK Rajonale, rekomandohet ta përmbyllin sa më parë këtë proces si një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të performancës, efiçencës operationale dhe qëndrueshmërisë financiare të tyre.

Parathënie

Enti Rregullator i Ujit është një institucion publik i pavarur, përgjegjës në nivel kombëtar për rregullimin dhe monitorimin e sektorit të FU dhe largimit e përpunimit të UN. Raporti Vjetor i Performancës së Sektorit të UK dhe të secilës shoqëri UK përbën një detyrim ligjor për ERRU-në, të cilin si institucion i pavarur duhet ta hartojë me paanshmëri dhe objektivitet në vlerësimet e tij për sektorin UK.

Raporti i Performancës së shoqërive UK për vitin 2022 hartuar nga ERRU është një instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit. Në të jepet një pasqyrë e sektorit UK krahasuar me vitet paraardhëse (benchmarking) dhe tendenca e performancës së tij.

Raporti nëpërmjet një diagnoze të detajuar jep gjithashtu konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomike të shoqërive UK dhe në të njëjtën kohë shërben si një mjet për shoqëritë UK për të krahasuar performancën e shoqërisë së tyre me ato të shoqërive të tjera në sektorin UK, sidomos ndërmjet atyre me profil dhe numër konsumatorësh të ngjashëm.

ERRU, në janar të këtij viti si pjesë e raportit të aktivitetit të tij për vitin 2022, për të cilin raporton në parlament, ka hartuar dhe botuar një raport paraprak të performancës së sektorit UK. Në atë kohë raporti është hartuar me të dhëna ekonomiko-financiare që nuk i referohen një bilanci të certifikuar të aktivitetit të shoqërisë, por që qëndrojnë mjaft afër realitetit mundësojnë një analizë të saktë të gjendjes dhe tendencës së performancës së sektorit.

Raporti i mëposhtëm i performancës së sektorit për vitin 2022 që botohet në qershor të vitit 2023 realizohet mbasi ERRU ka marrë të dhënat financiare të vitit 2022 nga shoqëritë UK të certifikuara nga një ekspert kontabël i autorizuar në fund të marsit të vitit pasardhës, si dhe të dhëna të tjera tekniko-operative të detajuara të aktivitetit të shoqërive UK, të cilat grumbullohen dhe përpunohen nga sektori i monitorimit pranë ERRU-së.

Viti 2022 konsiderohet si viti i fillimit të një reforme rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri, e cila synon të integrojë në baza vullnetare 58 shoqëritë UK ekzistuese të sektorit UK në 15 shoqëri UK rajonale të krijuara si Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta (SKP) të regjistruara si shoqëri UK Rajonale, në të cilat qeveria qendrore nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës do të zotërojë 51% të aksioneve të tyre. Në vijim të reformës, deri në mbyllje të vitit 2022 janë krijuar 12 shoqëri UK Rajonale, ndërkohe që gjatë vitit 2023 priten të krijohen edhe 3 shoqëritë e tjera rajonale.

Objektivi kryesor i reformës është që nëpërmjet ekonomisë së shkallës të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve UK.

Duke qenë se ndryshimet në sektor si rezultat i reformës kanë ndodhur në fund të vitit 2022, për efekt krahasimi me vitin paraardhës, analiza e shoqërive në këtë raport do të realizohet sipas 58 shoqërive UK ekzistuese pasi efektet e ndryshimit kanë filluar në fillim të vitit 2023 dhe bilanci financiarë të shoqërive për vitin 2022, janë mbyllur të veçanta për secilën prej tyre. Në këtë kontekst raporti edhe për këtë vit do të ruajë të njëjtën strukturë krahasimore.

Monitorimi i performancës në terren i shoqërive UK, ka vijuar të jetë në fokus kryesor të ERRU-së edhe për vitin 2022. Kjo është reflektuar edhe në numrin e lartë të monitorimeve të zhvilluara në 26 shoqëri UK, me qëllim nxitjen e përmirësimit të performancës së tyre, si edhe të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Saktësia e të dhënave të raportuara vijon të mbetet sfidë për shoqëritë UK, pasi ato janë elementi bazë i një analize objektive të performancës së shoqërive, si dhe të vendosjes nga ERRU të objektivave agresive ndaj shoqërive UK, reale dhe nxitëse për përmirësimin e performancës së tyre në të ardhmen.

Shoqëritë UK, në përgjithësi kanë performuar mirë në disa aspekte të menaxhimit, si ulja e sasisë së ujit të prodhuar, rritja e faturimit, përmirësim të arkëtimeve korrente dhe të prapambetura si dhe në uljen e numrit të konsumatorëve pa matës, por performanca financiare gjatë vitit 2022 gjithsesi është përkeqësuar nga ndikimi i faktorëve objektivë të jashtëm, si rritja e paparashikuar e çmimit të energjisë elektrike.

Gjendja e sektorit UK për vitin 2022, e paraqitur përmes Treguesve Kryesorë të Performancës krahasuar me vitin e mëparshëm, tregon një performancë të përmirësuar pothuajse në të gjithë treguesit, me përjashtim të dy treguesve financiar Mbulimi i Kostove O&M dhe Mbulimi i Kostove Totale, të cilët kanë një rënie të ndjeshme përkatësisht me 13.1% dhe 7.1%. Kjo situatë ishte e pritshme për sektorin UK si rezultat i krizës globale të energjisë elektrike e cila pati pikun e saj përgjatë vitit 2022 e ndikuar edhe nga lufta në Ukrainë e cila ndikoi në rritjen e inflacionit në çdo fushë të jetës duke dhënë kështu impakt negativ në mbulimin në përgjithësi të kostove O&M. Konstatohet se 64% e rritjes së kostove të O&M ka ardhur si rezultat i rritjes së çmimit të energjisë elektrike i cili në vitin 2022 është rritur me rreth 40% për të gjithë sektorin. Sektori ka akoma nevojë që të subvencionohet nga qeveria qendrore nëpërmjet AKUM-it pasi 45 nga totali prej 58 shoqëri UK gjatë vitit 2022 kanë operuar me bilanc financiar negativ, pra nuk kanë arritur të mbulojnë 100% kostot e O&M.

Treguesit e tjerë financiar Normat e Arkëtimit “Korrente dhe të Përgjithshme” të cilat lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive kanë tendencë pozitive krahasuar me vitin 2021 dhe janë përmirësuar përkatësisht me +3.8% dhe +5%. Gjithashtu të përmirësuar paraqiten edhe treguesi i “Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë” i cili është përmirësuar me përafërsisht 1 orë në ditë më shumë se në vitin 2021. Treguesi “Uji Pa të Ardhura” në nivelin e 63.7%, paraqitet i përmirësuar, por përsëri mbetet në nivele shumë të larta dhe të papranueshme, tregues i cili duhet të jetë në fokusin kryesor të objektivit të shoqërive UK. Po kështu të përmirësuar paraqiten edhe treguesit Mbulimi me Ujë 78% dhe Mbulimi me Kanalizime 54.2%.

Detyrimet ndaj OSHEE, vijojnë të mbeten problematikë për sektorin UK edhe gjatë vitit 2022 kjo pasi, siç u theksua më sipër shumica e shoqërive UK nuk arrijnë ti mbulojnë kostot operative me të ardhurat e faturuara, defiçit i cili përgjithësisht i akumulohet debisë së mëparshme të tyre ndaj OSHEE-së. Qeveria qendrore vazhdon të subvencionojë shoqëritë UK, por fondi i akorduar me objekt pagesën e faturave të energjisë elektrike ishte vetëm 26.1% e fondit total të subvencionit. Si rezultat në mbyllje të vitit 2022 detyrimet e shoqërive UK ndaj OSHEE kanë arritur vlerën e rreth 14 miliard lekë ose 122.4 milion Euro.

Përmirësimi i situatës kërkon domosdoshmërisht vëmendje të shtuar nga QQ dhe të stafëve drejtuese të shoqërive UK për mundësimin e shlyerjes së detyrimeve ndaj OSHEE me qëllim pagesën e faturave korrente të energjisë, si dhe shlyerjes pjesë pjesë të borxhit të mëparshëm të akumuluar. Shoqëritë UK rajonale të krijuara, duhet të kenë prioritet hartimin e studimit mbi efijencën e energjisë elektrike duke studiuar edhe mundësitë për burime alternative të rinovueshme të pavarura të energjisë elektrike. Referuar kësaj gjendjeje do të ishte e rekomandueshme gjithashtu mundësia e furnizimit të shoqërive UK me çmim preference të energjisë elektrike, si një sektor jetik dhe jofitimprurës, përndryshe mbulimi i kostove të energjisë do të kërkonte një rritje të tarifave të shërbimeve të FU dhe KUN ndoshta përtej kufijve të përbalueshmërisë nga shtresa të ndryshme të popullsisë.

Investimet në sektor gjatë vitit 2022 kanë qenë në nivele të kënaqshme ku në total janë disbursuar rreth 65 milion euro, por që rreth 87% e saj është financuar nga buxheti i shtetit dhe vetëm 13% nga donatorët e ndryshëm. Investimet kryesore kanë qenë të orientuara në përmbushje të objektivit të qeverisë për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë 24 orë/ditë fillimisht në qendrat urbane të vendit. Këto investime

kanë influencuar edhe në përmirësimin e disa treguesve të sektorit UK në përgjithësi, përkatësisht kohëzgjatja e orëve të furnizimit me ujë, ulja e humbjeve dhe rritja e nivelit të matjes.

Në një kapitull të veçantë të Raportit jepet në mënyrë të përmbledhur Metodologjia dhe Procedura për Miratimin e Tarifave të Shërbimeve UK e cila ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2022 dhe që merr parasysh edhe rastet kur shoqëritë me të ardhurat nga aktiviteti të mund të mbulojnë pjesërisht ose plotësisht nevojat e kostove totale, të cilat përfshijnë edhe financimin me tarifa edhe të investimeve fizike në sistemet e FU dhe të KUN. Gjithashtu një informacion i përmbledhur jepet edhe për reformën në sektorin UK si rezultat i agregimit dhe ndikimi i saj në sektor.

Si konkluzion, përmirësimi i performancës së sektorit UK kërkon një angazhim gjithëpërfshirës të të gjithë aktorëve në sektor, përkatësisht shoqëritë UK, qeveria qendrore si aksionari kryesor i tyre dhe të ERRU-se, AKUM-it, si dhe të pushtetit lokal.

Komisioni Kombëtar Rregullator

1 Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca

1.1 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin

Performanca e përgjithshme e sektorit Ujësjellës Kanalizime për vitin 2022 jepet përmes 12 treguesve të performancës të marrë në analizë nga ERRU të paraqitura në Tabelën 4, të cilët janë përmbledhur dhe rishikuar sipas metodologjisë së re të tarifave duke përfshirë në të për herë të parë edhe treguesit e "Eficiencës së Energjisë" dhe të "Ankesave të Klientëve" ndaj shoqërisë UK. Në tabelë jepet tendenca e treguesve të performancës krahasuar me vitin 2021 si dhe objektivat e "Performancës së Mirë" të përcaktuara nga ERRU.

Tabela 4. Treguesit e Performancës së Sektorit të UK për vitet 2021,2022

Nr.	Treguesit Kryesorë të Performancës	2021	2022	Tendenca	Performancë e Mirë (ERRU)
1	Uji Pa të Ardhura (%)	64.8	63.7	↗	30
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	103.4	90.3	↘	100
3	Mbulimi i Kostos Totale (%)	73.9	66.8	↘	80
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	92.3	97.3	↗	82
5	Norma e Arkëtimit Korrente(%)	77.6	81.4	↗	82
6	Niveli i Matjes (%)	80.7	82.8	↗	85
7	Eficienca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	4.9	4.73	↗	4/6/10
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	15.4	16.3	↗	18
9	Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	52	54.2	↗	75
10	Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	76.8	78	↗	n/a
11	Eficienca e Energjisë FU (kwh/m ³)*	n/a	0.65	-	-
12	Ankesat e Klientëve (%)*	n/a	2.8	-	-

Burimi: ERRU

*** Tregues të vendosur për tu marrë në analizë për herë të parë gjatë vitit 2022.**

Referuar tabelës së mësipërme, vërehet se Treguesit Kryesorë të Performancës për vitin 2022 paraqiten të përmirësuar pothuajse në të gjithë treguesit me përjashtim të treguesve financiar Mbulimi i Kostove O&M dhe Totale të cilët kanë një rënie të ndjeshme përkatësisht me (-13.1%) dhe (-7.1%) dhe që lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK.

Megjithëse, shoqëritë UK në përgjithësi kanë punuar mirë në drejtim të menaxhimit, si në uljen e prodhimit, rritjen e faturimit, arkëtimet korrente dhe të debive të prapambetura si dhe në uljen e numrit të konsumatorëve pa matës, nuk kanë arritur të ruajnë një performancë të mirë financiare. Kjo si rezultat i krizës globale të energjisë elektrike, e cila ka shënuar dhe rritjen më të madhe në zërin e kostove të shoqërive UK për vitin 2022 në nivelin 40% krahasuar me një vit më parë, duke ndikuar më pas në rritjen e të gjitha kostove O&M, e reflektuar edhe në përkeqësimin e këtij treguesi për sektorin në tërësi.

Kostot e Operim & Mirëmbajtjes kanë një rritje me rreth 18%, që vjen kryesisht nga rritja e konsiderueshme e kostove të energjisë elektrike me 1.106 miliard lekë dhe atyre të punës me rreth 372 milion lekë, ndërsa Kostot Totale kanë një rritje me 14%, që vjen nga rritja e kostove të amortizimit.

Pjesa tjetër e treguesve të përmirësuar për vitin 2022, lidhen direkt me rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe menaxhimin e mirë të shoqërive UK, si rritja e Normës së Arkëtimit Korrente dhe e Përgjithshme të cilat paraqiten përkatësisht në nivelin 81.4% dhe 97.3%, Nivelit të Matjes në 82.8%, Mbulimi me Ujë 78%, Mbulimi me Kanalizime 54.2% dhe Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë 16.3 orë/ditë, tregues këto që kanë ndikuar edhe në përmirësimin e Ujit Pa të Ardhura si dhe efijenca e stafit në nivelin e 4.73 staf/1000 lidhje UK.

Treguesi “Efijenca e Stafit” në nivelin 4.73 punonjës për 1000 lidhje UK, paraqitet i përmirësuar për vitin 2022 pasi numri i punonjësve është ulur me 101 punonjës dhe numri i lidhjeve është rritur me 23,970 lidhje Ujë dhe me rreth 22,558 lidhje KUN, por përsëri konstatohet rritje e kostove të punës me 8% të cilat zënë 43% të kostove operacionale të shoqërisë.

Normat e Arkëtimit “Korrente dhe të Përgjithshme” të cilat lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë kanë tendencë pozitive nga viti në vit kjo e reflektuar edhe në vitin 2022.

Kohëzgjatjen e Furnizimit me Ujë” në nivelin e 16.3 orë/ditë, paraqet një përmirësim të ndjeshëm dhe lidhet direkt me cilësinë e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve.

Treguesi “Uji Pa të Ardhura” në nivelin e 63.7% edhe pse vijon të ketë përmirësim të lehtë nga viti në vit, përsëri mbetet në nivele shumë të larta dhe shumë larg objektivit të vendosur nga ERRU për këtë tregues. Treguesi i “Niveli i Matjes” 82.8% i cili lidhet me faturimin e saktë të konsumatorëve për sasinë e ujit që konsumojnë ka përmirësim krahasuar me vitin 2021. Gjithashtu ky trend përmirësimi vërehet edhe për treguesit e “Mbulimit me Ujë dhe Kanalizime”.

ERRU në përputhje me kërkesat bashkëkohore të qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK dhe të rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve i ka dhënë një rëndësi të veçantë përcaktimit dhe vlerësimit të treguesve kryesorë të performancës të sektorit.

Më poshtë analizohen në detaje për të gjithë sektorin secili nga Treguesit Kryesor të Performancës.

1.1.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)

Niveli i Ujit Pa të Ardhura për vitin 2022 rezultoi në nivelin 63.7%. Nga 58 shoqëri që ushtrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, vetëm tre shoqëri performuan nën kufirin 30% të performancës së mirë, 21 prej tyre performuan brenda kufirit 30-50% dhe 34 të tjera mbi kufirin 50% të Benchmarking.

“Uji i prodhuar” që hyn në sistemin e shpërndarjes u realizua në sasinë 310.1 milion m³, nga të cilat 55% rezultoi i matur dhe 45% i vlerësuar. Reduktimi i prodhimit me (- 1.1 milion m³) dhe rritja e Faturimit Total me (+2.8 milion m³) janë faktorët kryesor në përmirësimin e treguesit UPA me (-1.1%).

Niveli i matjes për ujin e prodhuar, i përmirësuar me 5% për këtë vit, ende qëndron në nivele jo të kënaqshme. Pajisja e të gjitha burimeve të shfrytëzueshme me aparate ujëmatës duhet të jetë në fokusin e çdo shoqërie pasi prodhimi i matur në nivele të larta është përcaktues në saktësinë e nivelit të UPA për çdo sistem furnizimi.

Problematikat dhe vështirësitë e hasura gjatë hartimit të Bilancit të Ujit, niveli i ulët i matjes për disa nga shoqëritë UK lidhur me vlerësimin e volumeve të prodhuara dhe faturuara, treguan arsyet e luhatjeve të herëpashërme të treguesit UPA në disa prej shoqërive UK.

Gjatë tre viteve të fundit treguesi UPA ka ruajtur tendencën në përmirësim ndonëse në nivele jo të kënaqshme. Reduktimi i sasisë së ujit që nuk gjeneron të ardhura mundësohet nëpërmjet menaxhimit me

të mirë të sistemeve, reduktimit të lidhjeve të paligjshme në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, zbulimit të lidhjeve të reja dhe ato dyfishe, rritjes së faturimit, instalimit të ujëmatësve në prodhim dhe konsumatorë, mirëmbajtjes së rrjetit dhe reagimit në kohën e duhur ndaj avarive, investimeve të reja, trajnimit të stafit teknik etj.

ERRU, duke konsideruar UPA si pengesën kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërive UK, kërkon nga shoqëritë të angazhohen seriozisht në “Hartimin e planeve të biznesit” dhe përfshirjen në to të planeve të veprimit, për përmirësimin e mëtejshëm të treguesve kryesor të performancës dhe veçanërisht të UPA.

Procesi i reduktimit të UPA influencon në mbrojtjen e burimeve ujore nga mbi konsumi, redukon konsumin e energjisë së harxhuar në sistemet me ngritje mekanike si dhe përmirëson treguesin e Kohëzgjatjes së Furnizimit me Ujë, i cili gjatë këtij viti ushtrimor rezultoi i përmirësuar me +0.9 orë/ditë.

Rritja e kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve, lidhur me menaxhimin më të mirë të sistemeve të furnizimit si dhe njohja në tërësi e rrugëve për reduktimin e UPA, paraqitet e domosdoshme kryesisht në shoqëritë e grupit të dytë dhe të tretë. ERRU rekomandon shoqëritë që stafet teknike të trajnuara dhe me eksperiencë të gjatë pune të vlerësohen si asete të shoqërisë.

Hartimi i “Bilancit të Ujit”, si një instrument i rëndësishëm për evidentimin dhe vlerësimin e humbjeve teknike dhe administrative, mbetet vazhdimisht në fokusin e rregullatorit. Për dhjetë vite radhazi ERRU harton një raport mbi nivelin e UPA në sektor, i cili ju vjen në ndihmë të gjitha shoqërive UK.

Për përcaktimin real të UPA, rrjetet shpërndarëse në sektor kërkohet që të jenë të seksionuara, me zona të mbyllura të matura (DMA) në përputhje me modele hidraulike që lejojnë vlerësimin dhe kontrollin e humbjeve.

1.1.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe i Kostos Totale

Treguesit financiarë të performancës si Mbulimi i Kostove O&M dhe Totale kanë një rëndësi themelore për qëndrueshmërinë financiare në sektor. Performanca në sektor, për vitin 2022, lidhur me këta tregues, paraqitet e përkeqësuar me -13.1% për treguesin e Mbulimit të Kostove O&M dhe me -7.1% për treguesin e Mbulimit të Kostove Totale krahasuar me vitin 2021. Kostot e Operim & Mirëmbajtjes kanë një rritje me rreth 1.733 miliard lekë ose 18%, që vjen kryesisht nga rritja e konsiderueshme e kostove të energjisë elektrike me 1.106 miliard lekë dhe atyre të punës me rreth 372 milion lekë, ndërsa Kostot Totale kanë një rritje me 1.871 miliard lekë ose 14%, që vjen nga rritja e kostove të amortizimit, për shkak të shtimit të aktiveve të shoqërive si rezultat i përfundimit të investimeve të bëra me qëllim furnizimin me ujë pa ndërprerje për zonat urbane

Ndërkohë të ardhurat e aktivitetit dhe të tjera janë rritur me vetëm 303 milion lekë ose 3%, e cila është një rritje shumë e vogël krahasuar me rritjen e kostove të Operim & Mirëmbajtjes me 18% duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në uljen e niveleve të treguesve të mbulimit të kostove.

Tabela 5 jep të detajuara kostot e O&M dhe Kostot Totale për vitet 2021 dhe 2022 dhe diferencat për secilën prej tyre në vlerë absolute në lekë dhe në përqindje.

Tabela nr.5. Zërat e Kostove të O&M dhe Kostove Totale për vitet 2021 e 2022 (në 000 lekë)

Nr.	Kostot e Shërbimit UK	Viti 2021		Viti 2022		Diferenca 2022-2021 në 000 lekë	Rritja/Rënia 2022/2021 në %
		në 000 lekë	në 000 lekë	Ndaj Kostove O&M (%)	Ndaj Kostove Totale (%)		
1	Kosto e punës	4,521,714	4,894,508	43%	32%	372,794	8%
2	Kosto e energjisë së konsumuar	2,799,804	3,906,757	34%	25%	1,106,953	40%
3	Kosto e riparim/mirëmbajtjes	439,757	487,514	4%	3%	47,757	11%
4	Kosto e shërbimeve të kontraktuara	685,350	676,928	6%	4%	-8,422	-1%
5	Kosto e materialeve kimikate	265,968	277,142	2%	2%	11,174	4%
6	Kosto të tjera	947,889	1,151,388	10%	7%	203,499	21%
	Kostot Operim & Mirëmbajtjes	9,660,482	11,394,237	100%	74%	1,733,755	18%
7	Kostot e Amortizimit	3,021,227	3,170,328		21%	149,101	5%
8	Kosto financiare, taksa tatime	841,664	830,392		5%	-11,272	-1%
	Kostot Kapitale	3,862,892	4,000,720		26%	137,828	4%
	Kostot Totale	13,523,374	15,394,956		100%	1,871,582	14%

Ritmi i rritjes së Kostove të Operimit dhe Mirëmbajtjes për vitin 2022 është i konsiderueshëm me 18% krahasuar me vitin 2021 që ishte vetëm 1%.

Konstatohet se, për vitin 2022, rritja e Kostove O&M të sektorit UK është ndikuar kryesisht nga rritja e pothuajse të gjitha kostove operative të UK Durrës, të cilat në total janë rritur me rreth 658.5 milion lekë. Për UK Durrës kjo rritje vjen kryesisht nga rritja e kostos së energjisë, e cila është rritur me 551 milion lekë, si rezultat i rritjes së energjisë së konsumuar me rreth 100 721 kwh si dhe për shkak të rritjes së çmimit për njësi të energjisë elektrike. Më pas ndikim kanë dhënë shoqëritë e tjera si UK Kavajë me 158.2 milion lekë dhe UK Tiranë me 142.4 milion lekë.

Të gjithë zërat që përbëjnë totalin e kostove operative të sektorit janë në rritje me përjashtim të Kostos së Shërbimeve të Kontraktuara dhe Kosto Financiare, të cilat kanë një rënie të lehtë me -1%.

Rritje të konsiderueshme ka shënuar zëri “Kosto e energjisë së konsumuar” me +1.106 miliard lekë, “Kosto e punës” me +372.7 milion lekë, “Kosto të tjera” +203.5 milion lekë, në të cilin shoqëritë përfshijnë kostot të cilat nuk janë të pasqyruar në zërat e tjerë të cituar më lart, si kostot për pagesat rregulatore dhe detyrime të prapambetura ndaj ERRU, SHUKALB-it, Këshillave të Administrimit, tarifave ndaj Ministrisë së Mjedisit për përdorimin e ujit nga Basenet, ekspertë kontabël, kostot për nxjerrjet jashtë përdorimit, vendimet gjyqësore etj.

Në detaje analiza për secilin zë të koston të paraqitur në Tabelën 5 jepet si më poshtë:

Kosto e Punës Sektori për vitin 2022 e ka zhvilluar aktivitetin me një staf prej 7,815 punonjësish (punonjësit e vet pa përfshirë nënkontraktorët) nga 7916 punonjës që janë raportuar në vitin 2021, pra ka reduktuar stafin me (-101) punonjës.

Ky reduktim i numrit të punonjësve vjen si rezultat i riorganizimit të shoqërive UK, pasi në maj 2022, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 302, miratoi reformën në sektorin UK e cila ka si qëllim agregimin e sektorit UK në 15 shoqëri UK rajonale, nga një sektor më parë i fragmentarizuar në 58 shoqëri UK që ofrojnë shërbimin e FU dhe KUN në 61 bashki të vendit.

Megjithëse numri i punonjësve është ulur me 101 punonjës, rritja e kostove të punës me rreth 372.7 milion lekë ka ardhur si rezultat i ndryshimeve të pagës bazë minimale mujore në shkallë vendi, e cila ka ndryshuar dy here brenda vitit 2022, përkatësisht në prill nga 30.000 lekë në 32.000 lekë dhe në shtator në 34.000 lekë. Pritet që me riorganizimin e sektorit numri i punonjësve të reduktohet më tej sidomos stafi administrativ.

Shoqëritë që kanë ulur ndjeshëm numrin e punonjësve janë UK Kavajë me -72 punonjës, UK Vlorë me -45 punonjës, UK Patos me -20 punonjës dhe UK Kurbin -18 punonjës të cilët kanë rishikuar strukturën e punonjësve dhe kanë reduktuar stafet.

Menaxhimi i burimeve njerëzore duhet të jetë prioritet për stafet menaxhuese të shoqërive UK pasi kostot e punës përbejnë peshën më të madhe në totalin e kostove O&M të sektorit, e cila për vitin 2022 zë 43% të tyre. Numri i stafit të punësuar duhet të jetë në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të shoqërisë.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar të analizohen hollësisht numri i punonjësve dhe pozicionet në organigramë, përshkrimet e punës dhe ngarkesa reale për çdo pozicion pune, veçanërisht në rastet kur shoqëritë aplikojnë për nivel të ri tarifor, por sektori vazhdon të jetë i mbingarkuar me staf të pajustificuar.

Kosto e Energjisë Elektrike Kostot e energjisë elektrike zënë rreth 34% në totalin e kostove të O&M. Peshën kryesore e zënë kostot e energjisë elektrike të Grupit të I-rë me rreth 83% të totalit të kostos së energjisë elektrike të sektorit. Shoqëria UK Durrës jep dhe ndikimin kryesor me rreth 44% të kostove të energjisë elektrike të këtij grupi dhe rreth 37% të kostove të energjisë elektrike të sektorit.

I vetmi faktor për rritjen e kostove të energjisë elektrike është rritja e çmimit për njësi, pasi vëllimi i ujit të prodhuar në sektor ka rënë 2.68 milion m³ dhe konsumi i energjisë elektrike në total ka rënë me 6.7 milion KW.

Kostot e energjisë për vitin 2022 për shoqëritë raportohen rreth 1.1 miliard lekë më të larta se viti 2021. Kostot e energjisë janë rritur ndjeshëm me 40% për shkak të krizës së energjisë elektrike e cila arriti kulmin e saj gjatë vitit 2022 ku çmimi për njësi i energjisë elektrike u rrit (nga 11.5 lekë/kwh në 18.8 lekë/kwh) gjithashtu për UK-të që furnizohen me energji 35KV faturohen nga OSHEE me tarifa të liberalizuara të tregut. Ndikimin kryesor në rritjen e kostove të energjisë e ka dhënë UK Durrës i cili ka rritur kostot e energjisë me 551 milion lekë (63%) për arsyet e mësipërme. Rritje të kostove të energjisë elektrike kanë pasur edhe UK Vlorë (96 milion lekë) dhe UK Shkodër (77 milion lekë) dhe UK Tiranë (53 milion lekë). Duke qenë se 78% e shoqërive UK nuk arrijnë ti mbulojnë kostot operative me të ardhurat e faturuara, detyrimet e prapambetura që shoqëritë kanë ndaj OSHEE-së akumulohen çdo vit duke shtuar llogaritë e pagueshme edhe pse qeveria qendrore vazhdon të subvencionojë shoqëritë UK.

Kostot e energjisë elektrike do të mbeten problematike sa kohë që shoqëritë nuk kanë kapacitete financiare për t'i mbuluar të gjitha kostot operative prandaj përballimi i kësaj situate nga shoqëritë UK duhet të trajtohet për zgjidhje përfundimtare nga qeveria qendrore.

Kostot e Riparimeve Kostot e riparimeve gjatë vitit 2022 krahasuar me ato të vitit 2021 kanë rezultuar gjithashtu me rritje 11% ose 47.7 milion lekë.

Rritja e kostove për këtë shërbim ka qenë i dukshëm sidomos për grupin e parë, të cilët përbëjnë 83% të këtyre kostove ku ndikimin kryesor e ka dhënë rritja e kostove të riparimeve për UK Elbasan me 26.68 milion lekë, UK Kamëz 11.74 milion lekë, UK Durrës 9.03 milion lekë dhe UK Tiranë 8.98 milion lekë.

Rritja e këtyre kostove vjen si rezultat i rritjes së numrit të defekteve në rrjetin shpërndarës, por dhe për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve dhe shërbimeve të cilat gjatë këtij viti kanë kapërcyer në nivele të larta.

Kosto e Shërbimeve të Nënkontraktuara për vitin 2022 janë të vetmet kosto që kanë pësuar rënie për sektorin UK dhe janë reduktuar me 8.4 milion lekë (-1%) krahasuar me 2021. Ndikimin kryesor e ka dhënë UK Tiranë me një ulje prej rreth 53 milion lekë, e cila zë 46% në totalin e këtyre kostove për sektorin UK.

Në këto kosto përfshihen shpenzime të tjera për shërbimet e kontraktuara që kryhen nga të tretët, por pjesën më të madhe të këtyre kostove e zënë ato për shërbimin e rojeve nga nënkontraktorët. Shoqëritë janë të detyruara të mbajnë përgjegjësi për sigurinë e komponentëve të furnizimit me ujë, si depo, stacione pompimi, puse etj., të cilët konsiderohen si objekte me rëndësi strategjike për ruajtjen e sigurisë së shëndetit të popullsisë, kështu shërbimi i rojeve përveçse me punonjësit e vet kryhet dhe me nënkontraktorë.

Shoqëritë UK duhet të investojnë në monitorimin e objekteve nëpërmjet sistemeve të sigurimit me kamera të cilat sjellin reduktimin e këtyre kostove, ky investim duhet të jetë një nga prioritetet e investimeve në sektor.

Kosto e materialeve kimikate krahasuar me vitin 2021 janë rritur me 4% ose me vlerë 11.17 milion lekë. Ndikimin kryesor në këtë rritje të kostove të materialeve kimikate e ka dhënë UK Tiranë me rritje 1.9 milion lekë, e cila zë 71% në totalin e këtyre kostove për sektorin, pas shoqërisë UK Tiranë përdorim të lart për materiale kimikate ka pasur UK Kamëz dhe UK Lezhë.

Kosto të Tjera. Kostot e tjera janë rritur me rreth 203.5 milion lekë krahasuar me kostot e vitit 2021. Rritje të konsiderueshme ka shënuar UK Tiranë (94.3 milion lekë), UK Durrës (56.9 milion lekë), UK Kavajë (33.6 milion lekë), UK Vlorë (22.5 milion lekë) etj.

Në këto kosto shoqëritë raportojnë detyrimet ndaj ERRU, SHUKALB-it, pagesat e këshillave të Administrimit, tarifrat ndaj Agjencisë së Baseneve për përdorimin e ujit nga Basenet, ekspertë kontabël, shpenzime për penalitete dhe gjoba, shpenzime për konsulencë si dhe të tjera kosto që nuk kategorizohen në zërat e tjerë sintetik të kostove.

Kostot Kapitale. Kostot Kapitale përfshijnë kostot e Amortizimit dhe të Kredive. Këto kosto zënë një peshë të konsiderueshme me rreth 26% të totalit të kostove të sektorit.

Kostot e amortizimit për vitin 2022 rezultojnë 149.1 milion lekë më të larta se viti 2021, e cila kryesisht ka ardhur nga investimet e kryera dhe të pasqyruara në aktivet e bilanceve të shoqërive UK, ku ndikimin kryesor e ka dhënë rritja e kostove të amortizimit për UK Kavajë me 129.5 milion lekë, kjo për shkak se në vitin 2022 në bilancin e saj financiar janë pasqyruar dy aktive me vlerë të konsiderueshme të cilat nuk kanë qenë të regjistruara që nga viti 2017 dhe si rrjedhojë është llogaritur amortizimi i tyre i paraqitur dhe në bilancin financiar të shoqërisë. Më pas ndikim kanë dhënë edhe shoqëritë UK Kamëz me 77.4 milion lekë dhe UK Tiranë 44.7 milion lekë.

Kostot financiare, ku përfshihen kostot e interesave, kostot e taksave dhe tatimeve, provizione dhe zëri kosto financiare janë reduktuar me 11.3 milion lekë ku kryesisht ka ndikuar ulja e kostove për taksat-tatime

me 57.9 milion lekë dhe ulja e kostove financiare me 78.1 milion lekë. Kostot për interesa për vitin 2022 janë 391.5 milion lekë, por disa shoqëri nuk kanë mundësi financiare për të përballuar këto kosto.

Kostot Totale të aktivitetit të shoqërisë përbëhen nga Kostot O&M dhe Kostot Kapitale. Theksohet se sektori UK vazhdon të jetë larg mbulimit 100% të Kostove Totale. Aktualisht janë 3 shoqëri, UK Tiranë, UK Dibër dhe UK Librazhd, që arrijnë që t'i mbulojnë këto kosto.

Me të ardhurat e gjeneruara mbulohen vetëm 67% të shpenzimeve totale. Ritmi i rritjes së kostove totale me 14% për vitin 2022 tregon për paqëndrueshmëri të nivelit të kostove. Kjo kryesisht ka ardhur për shkak të krizës energjetike, pasi rritjet e kostove të energjisë reflektojnë ndikimin e tyre në përkeqësimin e situatës financiare, e cila do të ulë treguesit financiarë të performancës si Mbulimi i Kostove OM dhe Totale si rezultat i pamundësisë së likuiditetit për të shlyer kostot operative.

1.1.3 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është një nga treguesit financiar më të rëndësishëm të performancës së shoqërive, që lidhet me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe me aftësinë paguese të saj. Raporti ka konsideruar dy tregues në lidhje me Normën e Arkëtimit, përkatësisht Normën e Arkëtimit të Përgjithshme (NAP) dhe Normën e Arkëtimit Korrente (NAK). NAP në përlogaritjen e saj përfshin të gjitha arkëtimet e kryera gjatë gjithë vitit nga shoqëria, pra, edhe debitë e vjetra, ndërsa NAK i përjashton këto të fundit, pra, llogarit vetëm arkëtimet e kryera lidhur me të ardhurat e faturuara brenda vitit ushtrimor.

Aneks 2, tabela 41 jep për secilën shoqëri NAP dhe NAK të vitit 2022 dhe krahasuar ato me vitin 2021. Norma e Arkëtimit Korrente për sektorin UK për vitin 2022 raportohet në nivelin 81.4% nga 77.6% në vitin 2021, pra me një rritje prej 3.8% krahasuar me vitin 2021. Ky tregues mund të mos jetë real pasi shumë shoqëri në kontabilizimin e arkëtimit korrent përjashtojnë arkëtimet e vonuara në kohë, por që kryhen brenda vitit dhe i raportojnë si arkëtim i debive. NAP është një tregues më real pasi e amortizon “gabimin” që konstatohet në NAK.

Për vitin 2022, 35 shoqëri të sektorit UK, nga 58 në total kanë performuar pozitivisht sa i përket normës korente të arkëtimit, krahasuar me vitin 2021. Shoqëritë UK me normë të lartë arkëtimi korrent (mbi 85%) janë shoqëritë e bashkive Gramsh, Vorë, Tiranë, Berat, Kuçovë, Mat, Pogradec, Fushë-Arrëz, Lezhë, Poliçan, Himarë, Mirditë dhe Korçë.

Disa nga shoqëritë që operojnë me normë arkëtimi korrente të ulët (nën 60%) janë UK Krujë, UK Finiq, UK Sarandë, UK Cërrik, UK Libohovë, dhe U Has.

Norma e Arkëtimit e Përgjithshme për vitin 2022 raportohet e përmirësuar me 5% dhe paraqitet në nivelin 97.3% nga 92.3% që ka qenë në vitin 2021. Gjatë vitit 2022 shoqëritë kanë arkëtuar rreth 1.6 miliard lekë debi të prapambetura, pra rreth 164 milion lekë më shumë se viti paraardhës. Shoqëritë janë munduar ta përmirësojnë këtë tregues ku në vijim të reformës në disa shoqëri janë shtuar kontrollet me anë të task forcës e cila ka marrë masa deri në ndërprerjen e furnizimit me ujë të konsumatorëve debitorë duke i detyruar kështu që të bëjnë marrëveshjet midis shoqërisë dhe konsumatorit, sipas së cilës arkëtohen edhe debitë e vjetra krahas faturave korrente.

Përmirësimi i këtij treguesi lidhet me monitorimin e rregullt të arkëtimit të klientëve, moslejimin e krijimit të borxhit të keq, marrjen e masave për klientët që nuk paguajnë, si edhe me shtimin e qendrave dhe mënyrave të pagesës së faturës.

1.1.4 Niveli i Matjes

Niveli i Matjes është raporti i lidhjeve me matës ndaj numrit total të lidhjeve i shprehur në përqindje. Ky tregues analizon vetëm lidhjet me matës të kategorive të konsumatorëve dhe nuk pasqyron nivelin e matjes në sistemin e furnizimit me ujë. Rritja e nivelit të matur të ujit, rrit saktësinë dhe tek treguesi "Uji pa të Ardhura". Ky tregues është rritur me (+2.1%), për vitin 2022 duke e çuar nivelin e matjes në 82.8 % nga 80.7 % që ka qenë për vitin 2021. Ky tregues është shumë pranë objektivit të vendosur nga ERRU i cili është 85%. Ky tregues është shumë i rëndësishëm pasi ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e shërbimit për konsumatorët si dhe në rezultatet e disa treguesve të tjerë duke ndikuar në përmirësimin e tyre.

Shoqëritë UK për vitin 2022 kanë raportuar instalimin e 23 907 matësve të rinj, kështu numri i lidhjeve me matës në rang sektori ka shkuar 782 720 lidhje nga 945 128 lidhje UK që janë në total në të gjithë shoqëritë. Sektori ende vazhdon të faturojë aforfe 6 615 klientë privat dhe institucione, ndërkohë që procesi i instalimit të matësve, në kategorinë klientë jo familjarë të financuara nga vetë klientët, duhet të kishte përfunduar në zbatim të Vendimit Nr. 236, datë 10.5.1993 dhe VKM nr.96, datë 21.2.2007.

Me nivel shumë të mirë të këtij treguesi mbi 85% janë 26 shoqëri, por ka dhe shoqëri që e kanë këtë tregues nën nivelin 40%, si UK Kukës, UK Skrapar, UK Selenicë, UK Bulqizë, UK Kurbin, UK Dropull, UK Libohovë.

Në mënyrë që konsumatorët të paguajnë volumin real të ujit të konsumuar, shoqëritë UK duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë pajisjes 100% të konsumatorëve me matës, por edhe për faktin se faturimi aforfe lë hapësirë për shpërdorimin e ujit nga konsumatorët për ujitje, veçanërisht ato të shtëpive private dhe zonave rurale, e cila jep më pas impakt negativ edhe në treguesin tjetër të Uji Pa të Ardhura.

ERRU thekson vazhdimisht nevojën e instalimit të matësve në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë dhe konsumatorëve individualë, por për këtë kërkohet edhe mbështetja me financime nga qeveria qendrore.

1.1.5 Efiçenca e Stafit

Efiçenca e Stafit është një tregues shumë i rëndësishëm për sektorin pasi lidhet direkt me kostot e punës, të cilat zënë peshën kryesore ndaj totalit të kostove. Në vlerësimin e këtij treguesi ERRU ka përfshirë vetëm stafet sipas organigramës së shoqërive pa përfshirë personelin roje të nënkontraktorëve pasi paraqet situatën reale të stafit i cili operon në shoqëri sipas organigramës. Ky është edhe një nga dokumentet që ERRU i kërkon shoqërive në momentin që aplikojnë për nivel të ri tarifor dhe mbi të cilën vendosen edhe objektivat e këtij treguesi. Efiçenca e stafit për vitin 2022 është 4.73 punonjës për 1000 lidhje UK. Ky tregues luhet në varësi të dy variablave që janë numri i stafit të shoqërive dhe numri i lidhjeve UK. Përmirësimi i lehtë i efiçencës së stafit për vitin 2022, vjen si rezultat i uljes së numrit të punonjësve me 101 punonjës kundrejt rritjes së numrit të lidhjeve të ujit me rreth 23,970 lidhje dhe të lidhjeve me kanalizime me rreth 22,558 lidhje duke influencuar kështu në përmirësimin e këtij treguesi.

Vlen të theksohet se në shumë shoqëri ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të kërkesës në plotësimin e detyrimit ligjor për garantimin e sigurisë së veprave me personel roje veçorive të komponentëve të sistemeve të FU dhe KUN. Në ato zona shërbimi ku numri i depove, puseve dhe stacioneve të pompimit është i madh shoqëritë janë të detyruara që të kenë një numër të konsiderueshëm punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte që krijon përshtypjen e një treguesi të ulët të Efiçencës së Stafit. Gjithashtu faktor tjetër që influencon negativisht në këtë tregues vijnë të mbeten punësimet e pajustificuara, gjë që kërkon një vëmendje të veçantë të analizës së stafit për

vlerësimin real të këtij treguesi bazuar në organigramën përkatëse të shoqërisë dhe justifikimin e çdo pozicioni të punës në përputhje me përshkrimin e saj.

1.1.6 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë

Cilësia e shërbimit ndaj konsumatorëve, që matet përmes vazhdimësisë së shërbimit edhe për këtë vit nuk është në nivelet e duhura. Kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë nuk ka pësuar ndryshime të mëdha është rritur me vetëm 0.9 orë/ditë, krahasuar me vitin 2021. Konsumatorët janë furnizuar me ujë mesatarisht 16.3 orë/ditë, vlerë e cila është nën nivelin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU prej 18 orë/ditë.

Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve si (furnizimi i ujit me ndërprerje periodike, shpimi i tubave nga lidhjet e paligjshme, mbajtja e ujit në depozita etj.) ndikon edhe në cilësinë e ujit të pijshëm, që lidhet dhe me rrezikun e cënimit të shëndetit të popullatës, prandaj shoqëritë UK duhet të kenë në fokus kryesor gjetjen e rrugës dhe mundësisë për përmirësime të mëtejshme. Ato duhet të kujdesen në veçanti për treguesin Uji Pa të Ardhura që lidhet ngushtësisht me treguesin e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të konsumatorëve.

Investimet kapitale vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e situatës së sektorit edhe pse eksperiencia ka treguar se shoqëritë me performancë të mirë ose që kanë arritur në nivele të pranueshme, në oraret e furnizimit me ujë, në të tre grupet, nuk varet vetëm nga investimet, por mund të arrihet edhe përmes menaxhimi të mirë të shoqërisë.

Gjatë vitit 2022, ka vazhduar procesi i kryerjes dhe i përfundimit të investimeve kapitale për qendrat urbane të nisura nga Qeveria Qendrore, nëpërmjet AKUM-it, e cila do të vazhdojë deri në fund të vitit 2023. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për zonën rurale vazhdon të jetë më e ulët krahasuar me zonën urbane, kjo për arsye se investimet kapitale kanë qenë të drejtuara kryesisht në zonat urbane.

Shoqëritë ofrojnë furnizimin me ujë sipas një grafiku të përcaktuar dhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë varion nga 2-24 orë/ditë. Shoqëritë që ofrojnë furnizim të pandërprerë me ujë janë 11 shoqëri si UK Korçë, UK Lezhë, UK Librazhd, UK Mirditë, UK Devoll, U Gramsh, UK Bulqizë, UK Përmet, UK Poliçan, UK Fushë Arrëz, UK Pustec. Megjithatë disa shoqëri paraqiten me nivel të papranueshëm të këtij treguesi dhe ofrojnë deri në 6 orë/ditë ujë, të tilla janë UK Kamëz me 4 orë/ditë, UK Roskovec me 5 orë/ditë dhe UK Kurbin me 2 orë/ditë, që është dhe shoqëria me performancën më të dobët për këtë vit.

Vihet re, se shoqëritë UK gjatë raportimeve nuk bëjnë një llogaritje të saktë të orëve mesatare të furnizimit me ujë për të gjithë zonën e shërbimit të tyre në mënyrë analitike sipas zonave të ndara të shpërndarjes (DMA), por vetëm duke u nisur nga koha e shkarkimit të depove që furnizon rrjetin shpërndarës, e cila nuk është metoda e duhur për matjen dhe vlerësimin e tij. Shoqëritë duhet të marrin me seriozitet raportimin e të dhënave në ERRU pasi vazhdojnë akoma të jenë larg nivelit të dëshiruar lidhur me saktësinë dhe besueshmërinë e tyre.

1.1.7 Mbulimi me Shërbimet e FU dhe të KUN

Treguesi “Mbulimi me FU” dhe Mbulimi me KUN për vitin 2022 ka shënuar një rritje respektivisht me 1.3% për shërbimit FU dhe 2.2% për shërbimin KUN krahasuar me vitin 2021.

Popullsia në zonën e juridiksionit për vitin 2022 raportohet rreth 4.43 milion banorë me një rritje me 4.2 mijë banorë krahasuar me vitin paraardhës. Shërbimi i furnizimit me Ujë ofrohet për 78% të popullsisë

në juridiksion. Ky tregues ka një rritje të lehtë sepse popullsia në zonën e juridiksionit është shtuar shumë pak me 4 212 banorë, ndërsa ajo e mbuluar me shërbimin me kanalizimeve raportohet të jetë shtuar me rreth 58 806 banorë duke çuar mbulimin në 54.2%, por përsëri mbetet shumë larg nivelit të kërkuar.

Shërbimi me kanalizime i ujërave të ndotura ofrohet për 132 028 banorë me tepër se në vitin 2021. Problemi kryesor vazhdon të mbetet Zona Rurale, në të cilën përgjithësisht nuk ka rrjet kanalizimesh dhe shkarkimet e ujërave të ndotura realizohen individualisht me gropa septike, por që lënë mjaft për të dëshiruar në drejtim të respektimit të standardeve teknike të zbatimit të tyre. Mbulimi i shërbimit me KUN dhe ITUN mbetet sfidë për sektorin UK për tu realizuar në të ardhmen duke patur parasysh që është edhe një nga kërkesat që duhen plotësuar në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Kjo pasi kërkohen investime të shumta ku sipas një studimi të fundit të Bankës Botërore arrin në nivelin e rreth 2.5 miliard Eurove.

1.1.8 Efiçenca e Energjisë

Treguesi “Efiçenca e Energjisë” është një tregues i vendosur për herë të parë në listën e treguesve kryesorë të performancës në vitin 2022 i përcaktuar në metodologjinë e re të tarifave, si një tregues shumë i rëndësishëm i performancës financiare të shoqërive UK dhe që duhet të monitorohet si nga shoqëria ashtu edhe nga ERRU. Për vitin 2022 efiçenca e energjisë për furnizimin me ujë në sektor është 0.65 kwh/m³, por duke qenë viti i parë i vendosjes së këtij treguesi nuk mund të realizohet një analizë krahasimore me vitin e mëparshëm.

Monitorimi i këtij treguesi do të realizohet nëpërmjet variablave :

- Konsumi i energjisë elektrike për nevoja teknike për furnizim me ujë (konsumi i të gjitha instalimeve teknike – impiante trajtimi, stacione klorinimi, stacione pompimi, hidrofone, rezervuarë, të tjera) në zonën e shërbimit. (Kw)
- Vëllimet e ujit në hyrje të sistemit m³
- Konsumi i energjisë elektrike për nevoja teknike për trajtimin e ujërave të zeza (konsumi i impianteve të trajtimit të ujërave të zeza) Kw
- Vëllimi i Ujërave të zeza të trajtuara në WWTP m³

Nëpërmjet monitorimit të këtyre variablave, ERRU, do të llogarisë 2 tregues performance të efiçencës së energjisë, për ujin e pijshëm dhe për ujërat e ndotura, të cilat duhet të kenë trend rënës për një performancë të mirë. Analiza e këtij treguesi bëhet për shkak se rritja e konsumit të energjisë elektrike është e lidhur drejtpërdrejt me rritjen e kostove operative si me situatën e krizës energjitike globale.

ERRU, për shoqëritë që kanë aplikuar për tarifa gjatë vitit 2022, ka vendosur detyra mbi domosdoshmërinë e studimit të komponentëve të efiçencës së energjisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe KUN.

1.1.9 Ankesat e Klientëve

“Ankesat e Klientëve” edhe ky është një tregues i ri i vendosur për herë të parë për tu marrë në analizë gjatë vitit 2022 si një tregues shumë i rëndësishëm i cili lidhet direkt me cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe mbrojtjen e interesave të tyre. Ankesat e klientëve në raport me numrin total të lidhjeve të sektorit UK për vitin 2022 janë 2.8%, por edhe në këtë rast nuk mund të bëhet një analizë krahasimore me vitin paraardhës. Vendosja e këtij treguesi si pjesë e treguesve kryesorë të performancës për tu vendosur edhe si objektiva për shoqëritë UK, lidhet edhe me angazhimin e ERRU-së në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit. Në këtë kontekst, ERRU, krijoi brenda strukturës organizative Strukturën e

Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjes (SZAM), si struktura përgjegjëse brenda rregullatorit për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorit dhe shoqërisë UK në sektorin FU dhe KUN. *Natyra e ankesave të klientëve paraqitet kryesisht në tre kategori “zbatueshmëria e kushteve të kontratës për shërbime ujësjellës kanalizime”, “cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK” dhe “faturimi aforfe”.*

1.2 Rezultatet Financiare të Sektorit

1.2.1 Të Ardhurat nga Aktivitetet dhe Subvencionet

Rezultatet financiare për të gjitha shoqëritë UK janë me humbje, përveç UK Tiranë, UK Dibër dhe UK Librazhd, të cilat mbulojnë totalisht kostot operative dhe kapitale (ku përfshihen edhe ato për investime), me të ardhurat nga aktiviteti dhe të ardhura të tjera.

Për vitin 2022 nga 58 shoqëri UK që kanë operuar në sektor rezulton se vetëm 13 prej tyre, gjenerojnë të ardhurat e nevojshme për të shlyer totalisht kostot operative, ndërsa të gjitha shoqërive të tjera u mbetet një pjesë e kostove operative për t’u financuar nga jashtë apo subvencionuar, në mënyrë që të mos ngarkohen llogaritë e pagueshme çdo vit.

Gjatë vitit 2022 qeveria qendrore, nëpërmjet AKUM ka shpërndarë 360 milion lekë subvencione, të cilat krahasuar me një vit më parë janë ulur me 20 milion lekë. Për këtë vit, subvencione kanë përfituar vetëm 12 shoqëritë UK Rajonale, të cilat kanë filluar procesin e riorganizimit, përkatësisht nga 30 milion lekë secila **me përjashtim të shoqërive Rajonale UK Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, të cilat nuk e kanë përfunduar akoma këtë proces.** Kjo lidhet edhe me strategjinë e qeverisë qendrore e cila i ka dhënë prioritet me mbështetje financiare shoqërive UK të cilat janë bërë pjesë e reformës sipas VKM nr. 302 ku MIE/AKUM është aksionare me 51% të aksioneve.

Për vitin 2022 janë realizuar 10 291 milion lekë të ardhura nga aktiviteti i shoqërive UK, të cilat krahasuar me vitin paraardhës janë rritur me 303 milion lekë.

Në Aneks 3, tabela 42, paraqet nevojat reale për subvencione të shoqërive UK për të mbuluar kostot e O&M si dhe subvencionet e marra për vitin 2022. Në këtë tabelë, të ardhurat nga aktiviteti krahasohen me Kostot e O&M dhe Kostot Totale, gjithashtu paraqitet dhe rezultati financiar vjetor i shoqërive UK me humbje ose fitim.

Tabela 6 jep në mënyrë të përmbledhur të ardhurat për sektorin nga aktiviteti i shoqërive UK dhe nga subvencionet e akorduara nga qeveria qendrore nëpërmjet AKUM-it.

Tabela nr.6. Të Ardhurat e Sektorit UK për Vitet 2021-2022 nga Aktiviteti dhe Subvencionet

Nr.	Emërtimi	Viti 2021 (në 000 lekë)	Viti 2022 (në 000 lekë)	Diferenca (në 000 lekë)
1	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	9,987,507	10,290,998	303,491
2	Të Ardhurat nga Subvencionet	380,000	360,000	-20,000
3	TOTALI	10,367,507	10,650,998	283,491

Duke patur parasysh ndarjen e shoqërive në grupe, tabela 7 jep të dhënat mbi të Ardhurat e Sektorit për Vitet 2021-2022, të ndara sipas Grupeve të Shoqërive UK.

Tabela nr. 7. Të Ardhurat e Sektorit UK për Vitet 2021-2022 sipas Grupeve të Shoqërive UK

Nr.	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2022
		Grupi i I-rë (në 000 lekë)		Grupi i II-të (në 000 lekë)		Grupi i III-të (në 000 lekë)	
1	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	8,508,528	8,742,915	1,338,414	1,364,884	140,565	183,199
2	Të Ardhurat nga Subvencionet	215,408	105,762	154,554	198,710	10,038	55,528
3	TOTALI	8,723,936	8,848,677	1,492,968	1,563,594	150,603	238,726
	Diferenca pa Subvencionet	+234,387		+26,470		+42,634	

Nga tabela e mësipërme vërehet se në shoqëritë e **Grupit të I-rë** të ardhurat janë rritur me rreth 234 milion lekë. Shoqëritë që kanë rritjen më të madhe të të ardhurave në Grupin e parë janë UK Kavajë (+94.3 milion lekë), për shkak të rritjes së numrit të lidhjeve FU (+593 lidhje), rritjes së numrit të lidhjeve KUN (+319) rritjes së nivelit të faturimit si dhe eliminimit të lidhjeve të paligjshme nëpërmjet task-forcës; UK Durrës (+68.4 milion lekë), kryesisht për shkak të rritjes së numrit të lidhjeve FU (+2025 lidhje). Të tjera shoqëri me të ardhura më të larta, krahasuar me vitin paraardhës janë: UK Kamëz (+27.2 milion lekë), UK Fier (+24.5 milion lekë), UK Sarandë (+21.3 milion lekë), UK Vlorë (+14.7 milion lekë), UK Tiranë (+12.7 milion lekë), UK Korçë (+9.8 milion lekë) dhe UK Elbasan (+ 4.3 milion lekë).

Të gjitha shoqëritë e tjera të Grupit të I-rë kanë rënie të të ardhurave krahasuar me vitin paraardhës, duke filluar nga UK Lushnje (-18 milion lekë), UK Shkodër (-11.5 milion lekë), UK Lezhë (-5.5 milion lekë), UK Berat-Kuçovë (-5.3 milion lekë) dhe UK Pogradec (-2.5 milion lekë).

Në **Grupin e II-të** konstatohet rritje e të ardhurave për vitin 2022 në shumën 26.5 milion lekë, edhe pse, UK Vau Dejës dhe UK Poliçan kanë kaluar në grupin III, për shkak të numrit të lidhjeve që ka ndryshuar. Rritjen më të madhe e kanë shënuar UK Patos, UK Përmet dhe UK Cërrik. Me rënien më të madhe të të ardhurave në këtë grup janë shoqëritë: UK Krujë (-6.8 milion lekë), UK Divjakë (-5.5 milion lekë) dhe UK Mat (-5.4 milion lekë).

Grupi i III-të, të ardhurat e gjeneruara të të cilit përbëjnë vetëm 1.8% të të ardhurave të sektorit, rezultojnë me rritje të të ardhurave me rreth 42.6 milion lekë. Kryesisht, kjo diferencë kaq e lartë në të ardhura vjen si rezultat i përfshirjes në grupin e tretë të dy shoqërive UK Vau Dejës dhe UK Poliçan, që më parë kanë qenë në grupin e dytë (pra në këtë grup krahasohen të ardhurat e 13 shoqërive për vitin 2022, me të ardhurat e 11 shoqërive për vitin 2021).

Për vitin 2022 janë 13 shoqëri që i mbulojnë mbi 100% Kostot O&M nga 58 shoqëri në total. Niveli i mbulimit të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes, krahasuar me vitin e mëparshëm ka pësuar rënie për të gjithë sektorin, ku për shoqëritë e Grupit të I-rë ka një rënie të konsiderueshme nga 113.2% në vitin 2021, në 96.4% në vitin 2022, për shoqëritë e Grupit të II-të nga 70.4% në 67.8%, dhe për shoqëritë e Grupit të III-të, një rënie më të lehtë nga 60.1% në 59.3%, siç paraqitet dhe në tabelën nr. 8 në vijim.

Tabela nr. 8. Mbulimi i Kostove të Sektorit UK për Vitet 2021-2022, sipas Grupeve të Shoqërive UK

Nr.	Emërtimi	Viti	Viti	Viti	Viti	Viti	Viti
		2021	2022	2021	2022	2021	2022
		Grupi i I-rë		Grupi i II-të		Grupi i III-të	
		(në 000 lekë)		(në 000 lekë)		(në 000 lekë)	
1	Kostot e Sektorit UK	7,515,931	9,073,676	1,847,311	2,011,872	297,240	308,689
2	Mbulimi i kostove O&M	113.2%	96.4%	70.4%	67.8%	60.1%	59.3%
Shoqëri që mbulojnë Kostot O&M 2022		6		7		0	

Rritja e të ardhurave nga aktiviteti ka ardhur për arsye se vëllimi i ujit të faturuar për vitin 2022, krahasuar me vitin 2021 është rritur me 2.8 milion m³ ujë, si rezultat i rritjes me rreth 24 mijë lidhje të reja të furnizimit me ujë dhe 23 mijë lidhjeve me KUN si dhe për shkak të rritjes së orëve të furnizimit me ujë.

Sektori me të ardhurat e gjeneruara arrin të mbulojë kostot e O&M deri në nivelin 90.3%, ku vetëm 13 shoqëri arrijnë të mbulojnë kostot O&M 100%, 4 mbulojnë mbi 90% dhe 41 të tjera mbulojnë më pak se 90% e këtyre kostove. Ndërkohë, 10 shoqëri UK (në grupin e dytë dhe të tretë) nuk arrijnë të mbulojnë as 50% të kostove operative dhe nuk kanë kapacitet financiar për të vazhduar aktivitetin nëse nuk subvencionohen nga qeveria qendrore.

Gjatë vitit 2022 shpërndarja e subvencioneve është bërë në kuadër të agregimit të shoqërive. Secila SKP e krijuar brenda vitit 2022 ka përfituar 30 milion lekë, të shpërndara sipas nevojave të shoqërive, për qëllime të përcaktuara. Përkatësisht, për secilin qëllim është bërë shpërndarja si në vijim e fondeve: 38.9% për mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 13.6% për tatim taksa, 4.8% për paga, 26.1% për energji elektrike, si dhe 16.7% për performancë. Këtë të fundit e kanë përfituar vetëm dy shoqëri UK Rajonale Korçë dhe Pogradec kjo, në kuadër të nxitjes nga AKUM për një performancë sa më të mirë të shoqërive.

Nevoja reale për subvencione, për mbulimin e kostove O&M për të gjithë sektorin është 2 840 milion lekë, por, realisht janë shpërndarë 360 milion lekë, ose ndryshe vetëm 12.7% e nevojë së sektorit për subvencione.

Ndërkohë, siç u përmend më sipër kanë mbetur pa marrë fonde nga qeveria qendrore shoqëritë që nuk janë bashkuar ende, përkatësisht: UK Shkodër, UK Fushë Arrëz, UK Pukë, UK Vau Dejës, UK Malësi e Madhe, UK Tiranë, UK Kamëz, UK Vorë, UK Vlorë, UK Selenicë dhe UK Himarë të cilat përbëjnë 3 shoqëri UK Rajonale.

1.2.2 Investimet në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimit të Ujërave të Ndotura

Investimet në fushën e ujësjellës kanalizimeve që realizohen nëpërmjet agjencisë zbatuese AKUM (Agjencia Kombëtare Ujësjellës dhe Mbetjeve), ndahen :

- I. Të financuara nga buxheti i shtetit, përkatësisht:
 - a) investime fizike në sistemet e furnizimit me ujë dhe KUN
 - b) Investime për studim-projektim-mbikëqyrje punimesh të investimeve fizike
 - c) Kontributet lokale në zbatim të projekteve të financuara nga donatorë të huaj,dhe,
- II. investime të projekteve të financuara nga donatorët e huaj sipas marrëveshjeve përkatëse me qeverinë shqiptare.

Në total investimet sipas specifikave të mësipërme jepen në Tabelën nr.9 të mëposhtme .

Në total janë investuar **7,824,464,882 Lekë (ose rreth 65 milion Euro)**, nga të cilat **6,830,143,000 Lekë janë financiar nga Qeveria Shqiptare (rreth 87,3% të totalit) dhe 994,321,882 Lekë nga donatorët e huaj (rreth 12,7%).**

Në Aneks 16 jepet gjithashtu Tabela 54, (burimi AKUM), e cila përmban të dhëna të plota për çdo shoqëri UK të bashkive përkatëse, ku përfshihen detaje të secilit projekt, autoritetin kontraktues, vlerën e financiar, si dhe periudhën e zbatimit të punimeve.

Theksohet fakti se në sektorin e ujësjellës kanalizimeve financohen mjaft projekte, kryesisht në zona rurale, edhe nga agjencia tjetër zbatuese Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), të cilat nuk janë subjekt i këtij raporti.

Tabela nr.9. Investimet totale të realizuara në sektor për vitin 2022 nga buxheti i shtetit dhe financim i huaj sipas zërave.

Nr.	Zërat	Vlera (në lekë pa TVSH-në)	Vlera (në % mbi totalin)
1	Totali i investimeve fizike	6,028,719,075	77.05%
2	Totali i Studim-Projektim-Supervizion punimesh	147,401,057	1.88%
3	Totali Financimi i huaj	994,321,882	12.71%
4	Totali Kosto Lokale	654,022,868	8.36%
5	Totali i Përgjithshëm(Pa TVSH)	7,824,464,882 Lekë (rreth 65 milion Euro)	

Nga tabela e mësipërme vërehet se zëri i financimeve studim-projektim-supervizion punimesh përbën 1,88% të totalit të përgjithshëm të investimeve fizike. Kjo vlerë duhet të jetë ndërmjet 5%-20% të vlerës së totalit të investimeve fizike kushtëzuar nga madhësia e vlerës së investimit si dhe kompleksitetit dhe vështirësisë inxhinjerie të zbatimit të tij. Për rrjedhojë kjo përqindje konsiderohet e ulët gjë që në mjaft raste mund të mbartë rrezikun e cenimit të cilësisë së hartimit të projektit, dhe sidomos cilësinë e supervizionit të punimeve gjatë zbatimit të tij.

Tabela nr.10 jep vlerat e investimeve të ndara në investime fizike dhe ato për studim-projektim-mbikëqyrje punimesh për secilën shoqëri më vete në bashkitë përkatëse. Këto vlera jepen edhe në formë grafike në vlera absolute investimi, si dhe në përqindje të totalit të investimeve (grafikët nr. 23 dhe 24 në Aneks 14 dhe Aneks 15).

Referuar vlerave të grafikut në përqindje, rezulton se në sektor janë disbursuar nga 0% fonde për projektet e planifikuara në bashkinë Memaliaj deri në 10.35% fonde për projektet e planifikuara në bashkinë Mat. Shoqëritë/bashkitë më të financuara gjatë vitit 2022, jepen në detaje, përkatësisht Mat (10,35%), Kolonjë (6,44%), Pogradec (5,81%), Dibër (5,71%), Durrës (5,46%), Kamëz (4,83%), Finiq (3,80%), dhe Kurbin (3,49%).

Vlera e konsiderueshme e investimeve për këto shoqëri ka ardhur si rezultat i kompleksitetit të projektit për të zgjidhur përfundimisht problemet e furnizimit me ujë në bashkitë përkatëse të tyre sipas planit strategjik të qeverisë shqiptare për furnizimin me ujë 24 orë/ditë për qendrat urbane.

Shpërndarja në mënyrë të zhdrejtë e financimeve të sektorit për vitin 2022, sipas AKUM, lidhet gjithashtu me zonat të cilat gjatë viteve të fundit kanë përfituar më pak investime se të tjerat si bashkitë Dibër, Mat dhe Kolonjë. Gjithashtu përfituese kanë qenë zonat me prioritet turizmin si bashkitë Durrës dhe Pogradec si dhe zonat ku projektet që po zhvillohen kanë impakt të lartë në mbulimin e popullsisë me shërbim si në rastin e bashkisë Kamëz.

Tabela nr.10. Vlerat e investimeve të ndara në investime fizike dhe ato për studim-projektim-mbikëqyrje punimesh për secilën shoqëri më vete në bashkitë përkatëse për vitin 2022

Nr.	Shoqëria UK	Investime fizike	Studim-Projektim-Supervizion	Vlera e Financuar Viti 2022 (në Lekë pa TVSH)	Vlera (në % mbi Totalin)
1	Belsh	139,710,342	1,313,588	141,023,929	2.28%
2	Berat-Kuçove	187,500,000	18,943,862	206,443,862	3.34%
3	Bulqizë	131,115,789	1,420,262	132,536,051	2.15%
4	Cërrik	62,923,257	1,478,137	64,401,393	1.04%
5	Delvinë	4,237,310	326,496	4,563,806	0.07%
6	Devoll	66,813,764	1,461,122	68,274,886	1.11%
7	Dibër	351,162,187	1,291,667	352,453,853	5.71%
8	Divjakë	16,666,667	250,000	16,916,667	0.27%
9	Dropull	143,798,648	2,410,804	146,209,452	2.37%
10	Durrës	305,716,101	31,579,633	337,295,734	5.46%
11	Elbasan	90,000,000	6,849,276	96,849,276	1.57%
12	Fier	57,411,191	192,239	57,603,430	0.93%
13	Finiq	232,214,268	2,218,370	234,432,638	3.80%
14	Gjirokastër	49,985,000	541,667	50,526,667	0.82%
15	Gramsh	4,480,180	2,559,271	7,039,451	0.11%
16	Has	8,333,333	666,667	9,000,000	0.15%
17	Himare	78,921,600	1,109,965	80,031,565	1.30%
18	Kamëz	295,833,333	2,250,000	298,083,333	4.83%
19	Kavajë	77,804,939	1,052,861	78,857,800	1.28%
20	Këlcyrë	63,417,523	701,770	64,119,293	1.04%
21	Klos	15,963,502	313,762	16,277,263	0.26%
22	Kolonjë	394,885,567	2,867,184	397,752,751	6.44%
23	Konispol	34,861,350	444,515	35,305,865	0.57%
24	Korçë	31,760,878	936,311	32,697,188	0.53%
25	Krujë	62,500,000	291,667	62,791,667	1.02%
26	Kukës	25,000,000	8,138,889	33,138,889	0.54%
27	Kurbin	213,774,377	1,652,350	215,426,727	3.49%
28	Lezhë	142,969,358	1,132,397	144,101,754	2.33%
29	Libohovë	66,666,627	750,000	67,416,627	1.09%

30	Librazhd	8,333,333	0	8,333,333	0.13%
31	Lushnje	82,500,000	666,667	83,166,667	1.35%
32	Malësi e Madhe	50,000,000	833,139	50,833,139	0.82%
33	Maliq	66,666,667	375,000	67,041,667	1.09%
34	Mallakastër	61,738,847	10,109,457	71,848,304	1.16%
35	Mat	635,955,310	2,967,987	638,923,297	10.35%
36	Memaliaj	0	0	0	0.00%
37	Mirditë	16,666,667	291,667	16,958,333	0.27%
38	Patos	129,166,667	895,435	130,062,102	2.11%
39	Peqin	68,415,603	1,650,000	70,065,603	1.13%
40	Përmet	59,687,518	473,076	60,160,594	0.97%
41	Pogradec	353,661,124	5,313,562	358,974,686	5.81%
42	Poliçan	150,000,000	1,250,000	151,250,000	2.45%
43	Prrenjas	40,376,055	1,187,703	41,563,758	0.67%
44	Pukë	26,413,823	558,569	26,972,392	0.44%
45	Pustec	29,166,667	416,667	29,583,333	0.48%
46	Roskovec	25,000,000	83,333	25,083,333	0.41%
47	Rrogozhinë	82,986,377	1,330,016	84,316,393	1.37%
48	Sarandë	143,963,674	3,087,304	147,050,978	2.38%
49	Selenicë	21,045,816	2,416,667	23,462,483	0.38%
50	Shijak	101,435,008	987,779	102,422,788	1.66%
51	Skrapar	77,674,239	7,568,551	85,242,790	1.38%
52	Tepelenë	82,376,861	1,371,711	83,748,572	1.36%
53	Tiranë	108,333,333	666,667	109,000,000	1.76%
54	Tropojë	25,000,000	500,000	25,500,000	0.41%
55	Ura - Vajgurore	38,971,521	1,199,818	40,171,339	0.65%
56	Vau Dejës	28,639,413	166,667	28,806,079	0.47%
57	Vlorë	145,833,333	3,805,556	149,638,889	2.42%
58	Vorë	12,284,133	2,083,333	14,367,467	0.23%
Totali		6,028,719,075	147,401,057	6,176,120,132	100%

Në tabelën nr.11 jepen të gjitha kontratat që AKUM ka lidhur për zbatimin e investimeve me shoqëritë/bashkitë përkatëse. Referuar kësaj tablele, vihet re se në total janë rreth 340 kontrata investimesh të planifikuara për sektorin UK gjatë periudhës 2019-2023, të cilat përfshijnë investime në 59 bashki të vendit. Nga totali prej 340 kontratash investimesh të planifikuara, rezulton se 184 prej tyre kanë përfunduar brenda afateve të përcaktuara, ndërsa 156 kontrata mbeten akoma në proces. Nga totali i kontratave të mbetura në proces rezulton se 127 prej tyre u ka kaluar afati i parashikuar kontraktual. Më të evidentuarat paraqiten, përkatësisht shoqëritë UK: Kavajë (6/7), Peqin (8/10), Kamëz (6/8), Mallakastër (4/7), Vlorë (7/13), Sarandë (6/10), Tiranë (4/6), Belsh (4/8), Bulqizë (4/12), Dropull (4/8), Himarë (4/8), Mat (4/12), dhe Tepelenë (4/8).

Këto mosrealizime kanë ardhur për shkak të rrethanave objektive të paparashikuara në kontratat e firmosura referuar specifikave të ndryshme që ka secili projekt, por kryesisht ato lidhen me vonesat nga procesi i shpronësimeve, si dhe nga mbivendosjet e projekteve të tjera të infrastrukturës financuar nga bashkitë përkatëse, kryesisht ato rrugore, sistemime trotuaresh etj.

Për sa më sipër në çdo rast autoritetet kontraktuese nuk kanë aplikuar penalitete për kompanitë zbatuese të këtyre projekteve, por janë firmosur amendamente të këtyre kontratave në mënyrë që të justifikohen në mënyrë objektive dhe ligjore këto vonesa që kanë ndodhur gjatë zbatimit të tyre.

Tabela nr.11. Kontratat e lidhura nga AKUM për zbatimin e investimeve me shoqëritë/bashkitë

Nr.	Shoqëria UK	Nr. i Kontratave	Të Përfunduara	Në Proces	Tejkaluar Afati
1	Belsh	8	4	4	4
2	Berat-Kuçovë	8	6	2	2
3	Bulqizë	12	6	6	4
4	Cërrik	4	2	2	2
5	Delvinë	2	2	0	0
6	Devoll	6	4	2	2
7	Dibër	8	4	4	2
8	Divjakë	2	0	2	0
9	Dropull	8	4	4	4
10	Durrës	15	13	2	2
11	Elbasan	7	5	2	2
12	Fier	4	4	0	0
13	Finiq	6	4	2	2
14	Gjirokastër	2	2	0	0
15	Gramsh	4	4	0	0
16	Has	2	0	2	2
17	Himarë	8	4	4	4
18	Kamëz	8	2	6	6
19	Kavajë	7	1	6	6
20	Këlcyrë	6	6	0	0
21	Klos	6	2	4	2
22	Kolonjë	12	8	4	2
23	Konispol	5	5	0	0
24	Korçë	4	4	0	0
25	Krujë	4	2	2	2
26	Kukës	4	2	2	2
27	Kurbini	7	3	4	2
28	Lezhë	6	2	4	2
29	Libohovë	2	0	2	2
30	Librazhd	2	0	2	2
31	Lushnje	8	6	2	2
32	Malësi e Madhe	4	4	0	0
33	Maliq	2	2	0	0
34	Mallakastër	7	3	4	4
35	Mat	12	2	10	4
36	Memaliaj	5	1	4	0
37	Mirditë	2	0	2	2
38	Patos	4	2	2	2
39	Peqin	10	2	8	8
40	Përmet	6	6	0	0
41	Pogradec	13	7	6	6
42	Poliçan	4	2	2	2
43	Prrrenjas	2	2	0	0
44	Pukë	4	2	2	2
45	Pustec	2	0	2	2
46	Roskovec	2	0	2	2
47	Rrogozhinë	11	7	4	4
48	Sarandë	10	4	6	6
49	Selenicë	3	3	0	0
50	Shijak	6	4	2	2
51	Skrapar	5	3	2	2
52	Tepelenë	8	2	6	4
53	Tiranë	6	2	4	4
54	Tropojë	2	0	2	2
55	Ura - Vajgurore	4	4	0	0
56	Vau Dejës	4	2	2	0
57	Vlorë	13	5	8	7
58	Vorë	2	2	0	0
Totali		340	184	156	127

1.3 Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave të Raportuara nga Shoqëritë UK

Saktësia e të dhënave të raportuara është një element kyç në hartimin e Raporti të Performancës së shoqërive UK i cili është një dokument unik në sektor që publikohet çdo vit nga ERRU në fund të muajit qershor. Të dhënat e shoqërive dorëzohen deri në fund të muajit prill pas mbylljes së bilanceve financiare në fund të mars 2022 në mënyre që t'i lihet shoqërive një kohë minimale e mundshme gjatë vitit për zbatimin e rekomandimeve që rrjedhin nga ky raport në lidhje me performancën dhe problematikën e sektorit në vitin 2022.

Raporti merr një rëndësi të veçantë pasi përveç se u shërben shoqërive UK për të parë performancën e tyre dhe për ta krahasuar atë me shoqëritë e tjera, shërben edhe si një dokument referues për të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e ujit si qeveria qendrore dhe donatorët.

Raporti Performancës për të katërtin vit radhazi është hartuar duke u bazuar në të dhënat që shoqëritë UK kanë raportuar pranë sektorit të monitorimit të ERRU në vijim të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator Nr. 31, datë 28.06.2019 mbi "Platformën e Data Bazës për Grumbullimin e të Dhënave nga Shoqëritë Ujësjetës Kanalizime".

ERRU, në drejtim të forcimit të rolit të tij monitorues ka vijuar vit pas viti duke intensifikuar kërkesën e llogarisë ndaj shoqërive UK. Kështu gjatë vitit 2022 janë realizuar takime të drejtpërdrejta në terren me 26 shoqëri UK që paraqesin probleme në drejtim të raportimit korrekt të të dhënave pranë ERRU-së.

Gjatë takimeve, ERRU, përpos verifikimit dhe saktësisë së të dhënave të raportuara u fokusua edhe në nevojën për trajnimin e stafeve në plotësimin e saktë dhe korrekt të formularit të data bazës. Kjo si rezultat i ndryshimit të shpeshtë të stafeve përgjegjëse për plotësimin dhe raportimin e të dhënave, i cili është një ndër faktorët kryesorë ndikues në pasaktësinë e informacionit të dhënë.

ERRU, u rekomandoj drejtuesve të shoqërive UK nevojën për caktimin e një personi përgjegjës për raportimin e të dhënave tekniko ekonomike pranë ERRU dhe çdo institucioni tjetër të interesuar në mënyrë që të dhënat e raportuara prej tyre të jenë të njëjta për secilën palë duke pasqyruar kështu situatën reale të shoqërisë.

Megjithë asistencën e dhënë ndaj shoqërive UK, si në takime të drejtpërdrejta me drejtuesit dhe personat kyç të shoqërisë ashtu edhe në komunikimet e shpeshta telefonike dhe elektronike me to, saktësia dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara mbetet akoma një sfidë për sektorin UK.

Pasaktësi jo të vogla konstatohen në drejtim të të dhënave tekniko-ekonomike si në bilancet e ujit që shoqëritë dorëzojnë pranë ERRU-së të cilët hartohen me vlerësime dhe jo me instrumenta matëse. Kjo kryesisht për shkak të mungesës së ujëmatësve të mëdhenj në pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë. Si rezultat Uji Pa të Ardhura si treguesi kryesor i performancës së sektorit, mund të rezultojë me shkallë relativisht jo të vogël pasaktësie. Gjithashtu pasaktësi konstatohen edhe në raportimet që bëjnë shoqëritë në drejtim të arkëtimeve të detyrimeve korrente dhe atyre të prapambetura mbi bazën e të cilave llogariten treguesit e Norma e Arkëtimit Korrente dhe ajo e Përgjithshme.

Për të nxitur saktësinë dhe përmirësimin e besueshmërisë së bazës së të dhënave të raportuara nga shoqëritë UK, ERRU, në metodologjinë re të tarifave të miratuar në fund të vitit 2021, ka përfshirë në një kapitull të veçantë "Sistemet e Informacionit" ku paraqiten në mënyrë të detajuar të gjitha kërkesat specifike për mbajtjen e informacionit të krijuar nga shoqëria kur aplikojnë për tarifa të reja si kusht i domosdoshëm për një analizë objektive të performancës së sektorit dhe të vendosjes së objektivave në të ardhmen.

2 Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime

2.1 Ndarja sipas Grupimeve të Shoqërive UK

Monitorimi dhe vlerësimi krahasues i performancës së shoqërive ujësjiellës kanalizime është i bazuar në 12 tregues kryesorë të performancës të miratuara nga Komisioni Kombëtar Rregullator, por në raport do të analizohen 9 tregues pasi Norma e Arkëtimit Korrente dhe Norma Totale përmbliken në një tregues ndërsa dy treguesit e tjerë Eficienca e Energjisë dhe Ankesat e Klientëve janë tregues të rinj të cilët paraqiten për herë të parë në këtë raport dhe për efekt krahasimi me vitin paraardhës nuk do të merren në analizë për vitin 2022.

Treguesit kryesor të Performancës janë përzgjedhur duke patur parasysh nevojën për përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare, ku përparësi u është dhënë atyre treguesve që vlerësojnë situatën ekonomike të shoqërive, kapacitetet aktuale menaxhuese si dhe shërbimin ndaj konsumatorëve.

Nëpërmjet këtyre treguesve janë analizuar dhe vlerësuar drejtimet më të rëndësishme të performancës së operatorëve që tregon dhe nivelin e cilësisë së ofruar të shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Viti 2022 shënoj një ngjarje të rëndësishme në sektorin e ujit në Shqipëri siç është ajo e reformës së ujit e cila e agregon sektorin UK në 15 shoqëri UK rajonale nga 58 të tilla që operojnë në sektor, të krijuara si Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta (SKP) dhe të regjistruara si shoqëri UK Rajonale. Në vijim të reformës, deri në mbyllje të vitit 2022 janë krijuar 12 shoqëri UK Rajonale.

Duke qenë se ndryshimet në sektor si rezultat i reformës kanë ndodhur në fund të vitit 2022, për efekt krahasimi me vitin paraardhës, analiza e shoqërive në këtë raport do të realizohet sipas 58 shoqërive UK ekzistuese pasi efektet e ndryshimit kanë filluar në fillim të vitit 2023 dhe bilanci financiar të shoqërive për vitin 2022, janë mbyllur të veçanta për secilën prej tyre.

Metodologjia e përdorur në këtë raport performance për efekt krahasimi edhe për këtë vit mbetet e njëjtë, si për ndarjen në grupe të shoqërive, ashtu dhe në vlerësimin e treguesve të tyre. Tabela 12 jep tre grupimet e shoqërive UK sipas madhësisë (numrit të lidhjeve).

Gjithashtu në Aneks 10 në tabelën 50, jepen të detajuara të gjithë Treguesit Kryesorë të Performancës për secilën shoqëri UK më vete sipas grupimeve.

Tabela nr.12. Grupimet e Shoqërive Sipas Numrit të Lidhjeve

	Madhësia e shoqërisë (numri i lidhjeve)	Numri i shoqërive në grup	Numri i shoqërive që do të analizohen në grup
Grupi 1	> 15,000 lidhje ujësjiellës kanalizime	14	14
Grupi 2	3,000 - 15,000 lidhje ujësjiellës kanalizime	31	31
Grupi 3	< 3,000 lidhje ujësjiellës kanalizime	13	13

Burimi ERRU

Për vitin 2022 ka një ndryshim në grupet e renditjes së shoqërive krahasuar me vitin paraardhës, bazuar në kriterin e numrit të lidhjeve për klasifikimin e shoqërive.

Konkretisht në grupin e tretë janë shtuar dy shoqëri, të cilat vinë nga grupi i dytë përkatësisht UK Vau i Dejës dhe UK Poliçan për shkak të uljes të numrit të lidhjeve krahasuar me një vit më parë . Në detaje numri i lidhjeve për çdo shoqëri në secilin grup jepet në Tabelën 13.

Tabela nr.13. Numri i lidhjeve për çdo Shoqëri sipas Grupimeve

Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)	Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)
Grupi 1			Grupi 2 (vazhdimi)		
UK	Tiranë	265,159	UK	Bulqizë	5,856
UK	Durrës	93,633	UK	Rrogozhinë	5,644
UK	Vlorë	60,083	UK	Vorë	5,271
UK	Elbasan	40,060	UK	Përmet	4,892
UK	Fier	36,993	UK	Dropull	4,550
UK	Korçë	33,486	UK	Ura Vajgurore	4,473
UK	Shkodër	33,166	UK	Selenicë	4,443
UK	Berat -Kuçovë	29,944	UK	Ersekë	4,363
UK	Kavajë	26,334	UK	Skrapar	3,977
UK	Kamëz	25,898	UK	Peqin	6,960
UK	Lushnje	23,555	UK	Tropojë	3,646
UK	Sarandë	20,908	UK	Roskovec	3,293
UK	Lezhë	19,219	UK	Mirditë	3,275
UK	Pogradec	18,937	UK	Delvinë	3,192
Grupi 2			Grupi 3		
UK	Gjirokastër	13,442	UK	Vau i Dejës	2,942
UK	Dibër	10,442	UK	Tepelenë	2,900
UK	Maliq	10,306	UK	Poliçani	2,836
U	Devoll	9,163	U	Finiq	2,750
UK	Cërrik	8,359	U	Konispol	2,440
UK	Kurbin	7,462	U	Klos	2,106
UK	Belsh	7,382	UK	Memaliaj	2,024
UK	Kukës	7,184	UK	Pukë	1,854
UK	Librazhd	7,136	U	Këlcyrë	1,771
UK	Mat	6,639	U	Has	1,650
U	Divjake	6,607	U	Libohovë	1,554
UK	Himarë	6,359	UK	Pustec	817
UK	Krujë	6,152	UK	Fushë Arrëz	783
UK	Patos	6,091			
UK	Malësi e Madhe	6,001			
UK	Mallakastër	5,894			
U	Gramsh	5,877			

Burimi ERRU

2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU

Për efekt të analizës për secilin TKP, ERRU ka përcaktuar objektivat e synuar (që duhen arritur nga shoqëritë UK) për vlerësimin e performancës. Në grafikët e analizës së performancës së çdo treguesi vija e verdhë tregon nivelin e objektivit të synuar për arritjen e një performance të mirë, gjithçka poshtë vijës së kuqe tregon performancë të dobët. Segmenti ndërmjet dy vijave konsiderohet performancë e “pranueshme”, që tregon nga njëra anë përpjekjet e bëra nga shoqëritë dhe nga ana tjetër domosdoshmërinë për përmirësime të mëtejshme. Në tabelën nr. 14 tregohen kufijtë minimal dhe maksimal të përcaktuar për secilin TKP, të cilët në vijim të ndryshimeve në sektor si rezultat i reformës, për vitin në vijim do të jenë objekt rishikimi në përshtatje me kërkesat e kohës. Në grafikun 1 më poshtë është një shembull i grafikëve të analizës së TKP-ve.

Figura 1. Grafik i Analizës së TKP-ve




Tabela nr.14. Objektivat për TKP të Vendosura nga ERRU

Treguesit Kryesorë të Performancës		Objektivat nga ERRU		
		Mirë	Pranueshëm	Dobët
1 – Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	80 - 100%	≤ 80%
2 – Mbulimi i Kostos Totale		≥ 80%	50 - 80%	≤ 50%
3 – Norma e Arkëtimit		≥ 82%	60 - 82%	≤ 60%
4 – Eficienca e Stafit (numri i stafit për 1000 lidhje) ¹	Grupi 1	≤ 4	4 - 6	≥ 6
	Grupi 2	≤ 6	6 - 10	≥ 10
	Grupi 3	≤ 10	10 - 15	≥ 15
5 – Uji Pa të Ardhura		≤ 30%	30 - 50%	≥ 50%
6 – Niveli i Matjes		≥ 85%	n/a	<85
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥18 orë/ditë	8 - 18 orë/ditë	≤8 orë/ditë
8 – Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	50 - 75%	≤ 50%

¹ Për TKP Eficienca e Stafit, objektivi i benchmarking është më i lartë për shoqëritë e vogla, duke marrë parasysh faktin që shoqëritë më të mëdha (të cilat u shërbejnë zakonisht zonave me densitet popullsi më të madhe) e kanë më të lehtë të mbajnë më të ulët numrin e stafit për 1000 lidhje.

2.3 Treguesit Kryesorë të Performancës

2.3.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)

“Ujë Pa të Ardhura” konsiderohet sasia e ujit që humbet nga vëllimi total i ujit të prodhuar i cili nuk ju faturohet klientëve. Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues, shpërndarës etj.).

Gjatë vitit 2022, treguesi “Ujë Pa të Ardhura” në nivelin 63.7% rezultoi i përmirësuar si pasojë e reduktimit të prodhimit me rreth 1.1 milion m³ si dhe rritjes së faturimit total me rreth 2.8 milion m³.

Pengesë për përmirësimin e treguesit me ritme më të larta paraqesin kryesisht “Lidhjet e shumta të paligjshme” në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, niveli i ulët i matjes në variablat “Ujë i Prodhuar” dhe “Faturimi Total”, sistemet e vjetra të cilat duhen zëvendësuar me të reja, “kualifikimi jo i duhur i stafit teknik” lidhur me humbjet etj.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2022




Figura 2. Uji Pa të Ardhura për Grupin e I-rë, viti 2022

Për vitin 2022, shoqëria me nivelin më të ulët të UPA në grupin e I-rë u paraqit sha UK Korçë (30%). Me nivelin 30-50% të Benchmarking performuan shoqëritë UK Lezhë (37.40%), UK Pogradec (38.90%) dhe

Sarandë (43.10%). Shoqëria UK Berat-Kuçovë me nivelin e UPA (53.80%) raportoi përmirësim të ndjeshëm të treguesit me (-11.30%) si rezultat i reduktimit të prodhimit vjetor me rreth 2 milion m³ si dhe investimeve të reja të kryera viteve të fundit.

Për përmirësim të treguesit UPA spikatën edhe shoqëritë UK Elbasan (-4.50%), UK Fier (-4.50) , UK Durrës (-2.50%), UK Kavajë (-2.40%), UK Lushnje (- 1.9%) etj.

Me nivelin mbi 50% të treguesit UPA performuan 10 nga 14 shoqëri të këtij grupi. Përpjekje për reduktim të UPA konstatohet në disa shoqëri, por ende duhet shumë punë dhe investime për të arritur objektivat e vendosura.

Përkeqësim i treguesit UPA vërehet në shoqëritë UK Kamëz me (+ 2.4%), UK Tiranë me (+1.1%) etj.

Tabela nr. 15. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Berat - Kuçovë	UK	65.10	53.80	-11.30
2	Elbasan	UK	74.20	69.70	-4.50
3	Fier	UK	75.30	70.80	-4.50
4	Durrës	UK	79.20	76.70	-2.50
5	Kavajë	UK	64.70	62.30	-2.40
6	Lushnje	UK	71.20	69.30	-1.90
7	Shkodër	UK	69.20	69.00	-0.20
8	Vlorë	UK	76.20	76.10	-0.10
9	Lezhë	UK	37.50	37.40	-0.10
10	Pogradec	UK	38.70	38.90	0.20
11	Korçë	UK	29.50	30.00	0.50
12	Sarandë	UK	42.30	43.10	0.80
13	Tiranë	UK	58.70	59.80	1.10
14	Kamëz	UK	70.80	73.20	2.40

Grupi 2 - Uji pa të Ardhura (%)




Figura 3. Uji Pa të Ardhura për Grupin e II-të, viti 2022

Në grupin e dytë të shoqërive vetëm UK Kolonjë raportoi nivelin e UPA nën kufirin 30% të Benchmarking. Nga 31 shoqëri në grup, 13 prej tyre performuan në nivelin e UPA nga 30-50%, ndërsa pjesa e mbetur performuan dobët me nivel të UPA mbi 50%.

Analiza e të dhënave të raportuara nga shoqëritë e grupit të dytë tregoi se në disa prej tyre treguesi UPA luhetet në nivele të pabesueshme si pasojë e nivelit të ulët të matjes në variablat “ujë i prodhuar”, “ujë i faturuar” si dhe monitorimit jo korrekt të sistemeve të furnizimit gjatë gjithë vitit kalendarik. Në grafikun e hartuar për grupin e dytë, vërehet qartë luhajtja e treguesit UPA në nivele të cilat e bëjnë të pabesueshëm treguesin për shoqëritë UK Roskovec, UK Kurbin, UK Dropull, UK Bulqizë, UK Skrapar etj.

Me nivelin më të lartë të Ujit Pa të Ardhura u paraqiten UK Kurbin (80.70%), UK Mirditë (70.20%), UK Selenicë (76 %), UK Vorë (70.0%), UK Krujë (68.9%), UK Divjakë (67.7%), UK Himarë (68.3%) etj.

Më poshtë në tabelën 16, jepet ecuria e treguesit Uji Pa të Ardhura për dy vitet e fundit për shoqëritë e Grupit të II-të

Tabela nr.16. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Roskovec	UK	65.10	38.90	-26.20
2	Patos	UK	73.30	59.70	-13.60
3	Dibër	UK	56.10	46.10	-10.00
4	Malësi e Madhe	UK	51.20	42.10	-9.10
5	Skrapar	UK	60.20	51.20	-9.00
6	Selenicë	UK	84.10	76.00	-8.10
7	Bulqizë	UK	46.30	38.40	-7.90
8	Kukës	UK	54.50	48.10	-6.40
9	Cërrik	UK	70.40	64.30	-6.10
10	Përmet	UK	35.20	33.70	-1.50
11	Gjirokastër	UK	40.60	39.40	-1.20
12	Maliq	UK	40.30	39.40	-0.90
13	Ura Vajgurore	UK	54.90	54.00	-0.90
14	Rrogozhinë	UK	62.10	61.40	-0.70
15	Himarë	UK	68.70	68.30	-0.40
16	Delvinë	UK	46.30	46.20	-0.10
17	Vorë	UK	70.00	70.00	0.00
18	Peqin	UK	66.60	66.70	0.10
19	Mallakastër	UK	58.80	59.20	0.40
20	Gramsh	UK	38.40	38.90	0.50
21	Kolonjë	UK	26.60	27.30	0.70
22	Belsh	UK	33.00	34.30	1.30
23	Krujë	UK	67.50	68.90	1.40
24	Divjakë	UK	65.70	67.70	2.00
25	Librazhd	UK	46.80	50.50	3.70
26	Devoll	UK	31.70	37.30	5.60
27	Tropojë	UK	47.20	56.40	9.20
28	Mat	UK	42.10	51.50	9.40
29	Dropull	UK	27.70	39.90	12.20
30	Mirditë	UK	55.80	70.20	14.40
31	Kurbin	UK	49.10	80.70	31.60

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2022

Niveli i UPA për Grupin e III-të të shoqërive konstatohet në nivelin 60.8%. Nga 13 shoqëri UK, vetëm shoqëria UK Konispol (26.50%) ka performuar nën kufirin 30% të treguesit. Me nivel të UPA nga 30-50% u paraqiten pesë shoqëri UK, ndërsa pjesa e mbetur performon dobët mbi nivelin 50% të Benchmarking.

Me nivelin më të lartë të UPA u paraqitën shoqëritë UK Këlcyrë (76.4%), UK Pukë (75.6%), UK Finiq (73.9%), UK Libohovë (72.6%) etj.

Krahasuar me të dhënat e raportuara për vitin 2021, përmirësimi i treguesit UPA rezultoi në shtatë shoqëri të grupit; UK Poliçan (-14.20%), UK Fushë Arrëz (-10.70%), UK Tepelenë (-5.20%), UK Pustec (-2.50%) etj. Përmirësimi i treguesit UPA kryesisht ka ndodhur si pasojë e investimeve të reja të kryera në sistemet e furnizimit gjatë viteve të fundit. Për ndonjë nga shoqëritë UK, niveli i treguesit duhet marrë me rezervë pasi në shumë prej tyre prodhimi dhe faturimi vlerësohet dhe për pasojë mundësia për të gabuar është më e madhe.

Për shoqërinë UK Klos treguesi UPA i përkeqësuar me (+31.3%) është i pabesueshëm dhe me luhatje të mëdha për tre vitet e fundit. Shoqëria duhet të tregohet e kujdesshme në përlllogaritjen e variabëlve “ujë i prodhuar” dhe “volumet e faturuara aforfe”.

Grupi 3 - Uji pa të Ardhura (%)




Figura 4. Uji Pa të Ardhura për Grupin e III-të, viti 2022

Tabela nr.17. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Poliçan	UK	46.10	31.90	-14.20
2	Fushë Arrëz	UK	53.50	42.80	-10.70
3	Tepelenë	UK	35.70	30.50	-5.20
4	Pustec	UK	42.10	39.60	-2.50
5	Finiq	UK	76.10	73.90	-2.20
6	Këlcyrë	UK	77.40	76.40	-1.00
7	Konispol	UK	26.70	26.50	-0.20
8	Libohovë	UK	71.80	72.60	0.80
9	Pukë	UK	74.20	75.60	1.40
10	Has	UK	54.40	58.40	4.00
11	Vau i Dejës	UK	61.00	65.30	4.30
12	Memaliaj	UK	27.36	34.60	7.24
13	Klos	UK	26.60	57.90	31.30

Përfundime

- **Niveli i Ujit Pa të Ardhura për vitin 2022 rezultoi në nivelin 63.7%.** Nga 58 shoqëri që ushtrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, vetëm tre shoqëri performuan nën kufirin 30% të performancës së mirë, 21 prej tyre performuan brenda kufirit 30-50% dhe 34 të tjera performuan mbi kufirin 50% të Benchmarking.
- “Uji i prodhuar” që hyn në sistemin e shpërndarjes u realizua në sasinë **310.1 milion m³**, nga të cilat 55% rezultoi i matur dhe 45% i vlerësuar. Reduktimi i prodhimit me (- 1.1 milion m³) dhe rritja e Faturimit Total me (+2.8 milion m³) janë faktorët kryesor në përmirësimin e treguesit UPA.
- Pengesë në procesin për përmirësimin e treguesit paraqitën kryesisht “Lidhjet e shumta të paligjshme” në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, niveli i ulët i matjes në variablat “Ujë i Prodhuar” dhe “Faturimi Total”, sistemet e vjetra të furnizimit, “kualifikimi jo i duhur i stafit teknik” lidhur me humbjet etj.
- Për përcaktimin real të UPA, rrjetet shpërndarëse në sektor kërkohet që të jenë të seksionuara me zona të mbyllura të matura (DMA) në përputhje me modele hidraulike të tyre që lejojnë vlerësimin dhe kontrollin e humbjeve. Vëmendje të veçantë duhet t’i kushtohet zbulimit dhe eliminimit të lidhjeve të paligjshme, futjes në sistem të klientëve të rinj, saktësimin të të dhënave vjetore si dhe investimet në ujëmatës për pikat e prodhimit dhe për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.
- Niveli i matjes në prodhim ende rezulton në nivele jo të kënaqshme . Rritja e këtij treguesi nëpërmjet instalimit të ujëmatësve në të gjitha pikat kyçe të prodhimit saktëson të dhënat mbi “Ujin e prodhuar”, mbron burimet ujore nga mbi konsumi si dhe lejon shfrytëzimin e tyre në përputhje me kërkesën standarde për ujë.
- “Bilanci i Ujit” për disa nga shoqëritë nuk konceptohet si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e humbjeve të ujit. Kërkohet që bilanci i ujit, të hartohet bazuar në të dhëna të sakta të cilat do të jenë përcaktues në “planet e veprimeve” të cilat paraqiten në çdo plan biznesi të hartuar nga shoqëritë.
- Të kryhen investime për përmirësimin e situatës teknike të sistemeve të vjetruara të furnizimit bazuar në planin e menaxhimit të aseteve.
- ERRU, sugjeron të gjitha shoqëritë UK për rritjen e kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve për stafin teknik, në drejtim të menaxhimit të veprimtarisë së tyre dhe veçanërisht për UPA.

2.3.2 Mbulimi i Kostove O&M

“Mbulimi i Kostove O&M” është një nga treguesi i performancës financiare, i cili paraqet raportin me të cilin të ardhurat e realizuara nga aktiviteti mbulojnë kostot operative që nevojiten për funksionimin e aktivitetit. Në të përfshihen vetëm kostot që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen dhe përjashtohen kostot e amortizimit, huave dhe kostot financiare.

Për vitin 2022, niveli mesatar i këtij treguesi për gjithë sektorin UK është 90.3% nga 103.4% që ishte në vitin paraardhës duke shënuar një rënie me 13.1%.

Niveli nën 100% i këtij treguesi të performancës, tregon se sektori me të ardhurat e faturuara nuk arrin të mbulojë kostot operative. Për vitin 2022 janë 45 shoqëri nga totali prej 58 që nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M me të ardhurat, të cilat vazhdojnë të subvencionohen plotësisht ose pjesërisht nga qeveria qendrore me anë të AKUM-it. Ndikimin kryesor të këtij rezultati e jep Grupi i I-rë i shoqërive UK në të cilën

6 prej tyre e mbulojnë koston O&M dhe Grupi i II-të ku përfshihen 7 shoqëri UK që kalojnë nivelin mbi 100% të këtij treguesi të performancës. Në kuadër të reformës krijimi i shoqërive rajonale duke bashkuar shoqëritë në vështirësi financiare me shoqëritë në gjendje të qëndrueshme financiare, pritet që në disa raste të ndikojë pozitivisht duke zvogëluar/eliminuar subvencionet nga qeveria qendrore e shoqërive UK për shlyerjen e kostove operative të vitit ushtrimor dhe duke u përqendruar në investime të cilat duhet të sjellin optimizimin e kostove, rritjen e sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve.

ERRU konstaton se, për vitin 2022, në sektor janë 13 shoqëri që kanë këtë tregues mbi 100%, nga 12 që rezultojnë në vitin 2021. Shoqëritë UK që janë shtuar duke kaluar nivelin e mbulimit 100% janë UK Kukës (nga 78.78% në 108.43%), UK Himara (nga 89.89% në 113.93%).

Shoqëria UK që ka pësuar rënie të këtij treguesi nën 100% është UK Tropojë (nga 115.07% në 91.83%).

Më poshtë ky tregues analizohet në detaje për secilin grup të shoqërive.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2022

Bazuar në kriterin e numrit të lidhjeve për klasifikimin e shoqërive, në Grupin e I-rë, bëjnë pjesë 14 shoqëritë më të mëdha, një pjesë e të cilave kanë disa vite që mbulojnë koston e operimit dhe të mirëmbajtjes mbi 100 %. Realizimi i këtij treguesi për shoqëritë e Grupit të I-rë për vitin 2022 jepet në grafikun e mëposhtëm Figura 5.




Figura 5. Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e I-rë, viti 2022

Siç shihet nga grafiku, 6 nga 14 shoqëritë e këtij grupi përkatësisht: UK Korçë, UK Tiranë, UK Berat-Kuçovë, UK Lezhë, UK Pogradec dhe UK Sarandë megjithëse edhe për vitin 2022 vijojnë të mbeten në nivelin e

performancës së mirë ($\geq 100\%$) të mbulimit të kostove O&M të vendosur nga ERRU, janë me rënie të këtij treguesi krahasuar me vitin 2021.

Përkeqësim të këtij treguesi në nivelet më të larta e kanë dy shoqëri, UK Lezhë dhe UK Korçë me 30.84% dhe 19.44%. Performanca e UK Lezhë ka rënie për shkak të rritjes së kostos së operimit me 34.9 milion lekë dhe rënie të të ardhurave me 5.5 milion lekë, ndërsa performanca e UK Korçë ka rënie sepse rritja e të ardhurave nga aktiviteti (9.8 milion lekë) është më e ulët se rritja e kostove të operimit (32.7 milion lekë).

Në zonën e performancës së dobët për këtë vit janë gjashtë shoqëri të këtij grupi dhe konkretisht UK Durrës (55.5%), UK Kavajë (57.3%), UK Shkodër (62.5%), UK Vlorë (62.6%), UK Kamëz (66.4%) dhe UK Elbasan (67.6%). Këto shoqëri kanë rënie të nivelit të këtij treguesi, përveç UK Kavajë, e cila krahasuar me vitin paraardhës është përmirësuar me 2.11%, por gjithsesi mbetet në nivelin e performancës së dobët të Grupit të I-rë. Vlen të theksohet shoqëria UK Elbasan gjatë vitit paraardhës është pozicionuar në zonën e performancës së pranueshme me 89.77%, por gjatë vitit 2022 ka pësuar një rënie në 67.6% të këtij treguesi, e cila e klasifikon në zonën e performancës së dobët.

Në zonën e performancës së pranueshme (80%-100%) janë dy shoqëri, UK Lushnje (80.2%), UK Fier (84.6%), ku vërehet se këto dy shoqëri kanë pësuar një rënie të nivelit të treguesit mbulimi i kostove O&M përkatësisht me 8.32% dhe 5.17%.

Mbulimi i kostove të O&M për vitin 2022 ka një përkeqësim, i cili është 96.4% nga 113.2% që ishte në vitin 2021. Kjo situatë për Grupin e I-rë ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së kostove operative me +1.56 miliard lekë dhe rritjes së të ardhurave nga aktiviteti me rreth +234.4 milion lekë, pra rritja e kostove ka qenë shumë më e lartë se sa rritja e të ardhurave.

Tabela 18 paraqet ecurinë e treguesit mbulimi i Kostove O&M për dy vitet e fundit.

Tabela nr.18. Ecuria e Treguesit Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Kavajë	UK	55.19	57.30	2.11
2	Fier	UK	89.77	84.60	-5.17
3	Vlorë	UK	70.53	62.60	-7.93
4	Berat - Kuçovë	UK	147.95	139.70	-8.25
5	Lushnje	UK	88.52	80.20	-8.32
6	Tiranë	UK	164.16	155.70	-8.46
7	Pogradec	UK	111.83	103.01	-8.82
8	Kamëz	UK	75.65	66.40	-9.25
9	Sarandë	UK	110.47	101.00	-9.47
10	Shkodër	UK	79.72	62.50	-17.22
11	Durrës	UK	74.45	55.50	-18.95
12	Korçë	UK	173.64	154.20	-19.44
13	Elbasan	UK	89.77	67.60	-22.17
14	Lezhë	UK	144.84	114.00	-30.84

Në grupin e parë të shoqërive, gjatë vitit 2022 krahasuar me vitin 2021 kanë pasur përkeqësim të gjitha shoqëritë përveç UK Kavajë e cila ka pasur një përmirësim të lehtë me 2.11%, si rezultat i përmirësimit në rritje të nivelit të të ardhurave krahasuar me rritjen e nivelit të kostove.

Ecurinë me rënien më të lartë e kryeson UK Lezhë (-30.84%), për shkak të rritjes së kostove operative me 24% dhe uljes së të ardhurave me -3%, pasuar nga UK Elbasan (-22.17%), për shkak të rritjes së kostove operative me 36% kurse të ardhurat nga faturimi pothuajse nuk janë rritur me vetëm 1.21%, gjithashtu dhe UK Korçë ka rënie (-19.44%) për shkak të rritjes së kostove me 16% dhe rritjes së lehtë të të ardhurave me 2.73%. Shoqëritë e tjera janë me rënie më të lehtë.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2022

Referuar klasifikimit mbi numrin e lidhjeve, në Grupin e II-të të shoqërive bëjnë pjesë 31 shoqëri nga 33 që ishin në vitin 2021. Vërehet se në Grupin e II-të shoqërive është larguar UK Poliçan dhe UK Vau i Dejës, bazuar në kriterin e numrit të lidhjeve, kanë kaluar në Grupin e III-të. Evidentohen **shtatë shoqëri** me performancë të mirë, që mbulojnë Kostot O&M me mbi 100%, nga gjashtë shoqëri që ishin në vitin paraardhës. Sipas grafikut në vijim, shoqëria me performancën më të mirë është UK Kolonjë në nivelin 154.5%, e ndjekur nga UK Librazhd me 134.4%, UK Himarë me 113.9%, UK Dibër me 110.9%, UK Kukës me 108.4%, UK Malësi e Madhe me 106.6% dhe UK Gjirokastrë me 105%. Ndër shoqëritë me performancë të mirë vlen të theksohet shoqëria UK Kukës e cila krahasuar me vitin e kaluar që kishte një performancë të dobët me 78.78%, këtë vit ka kaluar në nivelin e performancës së mirë 108.4%, pra me një rritje +29.62%, e cila ka dhe rritjen me të lartë për grupin e II të shoqërive. Përmirësimi i performancës për këtë shoqëri ka ardhur si rezultat i aplikimit për nivel të ri tarifor në dhjetor të 2021. Shoqëria UK Kukës ka realizuar të ardhura më të larta me nivelin e ri tarifor të miratuar nga ERRU në tetor të 2022, me një rritje 18.7% dhe ka ulur kostot operative me 14%.

Nga analiza e mbulimit të kostos O&M vërehet se UK Tropojë ka përkeqësim të nivelit të performancës (nga 115.07% në 91.8%), krahasuar me vitin e kaluar. Gjithashtu janë tre shoqëri të cilat kanë pësuar rënie në performancë të dobët, nën 80% në krahasim me vitin e kaluar të cilat janë UK Gramsh (nga 89.02% në 69.9%), UK Vorë (nga 84.51% në 74.4%) dhe UK Delvinë (nga 83.13% në 79.7%). Kurse dy shoqëritë U Bulqizë (nga 65.38% në 85.6%) dhe UK Roskovec (nga 78.12 në 82%) kanë pësuar rritje të nivelit të performancës mbi 80% krahasuar me vitin 2021 duke kaluar në nivelin e performancës së mirë nga ajo e performancës së dobët.

Grupi 2 - Mbulimi i Kostove O&M (%)




Figura 6. Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e II-të, viti 2022

Në zonën e performancës së dobët, pra me mbulim të kostove O&M nën 80% renditen 18 shoqëri. Shoqëria me performancën më të dobët është UK Kurbini me vetëm 33.8% të mbulimit të kostove O&M. Kjo shoqëri ka një performancë të dobët financiare, pasi të ardhurat kanë një rritje të lehtë me 7% (2.8 milion lekë), ndërsa shpenzimet janë rritur me 12% (13.7 milion lekë).

Sipas grafikut nr. 6, në nivele shumë të ulëta mbulimi të kostove O&M janë dhe UK Kurbini, UK Divjakë, UK Peqin, UK Belsh, UK Skrapar që kryesisht si shkak kryesor kanë nivelin e ulët të tarifave pasi kanë një kohë relativisht të gjatë që nuk kanë aplikuar pranë ERRU-së për nivel të ri tarifor.

Në zonën e performancës së pranueshme, me mbulim të kostove O&M me 80%-100% janë renditur 6 shoqëri, ku krahasuar me vitin 2021 UK Bulqizë ka përmirësimin më të madh të nivelit të këtij treguesi me 20.22% e ndjekur nga UK Roskovec me 3.88%, UK Mat me 3.07%. Shoqëria UK Bulqizë vitin e kaluar ka pasur nivelin e performancës së dobët 65.38%, por në dhjetor të vitit 2021, kjo shoqëri ka aplikuar për nivel të ri tarifor pranë ERRU dhe i është miratuar në tetor 2022, gjatë kësaj periudhe që ka zbatuar nivelin e ri të tarifave ka pasur rritje të të ardhurave me 22.46% dhe ulje të kostove me -6%, kjo performancë e mirë e shoqërisë ka ndikuar automatikisht në rritjen e nivelit të mbulimit të kostove OM në 85.6%, e cila e kategorizon këtë shoqëri në nivelin e performancës së pranueshme.

Tabela nr.19. Ecuria e Mbulimit të Kostove O&M për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Kukës	UK	78.78	108.40	29.62
2	Himarë	UK	89.89	113.90	24.01
3	Bulqizë	U	65.38	85.60	20.22
4	Librazhd	UK	116.48	134.40	17.92
5	Selenicë	U	69.08	78.00	8.92
6	Mirditë	UK	56.64	62.50	5.86
7	Dibër	UK	105.64	110.90	5.26
8	Patos	UK	29.52	34.40	4.88
9	Roskovec	UK	78.12	82.00	3.88
10	Skrapar	UK	55.76	59.10	3.34
11	Mat	UK	90.33	93.40	3.07
12	Devoll	UK	92.22	93.80	1.58
13	Gjirokastër	UK	104.53	105.00	0.47
14	Përmet	U	89.64	89.20	-0.44
15	Cërrik	UK	60.17	59.10	-1.07
16	Kurbin	UK	35.35	33.80	-1.55
17	Malësi e Madhe	UK	108.58	106.60	-1.98
18	Delvinë	UK	83.13	79.70	-3.43
19	Rrogozhinë	UK	62.42	58.60	-3.82
20	Ura Vajgurore	UK	47.64	43.80	-3.84
21	Dropull	UK	68.22	63.00	-5.22
22	Krujë	UK	76.05	69.90	-6.15
23	Divjakë	UK	49.48	41.80	-7.68
24	Maliq	UK	67.59	59.70	-7.89
25	Mallakastër	UK	56.69	47.00	-9.69
26	Vorë	UK	84.51	74.40	-10.11
27	Kolonjë	UK	168.71	154.50	-14.21
28	Belsh	UK	62.31	47.30	-15.01
29	Peqin	UK	61.33	45.40	-15.93
30	Gramsh	U	89.02	69.90	-19.12
31	Tropojë	UK	115.07	91.80	-23.27

Nga 31 shoqëri që bëjnë pjesë në Grupin e II-të, raportohen 13 shoqëri që e kanë përmirësuar treguesin e mbulimit të Kostove të O&M në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.

Përmirësimin më të madh e ka shënuar UK Kukës e cila për vitin 2022 raporton rreth 9.6 milion lekë të ardhura më shumë se viti 2021, duke arritur nivelin e mbulimit të kostove O&M në 108.4% për vitin 2022, nga 78.78% që ishte në vitin 2021. Përmirësim të ndjeshëm kanë shënuar dhe shoqëritë UK Himarë, UK Bulqizë dhe UK Librazhd.

Ndërkohë, shoqëria UK Tropojë ka shënuar rënien më të madhe në mbulimin e kostove O&M në Grupin e II-të me 23.27%, duke e kaluar shoqërinë nga zona e performancës së mirë në zonën e performancës së pranueshme. Kjo situatë për shoqërinë për vitin 2021 ka ardhur si pasojë e rënies së të ardhurave me -3.16% dhe rritjes së kostove me 21%. Rënie të konsiderueshme të këtij treguesi (dy-shifrore) kanë shënuar dhe shoqëritë UK Gramsh, UK Peqin, UK Belsh, UK Kolonjë dhe UK Vorë.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2022

Sipas klasifikimit, në bazë të numrit të lidhjeve deri në 3000 lidhje, në Grupin e III-të për vitin 2022 bëjnë pjesë 13 shoqëri krahasuar me vitin 2021 që ishin 11 shoqëri pasi në këtë grup janë shtuar dy shoqëri si UK Poliçan dhe UK Vau i Dejës që më parë ishin pjesë e grupit të II-të. Vetëm shoqëritë UK Finiq dhe UK Pukë janë në zonën e performancës së pranueshme ndërsa 11 shoqëritë e tjera përfshihen në shoqëritë me performancë të dobët. Megjithatë shoqëritë e këtij grupi në përgjithësi nuk arrijnë të mbulojnë kostot e punës, që konsiderohen si kosto prioritare, influenza negative e tyre në sektor është minimale. Kjo si rezultat i peshës së vogël që kanë në sektor këto shoqëri si pasojë e numrit të vogël të klientëve.




Figura 7. Mbulimi i Kostove O&M Grupi III-të, Viti 2022

Grupi i III-të numëron në total rreth 36 mijë lidhje dhe kostot O&M të këtij grupi llogariten në rreth 3% të kostove O&M të sektorit, pra mund të thuhet që performanca e këtyre shoqërive nuk ka ndikim në sektor. Shoqëria me performancën më të dobët për këtë grup është UK Vau i Dejës që mbulon vetëm 34.6% të Kostove të O&M.

Nga tabela e mëposhtme nr.14 ku jepet ecuria e shoqërive për grupin e III-të, vihet re se shoqëritë e këtij grupi, kanë pasur tendencë pozitive për 7 prej tyre dhe negative për 6 shoqëri. Shoqëria që ka rënien më të madhe të mbulimit të kostove O&M me 20.49% është UK Memaliaj ndërsa rritjen më të madhe e ka shoqëria UK Pustec me +10.79% e ndjekur nga UK Këlcyrë me 10.24%.

Totali i të ardhurave për këtë grup është rritur me tendencë 4.46 milion lekë për shkak të dy shoqërive UK Poliçan dhe UK Vau i Dejës që i janë shtuar këtij grupi duke sjellë dhe rritje në totalit e të ardhurave.

Një ndër faktorët kryesorë në nivelin e ulët të këtij treguesi për këtë grup është edhe fakti se këto shoqëri nuk kanë aktivitet të rregulluar nga ERRU për shkak se një pjesë e tyre nuk kanë tarifa të miratuara nga ERRU.

Kjo situatë pritet të rregullohet në kuadër të reformës për agregimin e sektorit ku shoqëritë e këtij grupi do të bëhen pjesë e shoqërive UK Rajonale.

Tabela nr.20. Ecuria e Mbulimit të Kostove O&M për Grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Pustec	UK	34.91	45.70	10.79
2	Këlcyrë	UK	47.56	57.80	10.24
3	Fushë Arrëz	UK	63.96	72.10	8.14
4	Poliçan	UK	55.26	59.90	4.64
5	Konispol	UK	71.04	74.60	3.56
6	Libohovë	UK	55.44	58.30	2.86
7	Finiq	UK	95.27	97.90	2.63
8	Pukë	UK	91.54	89.50	-2.04
9	Vau i Dejës	UK	37.69	34.60	-3.09
10	Tepelenë	UK	73.93	67.90	-6.03
11	Klos	U	76.72	70.40	-6.32
12	Has	UK	47.71	40.20	-7.51
13	Memaliaj	UK	71.59	51.10	-20.49

Përfundime

- Nga analiza e treguesit “Mbulimi i Kostove O&M” për të tre grupet e shoqërive rezulton se niveli i mbulimit të kostove O&M për vitin 2022 është 90.3%, duke shënuar rënie me 13.1% krahasuar me vitin 2021. Ky përkeqësim i nivelit të këtij treguesi ka ardhur si rezultat i rritjes në përqindje të kostove O&M më lart se rritja në përqindje të të ardhurave, të ardhurat rriten me 3% dhe kostot me 18%.
- “Mbulimi i Kostove O&M” për sektorin në nivelin 90.3% përbën problem të performancës së sektorit pasi në fakt vetëm 13 shoqëri nga totali prej 58 arrijnë të mbulojnë mbi 100% të kostove O&M. Ndërkohë janë 10 shoqëri në nivelin e mbulimit 80%-100% dhe 35 shoqëri në nivelin nën 80%. Në sektor operojnë 10 shoqëri të cilat mbulojnë më pak se 50% të kostove O&M të cilat i përkasin kryesisht shoqërive të Grupit të II-të dhe të III-të pasi nuk kanë aftësi financiare për të përballuar kostot e O&M.
- Për vitin 2022 në sektor rezultojnë 21 shoqëri me tendencën pozitive të këtij treguesi që përbëjnë rreth 36% të shoqërive në sektor dhe 37 shoqëri me tendence negative që përbëjnë rreth 64% të shoqërive në sektor, kjo është arsyeja që niveli i mbulimit të kostos OM për sektorin është me rënie -13.1% në krahasim me vitin paraardhës.
- Nevoja për subvencione është e evidente për sektorin UK për mbulimin e kostove O&M, por me rajonalizimin e shoqërive UK në kuadër të reformës, pritet të reduktohet, pasi shoqëritë në vështirësi financiare do të bashkohen duke ndikuar pozitivisht në treguesit financiarë të performancës në të ardhmen.

- Mbulimi i Kostove O&M është elementi bazë në propozimet e shoqërive për tarifa të reja duke argumentuar në mënyrë të detajuar kostot, si edhe ti raportojnë shpenzimet sipas qendrave të kostos për të orientuar tarifat tek kostot e secilit shërbim më vete. Detajimi i kostove shërben edhe si një element bazë për transparencën ndaj konsumatorëve.

2.3.3 Mbulimi i Kostove Totale

Mbulimi i Kostove Totale për vitin 2022 për të gjithë sektorin UK raportohet në nivelin 66.8% nga 73.9% që ishte në vitin 2021.

Nga 58 shoqëri UK që operojnë në sektor, vetëm tre shoqëri arrijnë të mbulojnë kostot totale të operimit me të ardhurat nga aktiviteti, përkatësisht UK Tiranë në nivelin 116.3% dhe UK Librazhd në nivelin 110.9% dhe UK Dibër në nivelin 105.2%, prandaj për këtë tregues analiza nuk është kryer sipas grupeve të shoqërive, por për sektorin në tërësi.

Në nivelin e performancës (50%-80% e mbulimit të kostos totale) raportohen 24 shoqëri, ndërsa në nivelin e performancës së mirë (mbi 80% e mbulimit të kostos totale) raportohen vetëm 8 shoqëri, tre prej të cilave e kanë nivelin e mbulimit mbi 100% (UK Tiranë, UK Librazhd, UK Dibër).

Pjesa tjetër e shoqërive (23 shoqëri) bëjnë pjesë në brezin e performancës së dobët, me mbulimin e kostove totale deri në 50%, ku ka shoqëri me nivele minimale të mbulimit të kostove si: UK Kurbin (25.4%), UK Has (26.7%), UK Vau i Dejës (27.2%), UK Kamëz (28.8%), UK Patos (32.4%), UK Delvinë (33.6%) dhe UK Memaliaj (35.9%). Disa nga këto shoqëri, por edhe të tjera me të ardhurat e tyre nuk mund të mbulojnë as kostot e punës prandaj të gjitha janë subjekt i subvencioneve të qeverisë qendrore.

Janë 12 shoqëri që kanë pasur tendencë pozitive (mbi 5% rritje) në drejtim të mbulimit të kostove totale me të ardhurat nga aktiviteti krahasuar me vitin 2021. Kjo tendencë varion nga 5.7% UK Dibër, në 37.75% UK Tropojë, ndërsa numri i shoqërive nga (-5%) deri në 5% raportohen 27 shoqëri. Tendencë negative konstatohet në 35 shoqëri nga të cilat 24 shoqëri që ishin edhe në vitin e kaluar, prej të cilave 19 shoqëri konstatohen me rënie të konsiderueshme të nivelit të këtij treguesi nga (-5.1%) në (-35.3%).

Kostot totale në sektor për vitin 2022 janë rritur me 1.87 miliard lekë ose 14% krahasuar me vitin 2021. Në këtë rritje rreth 91%, ose 1.7 miliard lekë i takon shoqërive të Grupit të I-rë. Ndërsa, të ardhurat e sektorit kanë shënuar një rritje me rreth 3% ose në vlerë 303.4 milion lekë krahasuar me vitin paraardhës ku peshën kryesore të kësaj rritje e kanë shoqëritë e grupit të parë me rreth 77%.

Treguesi Mbulimi i Kostove Totale (66.8%) i cili ka një rënie me (-7.1%) krahasuar me një vit më parë nuk paraqitet në nivele të qëndrueshme, për shkak se rritja e kostove totale me (14%) ka qenë më e lartë se rritja e të ardhurave nga aktiviteti me (3%).

Gjithsesi në lidhje me treguesin e mbulimit të kostove totale kërkohet një analizë me e detajuar për çdo shoqëri dhe për secilin zë për të gjykuar për performancën e këtij treguesi. Ndonjë shoqëri si UK Lezha në dukje ka tregues të ulët të mbulimit të kostove totale (53.7%), por në fakt kjo shoqëri ka patur mjaft investime nga donatorët e huaj vitet e fundit, që megjithëse ajo i shlyen rregullisht principalin dhe interesat e kredive, këtë përqindje e ulë në mënyrë drastike vlera mjaft e lartë e amortizimit që imponojnë investimet e reja. Konkretisht për këtë shoqëri ndërsa kostot e O&M janë rreth 181.7 milion lekë/vit, ato totale janë në vlerën rreth 385.2 milion lekë/vit, të cilat vijnë si rezultat i kostove mjaft të larta të amortizimit, prej rreth 188.7 milion lekë/vit.

Tabela nr.21. Ecuria e Mbulimit të Kostove Totale

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Tropojë	UK	49.7%	87.5%	37.7%
2	Kukës	UK	50.1%	70.7%	20.6%
3	Konispol	UK	33.0%	49.3%	16.3%
4	Himarë	UK	71.9%	87.3%	15.4%
5	Pustec	U	31.0%	44.5%	13.6%
6	Librazhd	UK	98.9%	110.9%	12.0%
7	Bulqizë	U	61.9%	73.9%	12.0%
8	Tepelenë	UK	48.0%	58.7%	10.8%
9	Selenicë	U	66.8%	75.8%	9.0%
10	Skrapar	UK	48.6%	55.9%	7.4%
11	Finiq	UK	80.4%	86.1%	5.7%
12	Dibër	UK	99.5%	105.2%	5.7%
13	Patos	UK	27.4%	32.4%	5.0%
14	Fushë Arrëz	UK	36.0%	40.8%	4.8%
15	Ura Vajgurore	UK	37.2%	41.9%	4.8%
16	Këlcyrë	UK	43.8%	48.2%	4.4%
17	Kavajë	UK	32.5%	36.1%	3.6%
18	Libohovë	UK	51.1%	54.5%	3.5%
19	Cërrik	UK	52.3%	55.7%	3.4%
20	Gjirokastër	UK	83.9%	87.2%	3.3%
21	Klos	UK	65.3%	68.5%	3.2%
22	Vau Dejës	UK	24.4%	27.2%	2.8%
23	Roskovec	UK	41.9%	43.8%	1.9%
24	Fier	UK	74.0%	73.9%	-0.1%
25	Devoll	UK	85.8%	85.2%	-0.7%
26	Korçë	UK	83.9%	82.6%	-1.3%
27	Dropull	UK	43.1%	41.7%	-1.5%
28	Has	UK	28.9%	26.7%	-2.2%
29	Sarandë	UK	74.0%	71.8%	-2.2%
30	Berat Kuçovë	UK	95.4%	93.2%	-2.2%
31	Rrogozhinë	UK	58.7%	56.4%	-2.3%
32	Kamëz	UK	31.6%	28.8%	-2.8%
33	Përmet	U	71.1%	68.2%	-2.9%
34	Divjakë	UK	43.3%	40.2%	-3.1%
35	Poliçan	UK	53.8%	50.2%	-3.6%
36	Vlorë	UK	51.5%	47%	-4.4%
37	Kurbin	UK	30.1%	25.4%	-4.6%
38	Mat	UK	79.7%	74.8%	-4.8%
39	Pogradec	UK	53.5%	48.5%	-5.0%
40	Tiranë	UK	121.4%	116%	-5.1%
41	Lezhë	UK	59.0%	53.7%	-5.3%
42	Krujë	UK	68.8%	63.2%	-5.6%
43	Memaliaj	UK	41.9%	35.9%	-6.0%
44	Shkodër	UK	45.2%	39.0%	-6.2%
45	Pukë	UK	66.0%	59.7%	-6.3%
46	Malësi e Madhe	UK	81.7%	75.1%	-6.6%
47	Maliq	UK	61.8%	54.8%	-6.9%
48	Mallakastër	UK	46.3%	39.3%	-7.0%
49	Lushnje	UK	64.4%	54.4%	-10.0%
50	Mirditë	UK	55.4%	44.5%	-10.9%
51	Ersekë	UK	102.6%	90.6%	-11.9%
52	Gramsh	U	71.6%	58.9%	-12.7%
53	Vorë	UK	84.6%	71.7%	-12.9%
54	Belsh	UK	58.0%	44.7%	-13.3%
55	Durrës	UK	63.2%	49.7%	-13.5%
56	Elbasan	UK	67.6%	53.1%	-14.5%
57	Peqin	UK	56.8%	40.3%	-16.6%
58	Delvinë	UK	68.9%	33.6%	-35.3%

2.3.4 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është shprehja në përqindje e shumës së arkëtuar ndaj shumës së faturuar për shërbimet e ofruara ujësjellës-kanalizime. Ky tregues paraqet efektivitetin e shoqërisë për të garantuar likuiditetin e saj dhe varet kryesisht nga faktorë manaxherial.

Në analizën e shoqërive sipas grupeve llogariten treguesi Norma e Arkëtimit Korrente (NAK) që tregon arkëtimet e shitjeve të shërbimeve UK për vitin 2022, si dhe treguesi Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (NAP) ku përfshihen dhe arkëtimet e debive përpara vitit raportues.

Për vitin 2022, NAK rezulton 81.4% kundrejt 77.6% që ishte në vitin 2021, me një rritje prej 3.8%. Kjo tregon për një ecuri pozitive të këtij treguesi, i cili me gjithë nivelin e rritur të çmimeve gjatë vitit 2022 si rezultat i inflacionit është rritur, duke treguar kështu ndërgjegjësimin e konsumatorëve në drejtim të pagesës së faturës së ujit të konsumuar.

Shoqëritë, krahas arkëtimit të faturave korrente, bëjnë përpjekje edhe për vjeljen e debive të prapambetura duke përdorur mekanizma, si lidhja e akt - marrëveshjeve shoqëri – klient, për pagesën e tyre me këste.

Në mbyllje të vitit 2022 rezulton se nga debitë e prapambetura janë arkëtuar rreth 1.63 miliard lekë. Në analizën e Grupeve, fokusi është NAK, pasi efienca në mbledhjen e të ardhurave korrente është elementi kryesor i qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë, që gjithashtu rrit mundësinë e shlyerjes së debive të vjetra.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2022

Grupi 1 - Norma e Arkëtimit Korrente (%)




Figura 8. Norma e Arkëtimit Korrente për Grupin e I-rë, Viti 2022

Për vitin 2022, në Grupin e I-rë bëjnë pjesë 14 shoqëri, nga të cilat raportohen 5 shoqëri me performancë të mirë, pra me një normë arkëtimi korrente mbi 82%, që janë: UK Tiranë (92.64%), UK Berat-Kuçovë (92.56%), UK Pogradec (91.48%), UK Lezhë (88.91%) dhe UK Korçë (85.16%).

Në brezin e performancës së pranueshme, për vitin 2022 janë 8 shoqëri, përkatësisht: UK Lushnje (79.4%), UK Durrës (75.94%), UK Fier (74.07%), UK Shkodër (71.93%), UK Kavajë (71.02%), UK Kamëz (67.7), UK Vlorë (66.49%) dhe UK Elbasan (60.8%).

Ndërsa, UK Sarandë ka ulur performancën lidhur me arkëtimin korrent të debive, duke rënë në brezin e tretë, performancë e dobët, me normë arkëtimi 52.71%.

Tabela nr.22. Ecuria e Normës së Arkëtimimit Korrente për Grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Tiranë	UK	79.71	92.64	12.93
2	Berat - Kuçovë	UK	84.72	92.56	7.84
3	Korçë	UK	80.98	85.16	4.18
4	Shkodër	UK	68.01	71.93	3.92
5	Vlorë	UK	63.12	66.49	3.37
6	Pogradec	UK	90.57	91.48	0.91
7	Durrës	UK	76.36	75.94	-0.42
8	Lezhë	UK	91.68	88.91	-2.77
9	Fier	UK	77.12	74.07	-3.05
10	Kavajë	UK	74.86	71.02	-3.84
11	Lushnje	UK	84.15	79.40	-4.75
12	Elbasan	UK	68.28	60.80	-7.48
13	Sarandë	UK	68.56	52.71	-15.85
14	Kamëz	UK	98.42	67.70	-30.72

Nga 14 shoqëri të analizuara, 6 prej tyre kanë shënuar përmirësim të treguesit NAK, krahasuar me vitin 2021, ku progresin më të madh e ka shënuar UK Tiranë me (+12.93%) dhe UK Berat-Kuçovë me (+7.84%). Ndërkohë, pjesa tjetër e shoqërive që bëjnë pjesë në këtë grup (8 shoqëri) kanë shënuar përkeqësim të këtij treguesi, ku rënien më të madhe e ka UK Kamëz, me 30.72% dhe UK Sarandë me 15.85%.

Grupi 2 - Norma e Arkëtimit Korrente (%)




Figura 9. Norma e Arkëtimit Korrente për Grupin e II-të, Viti 2022

Në Grupin e II-të, ku bëjnë pjesë 31 shoqëri, 8 prej tyre bëjnë pjesë në brezin e performancës së mirë, me një normë arkëtimi korrente mbi 82%, ku kryesojnë U Gramsh me 94.43% dhe UK Vorë me 94.19%, duke vijuar me UK Mat me 89.25%, UK Himarë me 86.87%, UK Mirditë me 86.03%, U Bulqizë me 84.87%, UK Librazhd me 83.98% dhe UK Skrapar me 83.49%. Vihet re një përmirësim i dukshëm i normës së arkëtimit korrent për UK Librazhd, nga 59.5% në vitin 2021, në 83.49% në vitin 2022.

Në brezin e performancës së pranueshme, me normë arkëtimi korrente 60%-82%, përfshihen 21 shoqëri, duke filluar me UK Mallakastër dhe UK Kolonjë me treguesin NAK përkatësisht 81.46% dhe 81.45%, e duke vijuar deri tek UK Patos me 61.35%. Nga këto shoqëri konstatohet se 13 prej tyre e kanë përmirësuar këtë tregues krahasuar me vitin 2021, ku UK Roskovec dhe UK Kukës kanë kaluar nga brezi i performancës së dobët, në brezin e performancës së pranueshme. Ndërkohë, janë tre shoqëri, përkatësisht: UK Mallakastër, UK Maliq dhe UK Malësi e Madhe, të cilët kanë kaluar nga brezi me performancë të mirë, në brezin me performancë të pranueshme.

Në zonën e performancës së dobët, me normë arkëtimi korrente nën 60%, për këtë grup përfshihen vetëm 2 shoqëri, përkatësisht UK Cërrik dhe UK Krujë. Të dyja shoqëritë, krahasuar me vitin 2021 kanë kaluar nga brezi me performancë të pranueshme, në brezin me performancë të dobët.

Tabela 23 paraqet ecurinë e treguesit të Normës së Arkëtimit Korrente për Grupin e II-të të shoqërive.

Tabela nr.23. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korrente për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Librazhd	UK	59.50	83.98	24.48
2	Roskovec	UK	56.61	70.02	13.41
3	Kukës	UK	50.47	62.98	12.51
4	Përmet	UK	61.82	73.70	11.88
5	Selenicë	UK	60.33	68.66	8.33
6	Kurbin	UK	67.35	75.35	8.00
7	Peqin	UK	72.28	79.85	7.57
8	Dibër	UK	65.85	73.24	7.39
9	Divjakë	UK	66.04	72.59	6.55
10	Delvinë	UK	73.74	80.13	6.39
11	Kolonje	UK	75.62	81.45	5.83
12	Dropull	UK	70.68	76.07	5.39
13	Tropojë	UK	65.37	68.92	3.55
14	Devoll	UK	67.59	70.97	3.38
15	Bulqizë	UK	81.57	84.87	3.30
16	Skrapar	UK	80.65	83.49	2.84
17	Himarë	UK	84.23	86.87	2.64
18	Gramsh	U	93.03	95.43	2.40
19	Mirditë	UK	85.36	86.03	0.67
20	Mat	UK	88.85	89.25	0.40
21	Vorë	UK	94.53	94.19	-0.34
22	Mallakastër	UK	83.17	81.46	-1.71
23	Gjirokastër	UK	71.03	69.28	-1.75
24	Rrogozhinë	UK	70.97	68.71	-2.26
25	Ura Vajgurore	UK	71.54	66.99	-4.55
26	Malësi e Madhe	UK	82.88	76.11	-6.77
27	Cërrik	UK	65.25	57.39	-7.86
28	Belsh	UK	72.25	62.63	-9.62
29	Maliq	UK	91.66	78.11	-13.55
30	Patos	UK	79.28	61.35	-17.93
31	Krujë	UK	66.33	40.61	-25.72

Referuar tabelës së mësipërme, 20 shoqëri e kanë përmirësuar treguesin e NAK krahasuar me vitin e mëparshëm, kundrejt 11 shoqërive, të cilat kanë shënuar përkeqësim. Ecurinë më të mirë e kanë UK Librazhd me +24.48%, UK Roskovec me +13.41%, UK Kukës me +12.51%, UK Përmet me +11.88% duke vijuar me pjesën tjetër të shoqërive deri tek UK Mat, e cila ka përmirësimin më të vogël +0.4%.

Ndërsa, nga 11 shoqëri, të cilat, kanë rezultuar me përkeqësim të situatës për NAK, me uljen më të madhe të treguesit raportohen të jenë: UK Krujë me -25.72%, UK Patos me -17.93%, UK Maliq me -13.55%, duke vijuar deri tek shoqëria UK Vorë me -0.34%.

Grupi 3 - Norma e Arkëtimit Korente (%)




Figura 10. Norma e Arkëtimit Korrente për Grupin e III-të, Viti 2022

Në Grupin e III-të bëjnë pjesë 13 shoqëri, nga të cilat, UK Fushë Arrëz, UK Poliçan dhe UK Pukë përfshihen në nivelin e performancës së mirë (mbi 82% të nivelit të arkëtimit), respektivisht me 88.89%, 88.68% dhe 82.39%.

Në brezin e performancës së qëndrueshme përfshihen 7 shoqëri, ku krahasuar me vitin 2021, përmendim që UK Konispol ka pësuar rënie nga brezi i performancës së mirë në atë të pranueshme, ndërsa UK Memaliaj dhe UK Tepelenë janë rritur nga brezi i performancës së dobët në atë të pranueshme.

Në brezin e performancës së dobët (nën 60%) përfshihen tre shoqëri, përkatësisht: UK Has (58.99%), UK Libohovë (57.92%) dhe UK Finiq (48.32%).

Tabela 24 paraqet ecurinë e treguesit të Normës së Arkëtimit Korrente për Grupin e III-të të shoqërive.

Tabela nr.24. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korrente për Grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Memaliaj	UK	51.69	69.77	18.08
2	Tepelenë	UK	55.99	68.88	12.89
3	Fushë Arrëz	UK	77.60	88.89	11.29
4	Këlcyrë	UK	65.04	73.77	8.73
5	Vau Dejës	UK	62.79	68.02	5.23
6	Has	U	54.86	58.99	4.13
7	Pustec	UK	62.30	64.94	2.64
8	Klos	U	62.23	63.08	0.85
9	Pukë	UK	81.63	82.39	0.76
10	Finiq	UK	49.65	48.32	-1.33
11	Libohovë	UK	61.62	57.92	-3.70
12	Poliçan	UK	98.37	88.68	-9.69
13	Konispol	UK	88.19	77.34	-10.85

Siç tregohet në tabelën e mësipërme, në Grupin e III-të 9 shoqëri kanë përmirësuar treguesin NAK krahasuar me vitin paraardhës, ku UK Memaliaj ka rritjen më të madhe me +18.08%. Ndërkohë, 4 shoqëri kanë pësuar rënie të këtij treguesi, ku UK Konispol ka rënie më të madhe brenda grupit, me -10.85%, duke e kaluar shoqërinë në zonën e performancës së qëndrueshme, nga zona me performancë të mirë.

Përfundime

- Shoqëritë kanë raportuar për vitin 2022, të dhëna të ndara për secilin tregues. Gjithsesi, edhe për këtë vit ekziston një marzh gabimi në lidhje me treguesin NAK, pasi ka disa shoqëri që ende konsiderojnë dhe i raportojnë debitë e krijuara gjatë vitit, si shlyerje të debive të prapambetura, por që në fakt ato likuidohen nga klientët brenda vitit.
- Referuar sektorit në tërësi, nga 58 shoqëri që kanë raportuar të dhëna për Normën e Arkëtimit Korrente, 16 shoqëri rezultojnë në brezin e performancës së mirë (mbi 82%), 36 shoqëri në brezin e pranueshëm (60%-82%) dhe 6 shoqëri në nivelin e performancës së dobët (nën 60%).
- Për vitin 2022, vërehet se 35 shoqëri kanë shënuar përmirësim të këtij treguesi, nga 31 që kishin paraqitur përmirësim në vitin 2021, ndërsa 23 shoqëri kanë pësuar regres referuar nivelit të arkëtimit të të ardhurave korrente.
- Shoqëritë UK në kuadër edhe të riorganizimit në shoqëri rajonale duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë arkëtimit të faturave korrente si dhe mbledhjes së debive të prapambetura si një mjet i nevojshëm që lidhet direkt me qëndrueshmërinë e tyre financiare.

2.3.5 Niveli i Matjes

Ecuria e treguesit “Niveli i Matjes” në vite për sektorin në përgjithësi ka qenë pozitiv. Për vitin 2022 ky tregues është 82.8 % duke pësuar një rritje prej (+2.1%), krahasuar me vitin 2021, i cili ka qenë 80.7 %. Të pajisur 100% të konsumatorëve me matës deri tani janë dy shoqëri UK Devoll dhe UK Divjakë. Për këtë vit vetëm shoqëria UK Libohovë ka nivel shumë të ulët të nivelit të matjes me 1.8 %, ndërsa UK Dropull këtë vit ka raportuar 0 % të nivelit të matjes pasi kanë nxjerrë jashtë përdorimit të gjithë matësat e instaluar me arsyetimin se janë të një cilësie të dobët dhe kanë problematika në matjen e sasisë së ujit në mënyrë të saktë.

Shoqëritë UK për vitin 2022 kanë raportuar instalimin e 23 907 matësave të rinj, por përsëri nuk e kanë arritur nivelin e performancës së mirë 85% të vendosur nga ERRU për sektorin. Për vitin 2022 vetëm shoqëria UK Devoll dhe UK Divjakë raporton këtë tregues në nivelin e 100%.

Megjithëse ka një përmirësim të treguesit, akoma 10 shoqëri janë nën 50% të nivelit të matjes dhe u mbetet ende shumë punë për të bërë për të arritur në nivel të performancës së mirë.

ERRU, thekson vazhdimisht nevojën e instalimit të matësve në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë dhe konsumatorëve individualë, por për këtë kërkohet edhe mbështetja me financime nga qeveria qendrore. Konsumatorët duhet të paguajnë për sasinë reale të ujit të konsumuar prej tyre, prandaj pajisja me ujëmatës e gjithë sistemit mbetet një nga objektivat kryesorë të shoqërive dhe një element që lehtëson problemet e menaxhimit të kërkesës për ujë dhe uljes së shpërdorimeve të mbikonusimit të tij.

Grupi 1 - Niveli i Matjes (%)




Figura 11 . Niveli i Matjes Grupi I-rë, Viti 2022

Referuar grafikut të mësipërm vërehet se në Grupin e I-rë, shoqëritë paraqesin trend pozitiv në përmirësim të këtij treguesi, prej të cilave 8 shoqëri UK e kanë nivelin matjes mbi 85%, UK Lushnje 99 %, UK Durrës 96.7 %, UK Korçë 96.5 %, UK Sarandë 95.3 %, UK Berat - Kuçova 93.5 %, UK Tiranë 90.3 %, UK Pogradec 87.4 % dhe UK Lezhë 86.9 %. Vërehet se për 6 prej këtyre shoqërive ka patur trend pozitiv rritës të këtij treguesi krahasuar me vitin 2021, por në nivele të ulta përveç UK Berat - Kuçova që ka një rritje të konsiderueshme me (+15.3 %).

Gjashtë shoqëritë e tjera të këtij grupi janë nën kufirin e 85 % ku dhe përmirësimi ka qenë në nivele të ulta nën 3 % krahasuar me vitin 2021, ndërsa rënie të këtij treguesi nuk paraqet asnjë shoqëri.

Në tabelën 25, të mëposhtme jepet ecuria për treguesin e nivelit të matjes, për shoqëritë e Grupit të I-rë, për dy vitet e fundit.

Tabela nr.25. Ecuria e Nivelit të Matjes Grupi I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Berat - Kuçovë	UK	78.20	93.50	15.30
2	Lushnje	UK	95.70	99.00	3.30
3	Elbasan	UK	75.60	78.40	2.80
4	Kamëz	UK	77.00	79.80	2.80
5	Vlorë	UK	65.50	67.80	2.30
6	Fier	UK	72.10	74.10	2.00
7	Pogradec	UK	85.70	87.40	1.70
8	Shkodër	UK	71.10	72.10	1.00
9	Lezhë	UK	86.00	86.90	0.90
10	Durrës	UK	95.90	96.70	0.80
11	Tiranë	UK	89.50	90.30	0.80
12	Kavajë	UK	40.90	41.30	0.40
13	Sarandë	UK	95.00	95.30	0.30
14	Korçë	UK	99.10	96.50	-2.60

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2022




Figura 12. Niveli i Matjes Grupi II-të, viti 2022

Gjatë vitit 2022, në Grupin e II-të janë 31 shoqëri nga 33 që ishin për vitin 2021 kjo nga kalimi i pragut të lidhjeve ku këtë vit kanë deklaruar ulje të numrit të lidhjeve për arsye të saktësimit të të dhënave, për UK Vau-Dejës dhe UK Poliçan të cilat si rezultat janë bërë pjesë e Grupit të III-të. Mbi kufirin e performancës

së mirë (mbi 85%), performojnë 14 shoqëri UK duke filluar me UK Devoll dhe Divjakë në nivelin 100 % deri tek UK Delvinë 86.6 %, të cilat kryesisht vijojnë të kenë tendencë pozitive krahasuar me vitin 2021.

Nën nivelin e 85 % deri në 50 % të treguesit të nivelit të matjes janë 10 shoqëri, duke filluar me UK Cërrik, e cila është shumë pranë kufirit të performancës së mirë me 84.8 % deri tek UK Dibër 60.6 % ndërkohë që 2 prej këtyre shoqërive UK Vorë ka një rënie me 3.6 % dhe UK Mat rënie me 1.3 % .

Shoqëria me ecurinë më të keqe për këtë vit me një përkeqësim të theksuar të këtij treguesi me (- 18.7%) ka patur UK Dropull ku raporton 0% nivelin e matjes me arsyetimin se kanë nxjerrë jashtë përdorimit të gjithë matësat e instaluar pasi kanë hasur probleme në cilësinë e tyre dhe në pasaktësinë e matjes së sasisë së ujit.

Përmirësim të ndjeshëm të treguesit paraqesin 4 shoqëri UK Patos (+40.9 %), UK Gjirokastrë (+18.4 %), UK Delvinë (+14.9 %) dhe U Gramsh (+7.8 %) pasi janë bërë investime për pajisjen e abonentëve aforfe me matësa uji.

Ecuria e treguesit të nivelit të matjes, për shoqëritë e Grupit të II-të, për dy vitet e fundit paraqitet më poshtë në tabelën 26.

Tabela nr.26. Ecuria e Nivelit të Matjes, Grupi II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Patos	UK	33.20	74.10	40.90
2	Gjirokastrë	UK	61.30	79.70	18.40
3	Delvinë	UK	71.70	86.60	14.90
4	Gramsh	U	88.90	96.70	7.80
5	Mirditë	UK	70.10	75.70	5.60
6	Selenicë	UK	23.30	28.10	4.80
7	Kurbin	UK	21.10	25.50	4.40
8	Mallakastër	UK	63.20	66.60	3.40
9	Cërrik	UK	82.60	84.80	2.20
10	Dibër	UK	58.80	60.60	1.80
11	Kolonje	UK	40.50	42.20	1.70
12	Malësi e Madhe	UK	75.80	77.40	1.60
13	Krujë	UK	76.00	77.40	1.40
14	Bulqizë	UK	25.30	26.50	1.20
15	Divjakë	UK	98.90	100.00	1.10
16	Himarë	UK	92.80	93.70	0.90
17	Belsh	UK	91.70	92.20	0.50
18	Maliq	UK	89.20	89.60	0.40
19	Skrapar	UK	33.20	33.50	0.30
20	Librazhd	UK	99.10	99.30	0.20
21	Roskovec	UK	96.80	97.00	0.20
22	Rrogozhinë	UK	94.70	94.90	0.20
23	Përmet	U	93.00	93.20	0.20
24	Kukës	UK	37.40	37.50	0.10
25	Devoll	UK	100.00	100.00	0.00
26	Peqin	UK	98.20	98.20	0.00
27	Ura Vajgurore	UK	96.60	96.60	0.00
28	Tropojë	UK	89.10	89.10	0.00
29	Mat	UK	70.20	68.90	-1.30
30	Vorë	UK	82.90	79.30	-3.60
31	Dropull	UK	18.70	0.00	-18.70

Grupi 3 - Niveli i Matjes (%)




Figura 13. Niveli i Matjes Grupi III-të, Viti 2022

Në Grupin e III-të ku bëjnë pjesë 13 shoqëri, 4 shoqëri janë në nivelin mbi 85 % të këtij treguesi përkatësisht UK Pustec, UK Konispol, UK Këlcyrë dhe UK Vau-Dejës të cilat kanë patur tendencë përmirësimi edhe gjatë vitit 2021. Tendencë përmirësimi të treguesit nga të dhënat raportojnë 4 shoqëri UK Vau-Dejës (+10.2 %), U Klos (+7.5 %) UK Finiq me (+3.6 %) dhe UK Poliçan (+2.1%). Përsa i përket U Klos qëndron kjo rritje pasi ka instaluar 221 matësia për vitin 2022, ndërsa për UK Vau-Dejës realisht nuk ka rritje por ka ardhur si rezultat i saktësimit të të dhënave të cilat si numër lidhje janë me pak se në 2021 gjë që ka çuar që kjo shoqëri të kalojë në grupin e tretë.

Për të disatin vit radhazi, në nivelin më të ulët të treguesit niveli i matjes performon shoqëria UK Libohovë, e cila pothuajse i ka të pamatur të gjithë kategoritë e konsumatorëve dhe nuk bën asnjë përpjekje për përmirësimin e këtij treguesi duke qëndruar në nivelin e matjes nën 2%.

Ecuria e nivelit të matjes, për shoqëritë e Grupit të III-të, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 27.

Tabela nr.27. Ecuria e Nivelit të Matjes për grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Vau i Dejës	UK	83.60	93.80	10.20
2	Klos	U	45.60	53.10	7.50
3	Finiq	UK	59.80	63.40	3.60
4	Poliçan	UK	65.50	67.60	2.10
5	Fushë Arrëz	UK	47.20	47.90	0.70
6	Has	U	72.40	73.00	0.60
7	Memaliaj	UK	74.13	74.50	0.37
8	Këlcyrë	UK	95.30	95.30	0.00
9	Pukë	UK	82.70	82.70	0.00
10	Tepelenë	UK	67.60	67.60	0.00
11	Libohovë	UK	1.80	1.80	0.00
12	Pustec	UK	99.60	99.00	-0.60
13	Konispol	UK	99.00	98.00	-1.00

Përfundime

- Shoqëritë UK për vitin 2022 kanë raportuar instalimin e 23 907 matësve të rinj, kështu numri i lidhjeve me matës në rang sektori ka shkuar 782 720 lidhje nga 945 128 lidhje UK që janë në total në të gjithë shoqëritë. Sektori ende vazhdon të faturojë aforfe 6 615 klientë privat dhe institucione, ndërkohë që procesi i instalimit të matësve, në kategorinë klientë jo familjarë të financuara nga vetë klientët, duhet të kishte përfunduar në zbatim të Vendimit Nr. 236, datë 10.5.1993 dhe VKM nr.96, datë 21.2.2007.
- Shoqëritë UK për vitin 2022 nuk e kanë arritur nivelin e performancës së mirë 85% të vendosur nga ERRU për sektorin edhe pse e kanë rritur nivelin e matjes me instalimin e 23 907 matësve të rinj. Për vitin 2022, vetëm shoqëria UK Devoll dhe UK Divjakë raporton këtë tregues në nivelin e 100%.
- Me nivel shumë të mirë të këtij treguesi mbi 85% janë 26 shoqëri, por ka dhe shoqëri që e kanë këtë tregues nën nivelin 40%, si UK Kukës, UK Skrapar, UK Selenicë, UK Bulqizë, UK Kurbin, UK Dropull, UK Libohovë. Për këto shoqëri kërkohet një angazhim serioz në përmirësimin e këtij treguesi për të bërë të mundur eliminimin e praktikës aforfe, si dhe pajisja 100% me matës të konsumatorëve privat.
- Përmirësim të dukshëm të këtij treguesi kanë raportuar UK Patos me (+ 40.9 %), UK Gjirokastrë me (+18.4 %) , UK Berat – Kuçovë me (+ 15.3 %) dhe UK Delvinë (+ 14.9 %). Arsyeja për këtë përmirësim janë investimet e kryera në këto shoqëri.
- Rënie më të dukshme të këtij treguesi ka UK Dropull me 0% nga 18.7% që ka raportuar në vitin 2021, me arsyetimin që kanë nxjerrë jashtë përdorimit të gjithë matësat e instaluar pasi kanë hasur probleme në cilësinë e tyre dhe në pasaktësinë e matjes së sasisë së ujit. Shoqëritë UK Korçë, UK Mat, UK Vorë, UK Pustec dhe UK Konispol kanë një rënie nën 4%.
- Vlerat sa më të larta të treguesit të nivelit të matjes çojnë rrjedhimisht në uljen e niveli të shpërdorimit të ujit, duke ulur kërkesën për ujë, rritur orët e furnizimit me ujë, pra përmirëson cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve. Matja e konsumit të ujit paraqet domosdoshmëri për mirëmanaxhimin e aktivitetit të shoqërisë.
- Mesatarja e treguesit të nivelit të matjes për sektorin për vitin 2022 është 82.8 % me një rritje prej (+2.1%), krahasuar me vitin 2021 i cili ka qenë 80.7 %. Pavarësisht ecurisë së mirë sërish kërkon shumë angazhim nga ana e shoqërive për të përmbushur objektivin prej 85 % për nivelin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU.
- Për të tre grupet e shoqërive në total janë 26 shoqëri që operojnë mbi nivelin e performancës së mirë përse i përket shërbimit të matur me mbi 85 % . Nga këto shoqëri(8 janë në grupin e parë, 14 në grupin e dytë dhe 4 shoqëri në grupin e tretë). Në grupin e tretë shoqëria UK Libohovë vazhdon të jetë pothuajse me shërbim të pa matur pasi raporton vetëm 1.8 % treguesin e nivelit të matjes për shumë vite radhazi.
- ERRU, e konsideron procesin e vendosjes së matësve plotësisht të arritshëm nga shoqëritë UK, si dhe mbështet e nxit të gjitha shoqëritë për hartimin dhe zbatimin e programeve për instalimin e matësve individual.

2.3.6 Efiçenca e Stafit

Treguesi i efiçencës së stafit praqet raportin e numrit të punonjësve të shoqërisë mbi totalin e numrit të lidhjeve të ujësjellës kanalizimeve të ujërave të ndotura që administron shoqëria.

Treguesi i Efiçencës së Stafit për herë të parë këtë vit ashtu siç është theksuar edhe në raportin e Vitit 2021 do të analizohet dhe do të krahasohet duke përfshirë numrin e stafit sipas organigramës së shoqërisë

pa përfshirë personelin roje të nënkontraktuar. Kjo mënyrë krahasimi është vendosur nga ERRU me qëllim vendosjen e të gjitha shoqërive UK në të njëjtën bazë krahasimi për performancën e këtij treguesi.

Treguesi i efikasitetit të stafit është një tregues mjaft i rëndësishëm pasi lidhet direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë kjo pasi kostoja e personelit është zëri që zë përqindjen më të madhe prej 43% të kostove O&M.

Efikasiteti i stafit nënkupton që shoqëritë të mos kenë njerëz në organikën e tyre që nuk justifikojnë pozicionin e punës që presupozohet të kryejnë. Edhe pse për vitin 2021 sektori ka operuar me 101 punonjës më pak, përsëri sektori paraqitet i mbingarkuar me staf të pajustificuar që në mjaft raste janë të punësuar pa arsimin dhe kualifikimet përkatëse dhe bazuar në kritere partiake. Kjo pjesë e stafit përveç se është jo efikase, dekurajon edhe pjesën tjetër të stafit si shembull negativ i performancës në punë.

Konkretisht për vitin 2022 sektori e ka zhvilluar aktivitetin me një staf prej 7815 punonjësish nga 7916 punonjës që janë raportuar në vitin 2021, ndërkohë që edhe numri i lidhjeve të ujit është rritur me 23,970 lidhje dhe ai i kanalizimeve me 22,558 lidhje duke dhënë kështu impakt të lehtë pozitiv në përmirësimin e këtij treguesi i cili për vitin 2022 është 4.73 punonjës për 1000 lidhje nga 4.90 që ishte në vitin 2021.

Duke marrë parasysh specifikat e operimit dhe shërbimit të shoqërive si shtrirjen e shërbimit UK, numrin e sistemeve të furnizimit me ujë e të tjera arsye, ERRU ka vendosur nivel të diferencuar të objektivit të performancës së mirë për të tre grupet e shoqërive.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2022

Për Grupin e I-rë, ERRU ka përcaktuar si nivel të performancës shumë të mirë deri në 4 punonjës për 1000 lidhje, performancë të pranueshme 4-6 punonjës për 1000 lidhje, dhe mbi 6 punonjës për 1000 lidhje atë të performancës së dobët. Figura 14 jep grafikisht Efikasitetin e Stafit për Grupin e I-rë të shoqërive UK

Grupi 1 - Efikasiteti e Stafit (staf / 1000 lidhje)




Figura 14. Efikasiteti e Stafit për Grupin e I-rë, Viti 2022

Në këtë grup në zonën e performancës së mirë renditen tre shoqëritë UK Korçë me 2 punonjës për 1000 lidhje, UK Tiranë me 2.64 punonjës për 1000 lidhje dhe UK Vlorë me 3.91 punonjës për 1000 lidhje,. Në brezin e performancës së pranueshme sipas grafikut paraqiten 11 shoqëri nga UK Lezhë me 4.29 punonjës për 1000 lidhje tek UK Berat Kuçovë me 4.43 punonjës për 1000 lidhje deri tek UK Elbasan me 5.82 punonjës për 1000 lidhje.

Tabela 28 paraqet ecurinë e treguesit të Efiçencës së Stafit për Grupin e I-rë të shoqërive për dy vitet e fundit. Për Grupin e I-rë të shoqërive ecurinë më të mirë e ka patur UK Kavajë me 5.40 ose (-1.71) punonjës për 1000 lidhje duke vijuar më tej me 7 shoqëri të tjera të cilat kanë patur tendencë pozitive minimale dhe konkretisht UK Berat Kuçovë (-0.46), UK Korçë (-0.37), UK Durrës (-0.23), UK Lushnje (-0.21), UK Sarandë (-0.19) dhe UK Pogradec me (-0.18) si dhe UK Tiranë (-0.04) punonjës për 1000 lidhje.

Ecurinë më të madhe negative e ka patur UK Kamëz (+ 0.92) punonjës për 1000 lidhje si rezultat i shtimit të stafit organik me 12 punonjës gjatë vitit 2022. Pjesa tjetër e shoqërive të grupit të I-rë, përgjithësisht kanë tendencë negative të vogël duke filluar nga UK Lezhë (+0.04) deri tek UK Elbasan (+0.52) punonjës për 1000 lidhje.

Tabela nr. 28. Ecuria e Efiçencës së Stafit për Grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (staf/1000 lidhje)	2022 (staf/1000 lidhje)	Ndryshimi 2021-2020 (staf/1000 lidhje)
1	Kavajë	UK	7.11	5.40	-1.71
2	Berat - Kuçovë	UK	4.89	4.43	-0.46
3	Korçë	UK	2.37	2.00	-0.37
4	Durrës	UK	5.31	5.08	-0.23
5	Lushnje	UK	5.35	5.14	-0.21
6	Sarandë	UK	4.87	4.68	-0.19
7	Pogradec	UK	5.60	5.42	-0.18
8	Tiranë	UK	2.68	2.64	-0.04
9	Lezhë	UK	4.25	4.29	0.04
10	Shkodër	UK	5.29	5.43	0.14
11	Fier	UK	4.63	4.93	0.30
12	Vlorë	UK	3.42	3.91	0.49
13	Elbasan	UK	5.30	5.82	0.52
14	Kamëz	UK	3.86	4.78	0.92

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2022

Për Grupin e II-të, niveli i objektivit për performancë të pranueshme të vendosur nga ERRU është 6-10 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 10 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 6 punonjës për 1000 lidhje.

Figura 15 jep grafikisht Efiçencën e Stafit për Grupin e II-të të shoqërive UK

Grupi 2 - Efienca e Stafit (staf / 1000 lidhje)




Figura 15. Efienca e Stafit për Grupin e II-të, viti 2022

Në këtë grup në nivelin e performancës së mirë për të dytin vit radhazi bëjnë pjesë 4 shoqëri si UK Kolonjë, UK Librazhd, UK Maliq dhe UK Dibër, të cilat me përjashtim të UK Dibër (e cila ka pasur një rënie të lehtë) e kanë përmirësuar më tej këtë tregues përkatësisht me (-0.48), (-0.18) dhe (-0.03) punonjës për 1000 lidhje.

Në nivelin e pranueshëm të këtij treguesi janë 19 shoqëri duke filluar nga UK Mat deri tek UK Ura Vajgurore që variojnë brenda kufirit nga 6.29 deri në 9.10 punonjës për 1000 lidhje.

Në zonën e performancës së dobët me mbi 10 punonjës për 1000 lidhje renditen 8 shoqëri, duke filluar me UK Tropojë 10.21 punonjës për 1000 lidhje deri tek UK Peqin me 16.85 punonjës për 1000 lidhje e cila ka dhe efiençën më të dobët në këtë grup. Gjithsesi brenda këtij grupi megjithëse në nivel performance të dobët ka shoqëri që kanë patur një ecuri dukshëm të mirë si UK Patos në nivelin e 10.9 punonjës për 1000 lidhje nga 17.7 që kishte në vitin 2021.

Nisur nga tabela 23 e mëposhtme vërehet se ecurinë më të mirë në nivelin e nën 1 punonjës që është përcaktimi që ERRU konsideron pozitiv e kanë patur shoqëritë UK Patos (-6.80), UK Selenicë (-3.25), UK Kurbin (-1.70), UK Gjirokastër (-1.63) dhe UK Belsh (-1.03) punonjës për 1000 lidhje. Gjithashtu në këtë grup janë edhe 16 shoqëri me ecuri pozitive më të lehtë duke filluar me UK Bulqizë (-0.59) deri tek UK Maliq (-0.03) punonjës për 1000 lidhje.

Tendencë të lartë negative të këtij treguesi kanë pasur 3 shoqëri si UK Cërrik me (+1.39) e cila është edhe shoqëria me tendencën më të lartë negative në Grupin e II-të pasuar nga UK Krujë me (+0.62) dhe UK Delvinë me (+0.45) punonjës për 1000 lidhje.

Për UK Cërrik përkeqësimi ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të punonjësve me (+21) punonjës dhe rritjes së numrit të lidhjeve me ujë vetëm me (+709) lidhje për vitin 2022, duke ndikuar kështu në përkeqësimin e këtij treguesi i cili mbetet dukshëm larg objektivit të 1 punonjës për 1000 lidhje.

Tabela 29 paraqet ecurinë e treguesit të Efiçencës së Stafit për Grupin e II-të të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela nr.29. Ecuria e Efiçencës së Stafit për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (staf/1000 lidhje)	2022 (staf/1000 lidhje)	Ndryshimi 2022-2021 (staf/1000 lidhje)
1	Patos	UK	17.70	10.90	-6.80
2	Selenicë	UK	9.62	6.37	-3.25
3	Kurbini	UK	8.89	7.19	-1.70
4	Gjirokastër	UK	8.58	6.95	-1.63
5	Belsh	UK	9.63	8.60	-1.03
6	Bulqizë	UK	7.85	7.26	-0.59
7	Ura Vajgurore	UK	9.59	9.10	-0.49
8	Kolonje	UK	3.79	3.31	-0.48
9	Malësi e Madhe	UK	12.14	11.71	-0.43
10	Rrogozhinë	UK	7.86	7.51	-0.35
11	Përmet	UK	7.21	6.86	-0.35
12	Skrapar	UK	7.96	7.61	-0.35
13	Vorë	UK	12.37	12.08	-0.29
14	Gramsh	U	8.75	8.51	-0.24
15	Mallakastër	UK	15.94	15.71	-0.23
16	Librazhd	UK	5.30	5.12	-0.18
17	Mat	UK	6.46	6.29	-0.17
18	Roskovec	UK	8.95	8.86	-0.09
19	Divjakë	UK	11.13	11.05	-0.08
20	Dropull	UK	7.02	6.96	-0.06
21	Maliq	UK	5.43	5.40	-0.03
22	Devoll	UK	6.53	6.55	0.02
23	Mirditë	UK	11.31	11.41	0.10
24	Himarë	UK	6.65	6.80	0.15
25	Dibër	UK	5.34	5.52	0.18
26	Tropojë	UK	10.02	10.21	0.19
27	Kukës	UK	7.44	7.65	0.21
28	Peqin	UK	16.47	16.85	0.38
29	Delvinë	UK	7.34	7.79	0.45
30	Krujë	UK	5.71	6.33	0.62
31	Cërrik	UK	6.45	7.84	1.39

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2022

Për Grupin e III-të niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë shumë të mirë është nën 10 punonjës për 1000 lidhje, për performancë të pranueshme është 10-15 punonjës për 1000 lidhje dhe ai për performancë të dobët është mbi 15 punonjës për 1000 lidhje .

Në këtë grup për vitin 2022 siç është theksuar më lart në raport, janë shtuar dy shoqëri UK Vau – Dejës dhe UK Poliçan e cila më parë ka qenë pjesë e grupit të dytë.

Figura 16 jep grafikisht Efiçencën e Stafit për Grupin e III-të të shoqërive UK




Figura 16. Efiçenca e Stafit për Grupin e III-të, Viti 2022

Në Grupin e III-të performuesi më i mirë është UK Memaliaj 6.33 punonjës për 1000 lidhje i cili ndiqet më tej nga UK Poliçan me 7.93 punonjës për 1000 lidhje, UK Fushë – Arrëz dhe UK Pukë përkatësisht me 8.47 punonjës për 1000 lidhje, UK Konispol me 9.43 punonjës për 1000 lidhje e cila më parë ka qenë mbi këtë kufi me 10.5 punonjës për 1000 lidhje si dhe UK Finiq me 9.82 dhe UK Tepelenë 9.86 punonjës për 1000 lidhje. Në brezin e performancës së pranueshme për këtë grup janë 4 shoqëri si UK Pustec 11.88, UK Vau – Dejës 12.22, UK Libohovë 12.31 dhe U Klos 12.88 punonjës për 1000 lidhje.

Në nivelin e performancës së dobët, të renditura mbi vijën e kuqe, edhe për këtë vit janë 2 shoqëri, UK Kelçyrë 18.7 edhe pse ka patur një përmirësim të lehtë dhe UK Has me 20.61 punonjës për 1000 lidhje e cila vijon të ketë trend rritës dhe renditet e fundit në Grupin e III-të.

Tabela 30 paraqet ecurinë e treguesit të Efiçencës së Stafit për Grupin e III-të të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela nr.30. Ecuria e Efiçencës së Stafit për Grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (staf/1000 lidhje)	2022 (staf/1000 lidhje)	Diferenca 2022-2021 (staf/1000 lidhje)
1	Këlcyrë	U	19.3	18.07	-1.23
2	Memaliaj	UK	7.43	6.33	-1.10
3	Konispol	U	10.50	9.43	-1.07
4	Klos	U	13.71	12.88	-0.83
5	Pustec	UK	12.62	11.88	-0.74
6	Finiq	U	10.23	9.82	-0.41
7	Pukë	UK	8.78	8.47	-0.31
8	Poliçan	UK	8.10	7.93	-0.17
9	Libohovë	U	12.48	12.31	-0.17
10	Fushë Arrëz	UK	8.61	8.47	-0.14
11	Tepelenë	UK	9.88	9.86	-0.02
12	Has	U	20.43	20.61	0.18
13	Vau – Dejës	UK	9.63	12.22	2.59

Ndryshim pozitiv të ndjeshëm mbi 1 punonjës për 1000 lidhje ka pasur shoqëria UK Këlcyrë (-1.23) punonjës për 1000 lidhje, por përsëri mbetet në brezin e performancës së dobët. Po kështu ecuri pozitive kanë pasur dhe UK Memaliaj (-1.10) dhe UK Konispol (-1.07) punonjës për 1000 lidhje e cila ka hyrë dhe në brezin e performancës së mirë. Gjithashtu tendencë pozitive kanë pasur edhe shoqëritë UK Klos (-0.83) punonjës për 1000 lidhje deri tek UK Fushë Arrëz me (-0.14) punonjës për 1000 lidhje UK.

Tendencën negative më të madhe e ka UK Vau – Dejës me (+2.59) punonjës për 1000 lidhje si rezultat i raportimit të gabuar në vitin e mëparshëm dhe U Has me (+0.18) punonjës për 1000 lidhje.

Gjithsesi vlerësimi i performancës për të tre grupet e këtij treguesi duhet të realizohet rast pas rasti në funksion të karakteristikave dhe numrit të sistemeve të furnizimit me ujë brenda zonës së shërbimit të shoqërisë.

Përfundime

- Në mbyllje të vitit 2022, treguesi staf për 1000 lidhje ka një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin paraardhës nga 4.9 në 4.73 punonjës për 1000 lidhje.
- Ulja e numrit të punonjësve me 101 punonjës në rang sektori dhe rritja e lidhjeve UK me rreth 23,970 lidhje uji dhe 22,558 lidhje KUN, kanë dhënë efekt pozitiv në përmirësimin e performancës së këtij treguesi.
- Megjithëse ulja e numrit të punonjësve ka dhënë efektin e saj pozitiv në përmirësimin e këtij treguesi, përsëri kostot e punës zënë peshën kryesore në totalin e kostove O&M. Nevoja për përmirësimin e këtij treguesi ka rëndësi të veçantë pasi lidhet me objektivin strategjik të sektorit për të arritur qëndrueshmëri financiare ku përmirësimi i efiçencës së stafit është një nga elementet thelbësor për përmirësimin e efiçencës financiare të shoqërisë.
- Motivimi dhe trajnimi i stafeve në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale duhet të jetë në fokusin e shoqërive UK pasi do të ndikonte në mirëfunksionimin dhe zhvillimin e shoqërive.
- ERRU në mënyrë të vazhdueshme i kushton një vëmendje të veçantë shqyrtimit të organigramës së stafit të shoqërive UK kur ato paraqesin aplikime për tarifa të reja duke u treguar agresive në vendosjen e objektivit për secilin shoqëri në mënyrë që ato të jenë të justifikuara në numër punonjësish, pozicione dhe përshkrime të punës për secilin prej tyre.

2.3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë.

Kohëzgjatja e furnizimit me ujë mbetet një nga treguesit më të rëndësishëm në sektorin e ujit, ku dhe konsumatorët janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të këtij treguesi. Kur ky tregues të arrijë në nivelin e standardeve të kërkuara do të sjellë përmirësim edhe të cilësisë së ujit dhe konsumatorët nuk do të kërkojnë burime të tjera furnizimi me ujë. Si një nga treguesit më të rëndësishëm në sektorin e ujit ofrimi i vazhdueshëm i shërbimit për konsumatorët, apo çdo përmirësim i tij do të vihet re dhe mirëpritet nga konsumatorët. Për vlerësimin e këtij treguesi është përdorur mesatarja e orëve të furnizimit me ujë në ditë, mesatarja aktuale e sektorit është 16.3 orë/ditë dhe ka pësuar rritje me 0.9 orë në ditë nga viti paraardhës.

Faktorët kryesorë që shkaktojnë këtë vazhdimësi të ulët të furnizimit me ujë janë humbjet administrative të ujit që vijnë nga mbi konsumi i pamatur si pasojë e faturimit aforfe, nga lidhjet e paligjshme dhe nga humbjet teknike në rrjetë. Aktualisht, vetëm 11 nga shoqëritë e ujësjellësave (Korçë, Lezhë, Librazhd, Devoll, Mirditë, Përmet, Gramsh, Poliçan, Bulqizë, Fushë Arrëz dhe Pustec) mund të ofrojnë ujë 24 orë/ditë, përsa i përket shërbimit në qendrat urbane janë dhe më shumë shoqëri që ofrojnë 24 orë/ditë, por duke ju referuar të gjithë zonës së shërbimit, ku përfshihet edhe zona rurale, koha e furnizimit me ujë është nën 24 orë/ditë, siç jepet në tabelat përkatëse për secilin grup shoqëri.

Objektivi i performancës së mirë të vendosur nga ERRU prej 18 orë/ditë ende është larg për tu arritur nga shumë shoqëri, siç do vërehet me poshtë në analizën e shoqërive të ndara sipas grupeve.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2022

Grupi 1 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 17. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për Grupin e I-rë, Viti 2022

Në Grupin e I-rë të shoqërive, bëjnë pjesë 14 shoqëri UK, për vitin 2022 vetëm 6 shoqëri arrijnë të furnizojnë konsumatorët me mbi 18 orë/ditë që është dhe kufiri i performancës së mirë të vendosur nga

ERRU. Gjatë vitit 2022, përmirësim të këtij treguesi raportojnë shoqëritë UK Berat - Kuçovë (+7.6) orë/ditë, UK Sarandë (+2)orë/ditë, UK Pogradec (+1.7) orë/ditë, UK Shkodër (0.5)orë/ditë, e cila në vitin 2021 kishte pësuar këtë rënie në kohëzgjatjen e furnizimit me ujë, ndërsa shoqëritë e tjera nuk kanë patur ndryshime të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë krahasuar me vitin 2021, përveç UK Vlorë (-1.5) orë/ditë, UK Elbasan (- 0.4) orë/ditë dhe UK Durrës (-0.1) orë/ditë.

Shoqëritë UK Korçë, UK Lezhë janë edhe për këtë vit të vetmet shoqëri në këtë grup që arrijnë të furnizojnë me ujë 24 orë/ditë, duke u ndjekur nga UK Berat Kuçovë (22.6 orë/ditë), UK Pogradec (22.1 orë/ditë), UK Fier (22 orë/ditë), UK Shkodër (21.7 orë/ditë).

Shoqëria me performancë më të dobët për këtë grup dhe shumë larg realizimit të treguesit ose përafrimit të vlerave të grupit vazhdon të jetë dhe për këtë vit UK Kamëz me kohëzgjatjen e furnizimit me ujë 4 orë/ditë, e cila nuk ka bërë asnjë përpjekje për ta përmirësuar këtë tregues.

Ecuria e këtij treguesi për Grupin e I-rë të shoqërive për dy vitet e fundit paraqitet në tabelën31, ku vlen të përmendet se shoqëritë me ecuri më të mirë krahasuar me vitin 2021, janë UK Berat Kuçovë (+7.6) orë/ditë, si rezultat i futjes në punë të sistemit të ri, duke u ndjekur nga UK Sarandë (+ 2) orë/ditë, UK Pogradec (+1.7) orë/ditë, ndërsa shoqëria me ecurinë më të keqe është UK Vlorë (-1.5) orë/ditës, si rezultat i saktësimit të të dhënave.

Të gjitha shoqëritë e Grupit të I-rë duhet të kenë në fokus kryesor përmirësimin e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë sepse janë shoqëritë më të mëdha dhe mbulojnë me shërbim popullsinë më të madhe në vend.

Tabela nr.31. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (orë/ditë)	2022 (orë/ditë)	Ndryshimi 2022-2021 (orë/ditë)
1	Berat - Kuçovë	UK	15.00	22.60	7.60
2	Sarandë	UK	10.00	12.00	2.00
3	Pogradec	UK	20.40	22.10	1.70
4	Shkodër	UK	21.20	21.70	0.50
5	Korçë	UK	24.00	24.00	0.00
6	Lezhë	UK	24.00	24.00	0.00
7	Fier	UK	22.00	22.00	0.00
8	Tiranë	UK	17.00	17.00	0.00
9	Kavajë	UK	10.00	10.00	0.00
10	Lushnje	UK	10.00	10.00	0.00
11	Kamëz	UK	4.00	4.00	0.00
12	Durrës	UK	13.10	13.00	-0.10
13	Elbasan	UK	13.60	13.20	-0.40
14	Vlorë	UK	14.00	12.50	-1.50

Grupi 2 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 18. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për Grupin e II-të, Viti 2022

Në Grupin e II-të përbërë prej 31 shoqërish, pas largimit të UK Vau i Dejës dhe UK Poliçan në grupin e III-të. 14 prej tyre arrijnë të kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë mbi kufirin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Furnizimin me ujë 24 orë/ditë e ofrojnë 6 shoqëri UK Mirditë, UK Devoll, UK Gramsh, UK Librazhd, UK Bulqizë dhe UK Përmet, ndërsa për 5 shoqëri UK Rrogozhinë, UK Selenicë, UK Dropull, UK Roskovec, UK Kurbin niveli i këtij treguesi është nën kufirin e performancës së dobët (8 orë/ditë).

Edhe për këtë vit UK Roskovec (5 orë/ditë) dhe UK Kurbin (2 orë/ditë), e cila ka pësuar një rënie prej (-2) orë/ditë krahasuar me vitin 2021, mbeten performuesit më të dobët në këtë grup dhe shumë larg realizimit të treguesit.

Gjatë vitit 2022, përmirësim të orëve të furnizimit me ujë kanë patur shoqëritë UK Delvinë (+12) orë/ditë, e cila është dhe shoqëria me ecurinë më të mirë për këtë grup, rezultat i cili ka ardhur nga futja në punë e investimit të ri në sistemin e F.U, e ndjekur më pas nga UK Mirditë (+9) orë/ditë si rezultat i zëvendësimit të pompave në prodhim, UK Patos (+3,5) orë/ditë si rezultat i futjes në punë e investimit në sistemin F.U, UK Skrapar (+2.3) orë/ditë, UK Himarrë dhe UK Krujë me nga (+2) orë/ditë, UK Dibër(+1.6) orë/ditë, si rezultat i saktësimit të të dhënave. Gjithashtu, përmirësim të vogël të këtij treguesi kanë patur dhe shoqëri të tjera UK Kukës dhe UK Dropull me nga (+0.5) orë/ditë dhe UK Maliq (+0.3) orë/ditë.

Ky tregues ka pësuar përkeqësim të ndjeshëm për shoqërinë UK Divjakë (-2.6 orë/ditë) si rezultat i rrjetit shumë të amortizuar dhe defekteve të shumta që ka patur gjatë këtij viti, por përsëri mbetet mbi kufirin e performancës së dobët (8 orë/ditë). E njëjta situatë përkeqësimi dhe për UK Kurbin (-2) orë/ditë, si rezultat i saktësimit të të dhënave duke mbetur dhe për këtë vit shoqëria me performancën më të dobët

në këtë grup me 2 orë/ditë. Ndërsa UK Mallakastër ka një rënie të lehtë të këtij treguesi me (-0.5) orë/ditë, por mbetet mbi kufirin e performancës së dobët (8 orë/ditë).

Ecuria e shoqërive në Grupin e II-të për dy vitet e fundit pasqyrohet në tabelën 32.

Tabela nr.32. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (orë/ditë)	2022 (orë/ditë)	Ndryshimi 2022-2021 (orë/ditë)
1	Delvinë	UK	8.00	20.00	12.00
2	Mirditë	UK	15.00	24.00	9.00
3	Patos	UK	11.50	15.00	3.50
4	Skrapar	UK	14.00	16.30	2.30
5	Himarë	UK	16.00	18.00	2.00
6	Krujë	UK	8.00	10.00	2.00
7	Dibër	UK	11.00	12.60	1.60
8	Kukës	UK	10.50	11.00	0.50
9	Dropull	UK	6.50	7.00	0.50
10	Maliq	UK	17.10	17.40	0.30
11	Devoll	UK	24.00	24.00	0.00
12	Gramsh	U	24.00	24.00	0.00
13	Librazhd	UK	24.00	24.00	0.00
14	Bulqizë	UK	24.00	24.00	0.00
15	Përmet	UK	24.00	24.00	0.00
16	Cërrik	UK	22.00	22.00	0.00
17	Kolonjë	U	21.00	21.00	0.00
18	Peqin	UK	20.00	20.00	0.00
19	Tropojë	UK	19.00	19.00	0.00
20	Malësi e Madhe	UK	19.00	19.00	0.00
21	Mat	UK	18.00	18.00	0.00
22	Gjirokastër	UK	13.00	13.00	0.00
23	Ura Vajgurore	UK	12.00	12.00	0.00
24	Belsh	UK	8.50	8.50	0.00
25	Vorë	UK	8.00	8.00	0.00
26	Rrogozhinë	UK	7.50	7.50	0.00
27	Selenicë	U	7.00	7.00	0.00
28	Roskovec	UK	5.00	5.00	0.00
29	Mallakastër	UK	11.00	10.50	-0.50
30	Kurbini	UK	4.00	2.00	-2.00
31	Divjakë	UK	11.60	9.00	-2.60

Grupi 3 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 19. Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë për Grupin e III-të, Viti 2022

Në Grupin e III-të të shoqërive bëjnë pjesë 13 shoqëri. Për vitin 2022, në këtë grup janë shtuar 2 shoqëri UK Vau i Dejës dhe UK Poliçan, të cilat bënin pjesë në grupin e II-të. Sqarojmë se këto dy shoqëri kanë kaluar në grupin e III-të për shkak të rishikimit e saktësimit të të dhënave. Në këtë grup 9 shoqëri arrijnë të kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë mbi kufirin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Furnizimin me ujë 24 orë/ditë e ofrojnë shoqëritë UK Fushë Arrëz, UK Pustec të cilat ishin dhe në vitin 2021, ndërsa këtë vit është shtuar edhe UK Poliçan.

Përmirësim të orëve të furnizimit me ujë për vitin 2022 e kanë patur UK Vau i Dejës me 3.5 orë/ditë, si rezultat i uljes së numrit të klientëve pas verifikimit të bërë këtë vit (për të cilën kaloi dhe në grupin e III-të), por përsëri kjo shoqëri mbetet nën nivelin e performancës së mirë me 13.5 orë/ditë, e ndjekur me pas nga UK Tepelenë me 1 orë/ditë. Pjesa tjetër e shoqërive nuk ka pësuar ndryshime të këtij treguesi i ka në të njëjtat nivele me vitin e kaluar.

Për këtë vit, ky grup ka një performancë të mirë, vetëm UK Has vazhdon të ketë për të katërtin vit radhazi furnizimin me ujë 8 orë/ditë, duke shpresuar që reforma të sjelli përmirësime për UK Has.

Në tabelën 33 është paraqitur ecuria e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë për Grupin e III-të të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela nr.33. Ecuria e Kohëzgjatjes së FU për grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (orë/ditë)	2022 (orë/ditë)	Ndryshimi 2022-2021 (orë/ditë)
1	Vau i Dejës	UK	10.00	13.50	3.50
2	Tepelenë	UK	20.00	21.00	1.00
3	Poliçan	UK	24.00	24.00	0.00
4	Fushë Arrëz	UK	24.00	24.00	0.00
5	Pustec	UK	24.00	24.00	0.00
6	Pukë	UK	23.00	23.00	0.00
7	Libohovë	UK	22.00	22.00	0.00
8	Këlcyrë	UK	22.00	22.00	0.00
9	Finiq	UK	21.40	21.40	0.00
10	Konispol	UK	20.00	20.00	0.00
11	Memaliaj	UK	17.50	17.50	0.00
12	Klos	U	10.00	10.00	0.00
13	Has	UK	8.00	8.00	0.00

Përfundime

- Cilësia e shërbimit ndaj konsumatorëve, që matet përmes vazhdimësisë së shërbimit nuk është në nivelet e duhura, konsumatorët për vitin 2022 nuk furnizohen në mënyrë të pandërprerë me ujë. Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë për sektorin është rritur me 0.9 orë në ditë, krahasuar me vitin paraardhës duke arritur nivelin 16.3 orë/ditë. Ky tregues në kuadrin e reformës që presupozon një menaxhim më të mirë të kërkesës për ujë, si dhe nga investimet e pritshme nga QQ pritet të përmirësohet dukshëm.
- Shoqëritë ofrojnë FU që varion nga 2-24 orë/ditë. Shoqëritë që ofrojnë furnizim të pandërprerë me ujë janë 11 shoqëri si UK Korçë, UK Lezhë, UK Librazhd, UK Mirditë, UK Devoll, U Gramsh, UK Bulqizë, UK Përmet, UK Poliçan, UK Fushë Arrëz, UK Pustec.
- Shoqëritë me performancë të mirë ose që kanë arritur në nivele të pranueshme në oraret e FU tregojnë se ky tregues nuk varet vetëm nga investimet, por edhe nga mirëmenaxhimi i shoqërisë.
- Në përgjithësi, siç vihet re shoqëritë këtë vit kanë pasur rritje ose nivel të njëjtë të orëve të furnizimit dhe shumë pak rënie (ndoshta vjen nga pasaktësia në llogaritje), në krahasim me vitin 2021.
- Shoqëritë duhet të marrin me seriozitet raportimin e të dhënave për këtë tregues me mjetet e duhura dhe përgatitjen profesionale të stafit dhe ta pasqyrojnë këtë tregues edhe në planet e tyre të biznesit.

2.3.8 Mbulimi me Kanalizime

Treguesi i Mbulimit me Kanalizime është raporti i popullsisë që i ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe i largimit të ujërave të ndotura me popullsinë në zonën e juridiksionit të një shoqërie UK. Shoqëritë të cilat ofrojnë këtë shërbim, arrijnë të mbulojnë në nivel kombëtar mesatarisht 54.2% të popullsisë nga 52% e raportuar në vitin 2021, me një rritje prej 2.2%.

Ka ende 10 shoqëri të cilat nuk ofrojnë të dy shërbimet atë të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të ndotura, ky i fundit në të shumtën e rasteve kryhet nga ndërmarrjet brenda bashkive, pasi akoma pushteti vendor nuk e ka përfunduar kalimin e këtij shërbimi drejt shoqërive UK.

Investimet në këtë sektor kanë qenë të pakta dhe gjithmonë të diferencuara, më shumë i është kushtuar vëmendje shërbimit të furnizimit me ujë, gjithashtu ky diferencim ka ekzistuar edhe midis zonave urbane dhe rurale, me prioritet kanë patur zonat urbane prandaj dhe treguesi i mbulimit për të dyja shërbimet është më i lartë në zonat urbane.

Që shërbimi me kanalizime të jetë më cilësor nevojitet që të ketë impiante të trajtimit të ujërave të ndotura. Për vitin 2022, nga 11 (njëmbëdhjetë) impiantet ekzistuese, mbulimi me ITUN është raportuar 14.9% me një rritje prej 2.73% nga viti 2021. Për momentin vetëm 5 shoqëri kanë në funksionim impiant trajtimi të ujërave të ndotura, përkatësisht UK Korçë, UK Pogradec, UK Durrës, UK Lezhë, UK Shkodër të cilat janë të licencuara nga ERRU për të ofruar këto shërbime.

ITUN-të konsiderohen si shumë të rëndësishme për mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit, domosdoshmëria për ndërtim të impianteve të reja dhe vënia në punë me kapacitet të plotë e impianteve të ndërtuara do të rrisë ndjeshëm cilësinë e këtij shërbimi duke krijuar njëkohësisht mbrojtje më të madhe të mjedisit.

Analiza e mëposhtme merret vetëm me grumbullimin dhe largimin e ujërave të ndotura.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2022




Figura 20. Mbulimi me Kanalizime për Grupin e I-rë, Viti 2022

Në Grupin e I-rë të shoqërive, mbi kufirin 75% të performancës së mirë, performojnë vetëm 4 shoqëri, një me shumë se në vitin 2021, si UK Tiranë me 92.6 %, UK Sarandë me 83.5 %, UK Kamëz me 82.6 % dhe UK Korçë me 82.0%, të cilat duke i krahasuar me vitin paraardhës kanë pësuar një rritje të këtij treguesi UK Tiranë (+1.9 %), UK Sarandë (+3.9%) dhe UK Korçë me rritjen më të ndjeshme me (+16.7%). Ndërsa UK Kamëz është në të njëjtin nivel raportimi si për vitin 2021, por përsëri mbetet në shoqëritë me performancë të mirë me 82.6%.

Për vitin 2021, në nivelin e performancës 50% deri në 75% të këtij treguesi, performojnë 7 shoqëri UK Kavajë (74.0%), UK Vlorë (65.9%), UK Lezhë (62.8%), UK Durrës (59.4%), UK Elbasan (57%), UK Berat-Kuçovë (55.8%), UK Pogradec (52.7%), ndërsa në nivelin e performancës së dobët nën 50%, performojnë 3 shoqëri përkatësisht UK Shkodër (45.7%), UK Fier (43.9%) dhe UK Lushnje (38.4%).

Rritje të dukshme të këtij treguesi ka raportuar UK Korçë (+16.7 %) si shkak i shtimit të shërbimit në njësitë administrative Bulgaret, Mollë, Voskop, Voskopojë dhe Drenovë, duke çuar mbulimin me kanalizime në 82% nga 65.3% mbulim në vitin 2021. Rritje kanë pasur dhe disa shoqëri të këtij grupi, por nuk kanë kaluar 4% si UK Sarandë (+3.9%), UK Pogradec (+2.4%), UK Fier (+2.2%) dhe UK Vlorë (+2.0%). Shtatë shoqëri të tjera të këtij grupi kanë rritje nga 0.6% deri në 1.9%.

Trajtimi i ujërave të ndotura në këtë grup bëhet nga shoqëritë e licencuara UK Durrës, UK Pogradec, UK Korçë, UK Lezhë dhe UK Shkodër.

Ecuria e mbulimit me kanalizime, për shoqëritë e Grupit të I-rë, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 34.

Tabela nr.34 .Ecuria e mbulimit me kanalizime për Grupin I-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Korçë	UK	65.30	82.00	16.70
2	Sarandë	UK	79.60	83.50	3.90
3	Pogradec	UK	50.30	52.70	2.40
4	Fier	UK	41.70	43.90	2.20
5	Vlorë	UK	63.90	65.90	2.00
6	Durrës	UK	57.50	59.40	1.90
7	Tiranë	UK	90.70	92.60	1.90
8	Lezhë	UK	61.60	62.80	1.20
9	Shkodër	UK	44.60	45.70	1.10
10	Berat - Kuçovë	UK	54.80	55.80	1.00
11	Lushnje	UK	37.50	38.40	0.90
12	Kavajë	UK	73.40	74.00	0.60
13	Kamëz	UK	82.60	82.60	0.00
14	Elbasan	UK	57.00	57.00	0.00

Grupi 2 - Mbulimi me Kanalizime (%)




Figura 21. Mbulimi me Kanalizime për Grupin e II-të, Viti 2022

Në Grupin e II-të, për këtë tregues, kanë raportuar 27 shoqëri pasi 4 shoqëri nuk e kryejnë këtë shërbim UK Dropull, UK Devoll, UK Divjakë dhe U Gramsh.

Në këtë grup, për vitin 2022, 7 shoqëri kanë përmirësim të këtij treguesi me mbi 5%, 10 shoqëri kanë rritje pothuajse të papërfillshme, 12 shoqëri kanë nivel të njëjtë shërbimi si viti 2021, 2 shoqëri kanë pësuar rënie, por shumë të ulët, UK Peqini me (- 0.10%) dhe UK Përmet me (- 1.3 %).

Pjesa më e madhe e shoqërive të këtij grupi, 22 nga 31 shoqëri që ka grupi, vazhdojnë të mbeten nën nivelin e performancës së dobët prej 50%. Shoqëritë të cilat kanë përmirësim të konsiderueshme të këtij treguesi mbi 5% janë UK Bulqizë (+15.4 %) pasi ka marrë këtë shërbim nga Bashkia, UK Mallakastër (+12.0 %), UK Himarë (+8.7%), UK Selenicë (+7.7%), UK Belsh (+5.7%), UK Vorë (+5.6%) dhe UK Skrapar (+5.2%).

UK Kolonjë, për të tretin vit radhazi, raporton të njëjtin nivel të mbulimit me kanalizime prej 81.6% dhe është e vetmja shoqëri që performon mbi kufirin 75% të performancës së mirë.

Ecuria e mbulimit me kanalizime, për shoqëritë e Grupit të II-të, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 35.

Tabela nr.35. Ecuria e Mbulimit me Kanalizime për Grupin II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Bulqizë	UK	1.50	16.90	15.40
2	Mallakastër	UK	21.90	33.90	12.00
3	Himarë	UK	18.30	27.00	8.70
4	Selenicë	UK	31.30	39.00	7.70
5	Belsh	UK	14.50	20.20	5.70
6	Vorë	UK	50.90	56.50	5.60
7	Skrapar	UK	46.10	51.30	5.20
8	Mat	UK	46.70	49.60	2.90
9	Kukës	UK	39.90	42.00	2.10
10	Mirditë	UK	39.80	41.00	1.20
11	Gjirokastrë	UK	40.50	41.40	0.90
12	Maliq	UK	28.30	29.10	0.80
13	Kurbin	UK	37.00	37.60	0.60
14	Librazhd	UK	21.10	21.30	0.20
15	Cërrik	UK	29.10	29.30	0.20
16	Krujë	UK	25.70	25.80	0.10
17	Roskovec	UK	31.70	31.80	0.10
18	Dropull	UK	-	-	0.00
19	Devoll	UK	0.00	0.00	0.00
20	Divjakë	UK	-	-	0.00
21	Gramsh	U	0.00	0.00	0.00
22	Malësi e Madhe	UK	1.80	1.80	0.00
23	Rrogozhinë	UK	7.80	7.80	0.00
24	Ura Vajgurore	UK	14.60	14.60	0.00
25	Dibër	UK	17.40	17.40	0.00
26	Tropojë	UK	24.70	24.70	0.00
27	Delvinë	UK	38.10	38.10	0.00
28	Patos	UK	51.70	51.70	0.00
29	Kolonje	U	81.60	81.60	0.00
30	Peqin	UK	4.20	4.10	-0.10
31	Përmet	U	68.60	67.30	-1.30

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2022

Grupi 3 - Mbulimi me Kanalizime (%)




Figura 22. Mbulimi me Kanalizime për Grupin e III-të, Viti 2022

Grupi i III-të vazhdon të jetë grupi me performancën më të dobët për treguesin e mbulimit me kanalizime kjo dhe si rezultat i mungesës së investimeve në zonën rurale e cila zë një përqindje të lartë të hapësirës në zonën e tyre të shërbimit. Nga 13 shoqëri të këtij grupi, vetëm 7 shoqëri kanë raportuar të dhëna dhe do të analizohen për shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura.

Për vitin 2022, asnjë shoqëri e këtij grupi nuk ka mbulimin me kanalizime mbi 75% kufiri i performancës së mirë. Në kufirin 50 ÷ 75% mbulimi kanë vetëm UK Poliçan me (67.8%) dhe UK Tepelenë (50.4%). Nën nivelin e performancës së dobët 50% janë 5 shoqëri, UK Fushë - Arrëz me (34.5%), UK Memaliaj (31.90%), UK Pukë me (27.2%), UK Pustec me (24.1%) dhe UK Vau-Dejës me (6.2%). Nga grupi i III-të 6 shoqëri nuk e ofrojnë këtë shërbim pasi kjo e fundit kryhet nga Bashkitë respektive.

Përmirësim të këtij treguesi ka vetëm UK Tepelenë (+1.9%) dhe UK Pukë (+1.6%), por përsëri mbeten nën nivelin e performancës së dobët me 48.5% dhe 25.6% mbulim me kanalizime.

Ecuria e mbulimit me kanalizime, për shoqëritë e Grupit të III-të, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 36.

Tabela nr.36. Ecuria e Mbulimi me Kanalizime për Grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2021 (%)	2022 (%)	Ndryshimi 2022-2021 (%)
1	Tepelenë	UK	48.50	50.40	1.90
2	Pukë	UK	25.60	27.20	1.60
3	Poliçan	UK	67.80	67.80	0.00
4	Fushë Arrëz	UK	34.50	34.50	0.00
5	Memaliaj	UK	31.90	31.90	0.00
6	Vau i Dejës	UK	6.20	6.20	0.00
7	Finiq	UK	0.00	0.00	0.00
8	Has	U	0.00	0.00	0.00
9	Këlcyrë	UK	0.00	0.00	0.00
10	Klos	U	0.00	0.00	0.00
11	Konispol	UK	0.00	0.00	0.00
12	Libohovë	UK	0.00	0.00	0.00
13	Pustec	UK	24.30	24.10	-0.20

Përfundime

- Treguesi i mbulimit me shërbimet e KUN në vite ka qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel, me rritje pothuajse të papërfillshme. Këtë vit ky tregues është në nivelin 54.2% me një rritje prej 2.2% krahasuar me vitin 2021. Në vitin 2022 vetëm 5 shoqëri arrijnë të mbulojnë me shërbim mbi 75 % të popullsisë në zonën e juridiksionit, UK Tiranë, UK Sarandë, UK Kamëz, UK Korçë dhe UK Kolonjë.
- Nga të tre grupet, 13 shoqëri performojnë ndërmjet kufirit të performancës 50% dhe 75%, ndërsa shoqëritë e tjera arrijnë të mbulojnë me shërbim një përqindje të ulët të popullsisë në juridiksion.
- Trajtimi i ujërave të ndotura kryhet nga 5 shoqëri UK Durrës, UK Korçë, UK Pogradec, UK Shkodër (ITUN Velipojë + ITUN Shirokë) dhe UK Lezhë, të cilat janë të licencuara nga ERRU për të ofruar këto shërbime. Përsa i përket shoqërive UK Sarandë dhe UK Vlorë ende nuk kanë mundur të pajisen me lejen mjedisore, gjë që ka sjellë pengesë në marrjen e kategorisë D, për këto dy shoqëri.

- Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve duhet të jetë një nga sfidat kryesore për të gjitha shoqëritë UK të cilat gjatë hartimit të planeve të biznesit ku duhet të planifikojnë edhe investime dhe të vendosin objektiva për rritjen e këtij treguesi.
- Mbetet akoma problem respektimi i normave teknike për impiantet individuale të trajtimit të UN (gropat septike) për zonat rurale.
- Ndihet nevoja e rritjes së vëmendjes për investime në sektor, si në drejtim të zgjerimit të rrjeteve të mbledhjes dhe largimit të UN, edhe të ndërtimit të ITUN para se të derdhen në ambientin pritës në respektim të direktivave të BE-së mbi ujërat e ndotura dhe mjedisin

2.3.9 Efiçenca Energjisë

Treguesi “Efiçenca e Energjisë” është një tregues i vendosur për herë të parë në listën e treguesve kryesorë të performancës në vitin 2022 i përcaktuar në metodologjinë e re të tarifave, si një tregues shumë i rëndësishëm i performancës financiare të shoqërive UK dhe që duhet të monitorohet si nga shoqëria ashtu edhe nga ERRU.

Analiza e këtij treguesi bëhet për shkak se rritja e konsumit të energjisë elektrike është e lidhur drejtpërdrejt me rritjen e kostove operative. Kjo është reflektuar gjatë vitit 2022 ku si rezultat i krizës globale të energjisë pati një rritje të ndjeshme të kostove të energjisë elektrike në sektorin UK me rreth 40%.

Për vitin 2022 efiçenca e energjisë për shërbimin e furnizimit me ujë në sektor është 0.65 kwh/m³, por duke qenë viti i parë i vendosjes së këtij treguesi nuk mund të realizohet një analizë krahasimore me vitin e mëparshëm. Në tabelën nr. 37 të mëposhtme jepet efiçenca e energjisë për vitin 2022 për furnizimin me ujë për secilën nga 58 shoqëritë UK që operojnë në sektor. Nga tabela vihet re se janë 28 shoqëri UK të cilat e kanë efiçencën e energjisë mbi mesataren e sektorit e cila është 0.65 kwh/m³ duke filluar nga UK Patos me 3.32 kwh/m³ deri tek UK Elbasan me 0.66 kwh/m³. Pjesa tjetër e shoqërive, 30 prej tyre kanë këtë tregues nën mesataren e sektorit duke filluar me UK Korçë 0.64 kwh/m³ deri tek UK Fushë Arrëz e cila e ka zero këtë tregues si rezultat i sistemit të furnizimit me ujë me vetërrjedhje.

Ky tregues merr një rëndësi të veçantë kur kemi parasysh se në mbyllje të vitit 2022 në sektor janë 45 shoqëri UK nga 58, që nuk arrijnë të mbulojnë kostot O&M. Kostot e energjisë elektrike në sektorin e UK zënë rreth 34% të totalit të kostove O&M. Pra janë disa shoqëri të cilat nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M dhe mbijetesën financiare e sigurojnë me anë të subvencioneve nga qeveria qendrore, ose duke mos paguar faturën e energjisë elektrike ndaj OSHEE-së. Kjo gjendje ka sjellë një borxh të akumuluar të sektorit ndaj OSHEE i cili në mbyllje të vitit 2022 rezultoi rreth 14 miliard lekë ose (122.4 milion Euro). Në Aneks 13, tabela 53 jepen të detajuara të dhënat e detyrimeve ndaj OSHEE për secilën shoqëri UK të grupuara sipas reformës në shoqëri UK Rajonale.

Nisur nga kjo situatë është e rëndësishme që çdo shoqëri UK duhet të disponojë një raport të efiçencës së energjisë, në të cilin analizohet efikasiteti i përdorimit të energjisë elektrike, kryesisht në stacionet e pompimit të ujit të pijshëm e të ujërave të ndotura, si dhe në ITUN. Kjo pasi mbulimi i kostove të energjisë elektrike jo në të gjitha rastet mund të realizohet nga rritja e të ardhurave nëpërmjet rritjes së tarifës për FU dhe KUN, pasi në pjesën më të madhe të shoqërive kërkohet një rritje tarife shumë e lartë dhe e menjëhershme, që mund të krijojë reagim negativ nga konsumatorët për mospagimin e faturës së ujit. Gjithashtu një tjetër element që duhet patur në konsideratë është edhe përballueshmëria e faturës për konsumatorët, e cila nuk duhet të kalojë vlerën prej 5% të shpenzimeve mesatare mujore për familje. Gjithsesi kjo kërkon një analizë të detajuar dhe duhet parë rast pas rasti për secilën shoqëri.

Tabela nr.37. Efiçenca e energjisë për furnizimin me Ujë për secilën shoqëri UK, viti 2022

Nr.	Aktiviteti	Shoqëritë	Efiçenca e Energjisë Kw FU/m ³
1	UK	Patos	3.32
2	UK	Konispol	2.33
3	UK	Belsh	2.20
4	UK	Memaliaj	2.05
5	UK	Peqin	1.79
6	UK	Durrës	1.61
7	UK	Mallakastër	1.51
8	UK	Vorë	1.42
9	UK	Cërrik	1.41
10	UK	Poliçan	1.34
11	UK	Lezhë	1.32
12	UK	Ura Vajgurore	1.09
13	UK	Sarandë	1.08
14	UK	Rrogozhinë	1.08
15	UK	Maliq	1.03
16	UK	Kurbin	0.93
17	UK	Himarë	0.90
18	UK	Shkodër	0.87
19	UK	Skrapar	0.86
20	UK	Vau Dejës	0.80
21	UK	Vlorë	0.77
22	UK	Lushnje	0.77
23	UK	Tepelenë	0.77
24	UK	Pustec	0.76
25	UK	Delvinë	0.73
26	UK	Fier	0.70
27	UK	Pogradec	0.68
28	UK	Elbasan	0.66
29	UK	Kavajë	0.65
30	UK	Korçë	0.64
31	UK	Divjakë	0.64
32	U	Has	0.61
33	UK	Dropull	0.51
34	UK	Selenicë	0.48
35	UK	Libohovë	0.44
36	UK	Devoll	0.28
37	UK	Këlcyrë	0.27
38	UK	Tiranë	0.22
39	UK	Përmet	0.22
40	UK	Bërat Kuçovë	0.19
41	UK	Gramsh	0.19
42	UK	Gjirokastër	0.18
43	UK	Mirditë	0.15
44	UK	Finiq	0.10
45	UK	Kamëz	0.05
46	UK	Librazhd	0.03
47	UK	Mat	0.02
48	UK	Bulqizë	0.02
49	UK	Tropojë	0.02
50	UK	Dibër	0.01
51	UK	Kukës	0.01
52	UK	Malesi_e_Madhe	0.01
53	UK	Ersekë	0.01
54	UK	Pukë	0.01
55	UK	Krujë	0.00
56	UK	Roskovec	0.00
57	U	Klos	
58	UK	Fushë Arrëz	
Totali			0.65

2.3.10 Ankesat e Klientëve

“Ankesat e Klientëve” edhe ky është një tregues i ri i vendosur për herë të parë për tu marrë në analizë gjatë vitit 2022 si një tregues shumë i rëndësishëm i cili lidhet direkt me cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe mbrojtjen e interesave të tyre. Vendosja e këtij treguesi si pjesë e treguesve kryesorë të performancës për tu vendosur edhe si objektiva për shoqëritë UK, lidhet edhe me angazhimin e ERRU-së në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit. Në këtë kontekst, ERRU, ka krijuar brenda strukturës organizative Strukturën e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjes (SZAM), si struktura përgjegjëse brenda rregullatorit për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorit dhe shoqërisë UK në sektorin FU dhe KUN.

Në tabelën nr.38 të mëposhtme jepen ankesat e klientëve në raport me numrin total të lidhjeve të sektorit UK, ku për vitin 2022 rezulton të jenë në nivelin e 2.8%, por edhe në këtë rast nuk mund të bëhet një analizë krahasimore me vitin paraardhës. Referuar tabelës vihet re se 36 shoqëri UK e kanë këtë tregues nën mesataren e sektorit ku bëjnë pjesë shoqëri nga të tre grupet të mëdha dhe të vogla, ndërsa 22 prej tyre e kanë këtë tregues mbi mesataren e sektorit duke filluar me UK Dibër 2.87% deri tek UK Memaliaj me 17.29%. Kjo është edhe shoqëria me nivelin më të lartë të ankesave të konsumatorëve për shkak se kjo shoqëri është krijuar në vitin 2020 si rezultat i ndarjes me UK Tepelenë ku ka qenë pjesë më parë duke krijuar kështu konfuzion tek klientët në zonën e shërbimit pas ndarjes.

Natyra e ankesave të klientëve paraqitet kryesisht në tre kategori “zbatueshmëria e kushteve të kontratës për shërbime ujësjellës kanalizime”, “cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK” dhe “faturimi aforfe”.

Në kuadër të edukimit të konsumatorëve dhe shoqërive UK për rolin ndërmjetësues që ka rregullatori për trajtimin e ankesave, orientimi dhe trajtimi i disa prej ankesave përgjatë vitit 2022 është kryer nëpërmjet strukturës së ngritur pranë ERRU-së për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve. Theksohet fakti se konsumatorët i drejtojnë ankesat që kanë ndaj shoqërive UK, pranë ERRU-së, pasi kanë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për zgjidhjen e tyre me këto të fundit.

Rastet e faturimit aforfe ku konsumatorët faturohen më shumë se norma e konsumit mujor për person e parashikuar në rastet kur konsumatori nuk ka ujëmatës, vijojnë të jenë objekt i ankesave pranë ERRU, por në shumë raste është evidentuar se konsumatorët familjarë, të cilët janë ankuar për faturimin aforfe kanë qenë konsumatorë të cilët janë me kolona të përbashkëta të furnizimit me ujë. ERRU i ka sugjeruar shoqëritë UK për hartimin e planeve të veprimit konkrete nga ana e shoqërive UK për zgjidhjen e këtyre rasteve të ankimit dhe eliminimin përfundimtar të faturimit aforfe të konsumatorëve familjarë.

Tabela nr.38. Ankesat e klientëve për secilën shoqëri UK, viti 2022

Nr.	Aktiviteti	Shoqëritë	% e Ankesave të Klientëve
1	UK	Korçë	0.00%
2	UK	Kavajë	0.00%
3	UK	Maliq	0.00%
4	UK	Devoll	0.00%
5	UK	Kukës	0.00%
6	UK	Divjakë	0.00%
7	UK	Patos	0.00%
8	UK	Mallakastër	0.00%
9	UK	Gramsh	0.00%
10	UK	Përmet	0.00%
11	UK	Ura Vajgurore	0.00%
12	UK	Ersekë	0.00%
13	UK	Peqin	0.00%
14	UK	Poliçan	0.00%
15	UK	Finiq	0.00%
16	UK	Konispol	0.00%
17	UK	Këlcyrë	0.00%
18	U	Has	0.00%
19	UK	Pustec	0.00%
20	UK	Tiranë	0.13%
21	UK	Malesi_e_Madhe	0.42%
22	UK	Belsh	0.46%
23	UK	Kurbin	0.83%
24	UK	Kamëz	0.85%
25	UK	Tropojë	0.96%
26	UK	Krujë	1.02%
27	UK	Fushë Arrëz	1.28%
28	UK	Durrës	1.75%
29	UK	Cërrik	1.79%
30	UK	Bulqizë	2.03%
31	UK	Pukë	2.16%
32	UK	Sarandë	2.19%
33	UK	Dropull	2.29%
34	UK	Elbasan	2.45%
35	UK	Skrapar	2.59%
36	UK	Rrogozhinë	2.69%
37	UK	Dibër	2.87%
38	UK	Himarë	3.07%
39	UK	Selenicë	3.51%
40	UK	Lushnje	3.83%
41	UK	Mat	3.99%
42	UK	Pogradec	4.12%
43	UK	Lezhë	4.42%
44	UK	Roskovec	4.55%
45	UK	Tepelenë	5.38%
46	UK	Vau Dejës	5.61%
47	UK	Mirditë	6.11%
48	UK	Librazhd	6.21%
49	UK	Fier	6.28%
50	UK	Bërat Kuçovë	6.71%
51	UK	Delvinë	6.97%
52	U	Klos	7.12%
53	UK	Gjirokastër	9.02%
54	UK	Vlorë	11.22%
55	UK	Shkodër	11.67%
56	UK	Libohovë	13.02%
57	UK	Vorë	13.28%
58	UK	Memaliaj	17.29%
		Totali	2.8%

Renditja e Shoqërive UK Sipas Performancës

Për të vlerësuar arritjet në performancën e shoqërive UK në sektor edhe gjatë vitit 2022 u përzgjedhën katër Tregues Kryesorë të Performancës, të cilët lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive, si dhe të cilësisë së shërbimit që ato i ofrojnë konsumatorëve, respektivisht, Mbulimi i Kostove të O&M, Norma Korrente e Arkëtimit, Uji Pa të Ardhura dhe Vazhdimësia (Orët) e Furnizimit me Ujë.

Bazuar në mesataren e renditjes të katër treguesve të mësipërm, në klasifikimin e përgjithshëm shoqëria me performancën më të mirë për vitin 2022 u rendit Shoqëria UK Korçë, e ndjekur nga shoqëritë UK Lezhë, dhe UK Kolonjë. Ndërsa, shoqëritë me performancë më të dobët në sektor u klasifikuan shoqëritë UK Kurbin, UK Has, dhe UK Krujë (shih Aneks 6, tabela 45).

Gjithashtu një klasifikim tjetër për performancën më të mirë u realizua bazuar në ndarjen në tre grupe të shoqërive UK, që i referohen numrit të lidhjeve që ato administrojnë (shih aneks 7, tabela 46). Për grupin e parë, performancën më të mirë e ka UK Korçë, ndërsa më keq ka performuar UK Kamëz, e cila për performancën në sektor zë vendin 56, nga 58 në total. Për grupin e dytë, performancën më të mirë e ka UK Kolonjë, ndërsa më keq ka performuar UK Kurbin, e cila për performancën në sektor zë vendin e fundit. Ndërsa, për grupin e tretë, performancën më të mirë e ka UK Poliçan, e cila për performancën në sektor zë vendin e 11, dhe shoqëria që ka performuar më keq është UK Has, e cila në sektor zë vendin e 57.

3 Reforma në Sektorin UK Sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022

Në maj 2022, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 302, *“Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”* miratoi reformën në sektorin UK, e cila konsiderohet si fillimi i një reforme rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri, e cila ka si qëllim agregimin e sektorit UK në 15 shoqëri UK rajonale, nga 58 shoqëri UK që ofrojnë shërbimin e FU dhe KUN në 61 bashki të vendit. Objektivi kryesor i këtij procesi është që nëpërmjet ekonomisë së shkallës të përmirësuar cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve UK.

Reforma në mënyrë të përmbledhur parashikon si më poshtë:

- Riorganizimi i shoqërive UK si Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta (SKP-UK) do të kryhet nëpërmjet krijimit të shoqërive të reja aksionare me dy nivele administrimi, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*, i ndryshuar.
- Njësitë e qeverisjes vendore që bien dakord për themelimin e SKP-UK-së së re do të ndjekin statutin e modelit standard që shërben si akt themelor për themelimin e SKP-UK-së. SKP-UK do të kryejë veprimtarinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonat e shërbimit sipas hartës territoriale, të miratuar nga AKUM.
- SKP-UK-ja e themeluar do të ketë në asamblenë e aksionarëve përfaqësues të qeverisë qendrore MIE, e cila do të mbajë të paktën 51% të aksioneve. Pjesa e mbetur prej 49% do llogaritet në raport me numrin e klientëve aktivë që kanë shoqëritë ekzistuese në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për themelimin e shoqërisë rajonale UK.

- SKP-UK-të e krijuara janë të detyruara të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktuale, kontratat e shërbimeve, si dhe çdo të drejtë që rrjedhin prej tyre, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, ndërmarrjeve të ujësjellësit dhe ish-njësive të qeverisjes vendore, me institucionet financiare ndërkombëtare dhe kompanitë kontraktuese.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me dokumentet strategjike sektoriale të miratuara, do të ndajë të gjitha fondet e planifikuara për investime nga buxheti i shtetit apo institucionet financiare ndërkombëtare vetëm përmes SKP-UK-së së re.
- Bashkitë që bien dakord të marrin pjesë në procesin e riorganizimit, duhet të miratojnë dhe të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm të kërkuar nga ligjet në fuqi për të vazhduar me transferimin e aktivitetit aktual të ndërmarrjes së ujësjellësit tek SKP-UK dhe do të procedojnë sipas dispozitave të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në përputhje me riorganizimin dhe planin kombëtar të hartuar nga AKUM.
- SKP-UK e re e krijuar nga riorganizimi në përputhje me hartën e ndarjes territoriale të hartuar nga AKUM, brenda tre muajve nga miratimi i Prefektit të Qarkut, do të aplikojë për marrjen e licencës së re për ofrimin e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU).
- Transferimi i aktivitetit do të bazohet në një kontratë të noterizuar (marrëveshje transferimi) që do të nënshkruhet ndërmjet palëve (transferuesit dhe marrësi i transfertës), e cila do të regjistrohet në pasqyrat financiare të Shoqërive të reja.

Procesi i riorganizimit për agregimin e sektorit ka ecur me ritme të shpejta, duke u ndjekur me shumë intensitet nga AKUM, si institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij procesi. Kjo konstatohet edhe nga fakti se deri në mbyllje të vitit 2022 janë arritur marrëveshjet e transferimit të aktivitetit të shërbimeve UK ndërmjet 50 bashkive, si rrjedhojë janë krijuar 12 shoqëri UK Rajonale, nga 15 të parashikuara sipas reformës. Shoqëritë e reja Rajonale të krijuara janë **SKP Korçë, SKP Pogradec, SKP Durrës, SKP Lezhë, SKP Dibër, SKP Kukës, SKP Berat, SKP Elbasan, SKP Gjirokastrë, SKP Fier, SKP Lushnje dhe SKP Sarandë**.

Mbeten akoma 11 bashki, të cilat sipas parashikimeve të reformës në sektor përbëjnë 3 shoqëri UK Rajonale, përkatësisht **SKP Shkodër**, e cila përfshin bashkitë Shkodër, Vau Dejës, Malësi e Madhe, Fushë Arrëz, Pukë; **SKP Tiranë**, e cila përfshin bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë; dhe **SKP Vlorë**, e cila përfshin bashkitë Vlorë, Selenicë, Himarë, që nuk kanë arritur të kryejnë marrëveshjet e bashkëpunimit, edhe pse nga ana Këshillave Bashkiakë të këtyre bashkive janë marrë vendimet përkatëse, të cilat autorizojnë kryetarët e bashkive për të nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me MIE dhe më pas transferimit drejt shoqërisë UK Rajonale. Vonesat në krijimin e këtyre 3-shoqërive UK Rajonale brenda vitit 2022 sipas parashikimeve të VKM nr.302, vijnë si rezultat i diskutimeve në vazhdim për pika të veçanta të procesit ndërmjet drejtuesve të pushteteve vendore dhe MIE. Në aneks 1, tabela 40 jepet situata e licencimit të shoqërive UK për vitin 2022 me ndarjen sipas reformës.

ERRU, në vijim të reformës dhe hapave që duhen ndjekur për konkretizimin e saj, ka luajtur një rol proaktiv duke ndërmarrë vendimet e nevojshme në drejtim të licencave dhe tarifave, të cilat i shërbejnë përshtetimit dhe ecurisë së këtij procesi. Kështu, KKRR, me vendimin Nr. 420, datë, 29.09.2022 “Për licencat dhe tarifën e shërbimit të operatorëve UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në subjekte me kompetenca të përbashkëta”, ka lehtësuar ecurinë e këtij procesi, i cili në pikën 1 dhe 3 të tij shprehet si më poshtë:

- 1) *Shoqërive ujësjellës-kanalizime të cilat janë të pajisura me licencë nga ERRU për operatorët që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", dhe kanë firmosur marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta (SKP) sipas vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", **ERRU u jep të drejtën e transferimit të licencave ekzistuese në Subjektin e Kompetencave të Përbashkëta.***
- 2) ***Shoqëritë SKP-UK do të përdorin tarifat aktuale për zonat e shërbimit të miratuara nga ERRU, deri në miratimin e tyre, nga Komisioni Kombëtar Rregullator.** SKP mbas marrjes së licencës nga ERRU, paraqet aplikimin për rishikimin dhe miratimin e tarifave, që do të kryhet bazuar në të dhënat e një viti ushtrimor të aktivitetit të shoqërisë SKP. Procedurat për miratimin e tyre do të kryhen në përputhje me nenin 22 të ligjit 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator Nr.539, datë 30.12.2021 "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime".*

Vendimin e mësipërm ERRU e ka ndërmarrë në zbatim të VKM nr. 302, datë 11.05.2022, të cilat kanë pasur si qëllim eliminimin e burokracive, duke përshpejtuar sa më shumë ecurinë e zbatimit të reformës dhe njëkohësisht duke respektuar legjislacionin në fuqi për proceset e licencimit dhe të miratimit të tarifave të shoqërive UK-SKP.

Agregimi i sektorit është një proces kompleks, i cili, gjatë zbatimit të tij në terren do të hasë shumë sfida dhe të panjohura, të cilat kërkojnë vëmendje nga qeveria qendrore, në drejtim të manaxhimit të aseteve ekzistuese dhe planifikimit sa më të drejtë të investimeve të nevojshme që duhen kryer, për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve, si synimi final i këtij procesi.

4 Konkluzione dhe Rekomandime

- Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara pranë ERRU-së, për mjaft shoqëri UK, vijon të ketë probleme. Shoqëritë UK duhet të punojnë në drejtim të rritjes së profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë për saktësinë e të dhënave të raportuara duke respektuar procedurat për shkallën e saktësisë së tyre të përcaktuara në metodologjinë e re të vendosjes së tarifave të shërbimeve UK.
- Efiçenca e energjisë duhet të jetë në fokus të shoqërive UK, pasi ky zë shpenzimesh mbetet si kryesor dhe pritshmëria është që mund të ketë akoma rritje për shkak të situatës energjitike në rang global dhe të ndryshimit të kushteve të klimës. Fokusi duhet të jenë kryesisht shoqëritë që pjesën më të madhe të sistemeve të FU e kanë me ngritje mekanike. Këto shoqëri duhet të studiojnë mundësitë për burime alternative të pavarura furnizimi me energji elektrike të rinovueshme.
- Në zbatim të reformës në sektor synohet një përmirësim i dukshëm financiar i operimit të shoqërive rajonale, pra që ato të mund të mbulojnë mbi 100% të kostove të O&M. Në këtë kuadër të mundësohet nga vetë shoqëritë, donatorët ose QQ financimi dhe asistenca e nevojshme për hartimin e Planeve 5 Vjeçare të Biznesit për këto shoqëri që është kusht i domosdoshëm për aplikimin pranë ERRU-së për tarifa të reja, dhe që konsiderohet si instrumenti bazë i vizionit të menaxhimit të shoqërisë për përmirësimin e performancës financiare dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve.
- Shoqëritë rajonale duhet të hartojnë Planet e Menaxhimit të Aseteve si instrumenti bazë që justifikon kërkesat dhe nevojat për financimin e investimeve fizike, si dhe efikasitetin e pritshëm të tyre në operimin e shoqërisë dhe uljen e kostove të tyre.
- Uji Pa të Ardhura në nivelin e 63.7%, vazhdon të jetë në nivele mjaft të larta dhe të papranueshme pavarësisht një përmirësimi të lehtë të këtij treguesi. Shoqëritë rajonale duhet të kenë në fokusin e tyre kryesor reduktimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme dhe të humbjeve fizike. Nga ana tjetër për një vlerësim real të gjendjes së humbjeve dhe të hartimit nga shoqëritë të bilanceve të ujit sa më të sakta, mbetet e një rëndësie të veçantë financimi dhe instalimi i matësve të mëdhenj të ujit në burim dhe ato individualë tek konsumatorët privat dhe familjarë. Bilancet e ujit përcaktojnë gjendjen reale të kërkesës për ujë dhe shërbejnë si bazë për hartimin e planeve për reduktimin e humbjeve dhe mbrojtjen e burimeve nga mbikonsumi i pajustificuar.
- Kostot e punës zënë aktualisht 43% në kostot O&M të shoqërisë. Treguesi i efiçencës së stafit në nivelin 4.73 punonjës për 1000 lidhje UK tregon se ka mjaft hapësirë për reduktimin e tij nga punonjësit e tepërt në numër dhe pozicione të pajustificuara. Shoqëritë UK në kuadër edhe të riorganizimit si rezultat i reformës duhet të rishikojnë organigramën dhe pozicionet e punës bazuar në një analizë të detajuar për të justifikuar numrin e punonjësve në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të saj, kërkesë e cila theksohet në veçanti nga ERRU kur shoqëritë UK aplikojnë për tarifa të reja.
- Shoqëritë UK të cilat nuk janë riorganizuar akoma si shoqëri UK Rajonale, rekomandohet ta përmbyllin sa më parë këtë proces si një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të performancës, efiçencës operacionale dhe qëndrueshmërisë financiare të tyre.

5 Tema e Veçantë: Metodologjia e Miratimi të Tarifave të Shërbimeve UK dhe Ndikimi i Saj në Reformën në Sektor.

I. Të Përgjithshme

Një nga dokumentet më të rëndësishme të veprimtarisë rregulluese të ERRU-së është metodologjia e miratimit të tarifave, e cila ka për qëllim rregullimin e sektorit UK në Shqipëri. Përcaktimi i rregullave dhe procedurave që duhen ndjekur dhe zbatimi i tyre me korrektësi nga të gjitha shoqëritë UK, por edhe nga ERRU, sjell përmirësimin e performancës së tyre, si dhe rritje të cilësisë së shërbimeve dhe qëndrueshmëri financiare. Fokusi i saj qendron gjithashtu në mbrojtjen e konsumatorëve nga një çmim i pajustificueshëm apo i papërbalueshëm.

Në fund të vitit 2021, ERRU miratoi një model të ri të llogaritjes së tarifave që bazohet tek nevoja për të ardhura. Nevoja për rishikimin e metodologjisë së tarifave lindi si rezultat i mungesës së disa elementeve thelbësore në funksion dhe përmbajtje.

Procedura për vendosjen e tarifave, bazuar në ligjin nr. 8102 datë 28.03.1996 fillon me propozimin e bërë nga i licencuari dhe periudha rregullatore afatshkurtër sipas metodës së mëparshme nuk e ndërlidh tarifën me arritjen e objektivave të parashikuara, në mënyrë që i licencuari të nxitet të aplikojë për tarifë dhe ERRU të ketë kontroll të vazhdueshëm mbi këto tarifa. Pas miratimit të tarifave, shoqëritë UK nuk paraqiteshin për aplikim për një periudhe shumë të gjatë kohore, kështu çmimet për njësi që llogarisin kostot pësonin rritje qoftë duke marrë parasysh vetëm inflacionin vit pas viti. Si rezultat i propozimeve të shoqërive UK për tarifa pas një kohe të gjatë pritje, për shkak të rritjes së kostove, tarifat kërkojnë rritje të menjëhershme, e cila sipas analizave të ERRU-së mund të jenë të papërbalueshme nga konsumatorët dhe të ndikojnë në uljen e normës së arkëtimit të faturave. Gjatë kësaj periudhe, në analizat e saj, ERRU është kujdesur që të paraqesë në mënyrë të qartë nevojat për subvencione, duke qenë se të ardhurat nga tarifat nuk mbulojnë të gjitha kostot e veprimtarisë UK.

Sipas metodologjisë së mëparshme, kostot variabël duhet të mbuloheshin nga tarifa variabël dhe kostot fikse të mbuloheshin nga tarifa fikse. Duke qenë se pjesën më të madhe të kostove operative e përbëjnë kostot fikse, tarifa e llogaritur prej tyre rezultonte shumë e lartë. Përmbajtja e zërave të kostove nuk përcaktohej në mënyrë të detajuar, duke krijuar konfuzion në raportimet e të dhënave për kostot, verifikimi i të cilave ka qenë një nga vështirësitë që ERRU ka hasur vazhdimisht. Gjithashtu gjobat, kamatat dhe kostot për aktivitete të parregulluara siç janë lidhje, rilidhje apo shërbime të tjera të ofruara nga operatori nuk paraqiteshin në mënyrë të veçantë sipas kërkesave të ERRU-së.

Përmirësimi i situatës financiare të shoqërive UK çdo vit, krijon mundësi që me të ardhurat e gjeneruara të përmbushen nevojat për investime, prandaj në llogaritjen e tarifave njohja e kostove të amortizimit me normat rregullatore, kostove të huasë dhe kostove të kthimit mbi kapitalin e investuar, do të mund të realizonte investimet me vetëfinancim apo me financim nga të tretë.

Në metodën e mëparshme nuk përfshiheshin sistemet e informacionit sipas kërkesave të ERRU-së, në mënyrë që të verifikohen të dhënat në çdo kohë, prandaj cilësia e dobët e tyre ndikon si në llogaritjen e tarifës, ashtu edhe në përcaktimin e objektivave jo reale. Gjithashtu, politikat e ndërfinancimit midis kategorive të klientëve nuk përcaktonin në raporte ndërmjet tyre kufij duke krijuar shpesh herë një hendek të madh midis tarifës së familjarëve dhe asaj për jofamiljarë.

II. Metodologjia e Re e Tarifave

Shoqëritë mund të aplikojnë për tarifa nëse të ardhurat nga tarifat nuk mbulojnë kostot e pranuar nga ERRU, si edhe në rastet kur bashkohen zona shërbimi me tarifa të ndryshme, kur tarifave u mbaron afati, apo edhe kur kostot ndryshojnë për shkaqe të jashtëzakonshme. Sipas metodologjisë së re, shoqëritë UK

duhet të bazohen në objektivin e mbulimit të kostove për të përcaktuar se cilën metodë aplikimi do të duhet të zbatojnë: Metodën “Kosto Plus” apo Metodën “Çmimi Tavan”.

1. Metoda Kosto Plus

Metoda “Kosto Plus” zbatohet për shoqëritë që kanë për objektiv mbulimin deri në 100% të kostove të pranuar operacionale. Periudha rregullatore përcaktohet nga Komisioni Kombëtar Rregullator deri në 3 vite, në të cilën shoqëria duhet të jetë në monitorim të vazhdueshëm nga ERRU të zbatojë tarifat e vendosura sipas vendimit të KKRR dhe të realizojë objektivat e vendosura gjatë kësaj periudhe.

Nevojat për të ardhura llogariten vetëm me kostot e pranuar operacionale (OPEX) të paraqitura në modelin e aplikimit për secilin shërbim më vete. Struktura tarifore përbëhet nga tarifa fikse dhe tarifa volumetrike. Tarifa fikse/muaj përcaktohet për të gjithë klientët për të financuar disponibilitetin e shërbimit në çdo kohë dhe llogaritet për të mbuluar deri 30% të kostove operacionale. Tarifa volumetrike/m³ aplikohet vetëm për klientët aktiv, përcaktohet bazuar tek kostot e secilit shërbim dhe llogaritet për pjesën e mbetur të kostove. Sipas kësaj metode tarifat nuk ndryshojnë gjatë periudhës rregullatore, por përditësohen në fund të saj.

ERRU monitoron shoqërinë çdo vit, verifikon të dhënat e raportuara nëpërmjet sistemeve të informacionit që shoqëritë janë të detyruara të krijojnë dhe të mirëmbajnë, si edhe vlerëson realizimin e objektive të planifikuara. Për mosrealizimin e objektive të vendosura nga ERRU aplikohet një penalitet, i cili ka efekt në zvogëlimin e tarifës; për realizimin e objektive nuk aplikohen ndryshime; për tejkalimin e objektive aplikohet një bonus, i cili ka efekt në rritjen e tarifës. Në këtë mënyrë, ERRU nxit shoqëritë UK të jenë më të përgjegjshme për të arritur objektivat që planifikohen.

2. Metoda “Çmimi Tavan”

Metoda “Çmimi Tavan” zbatohet për shoqëritë që mbulojnë kostot operacionale dhe planifikojnë investime që e justifikojnë dhe vërtetojnë nevojën e tyre, pasi optimizojnë kostot, rrisin sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve dhe përmirësojnë treguesit kryesorë të performancës. Sipas kësaj metode, shoqëritë plotësojnë modelin 5 vjeçar të aplikimit, bazuar në një plan biznesi 5-vjeçar dhe planin tarifor. Për këto shoqëri, ERRU zbaton periudhë rregullatore 5 vjeçare, gjatë të cilës shoqëria duhet të jetë në monitorim të vazhdueshëm nga ERRU të zbatojë tarifat e vendosura sipas vendimit të KKRR dhe të realizojë objektivat e planifikuara gjatë kësaj periudhe.

Nevojat për të ardhura llogariten me kostot e pranuar operacionale (OPEX), kostot kapitale (CAPEX) dhe kostot e kthimit mbi kapitalin e investuar, të paraqitura në modelin e aplikimit për secilin shërbim më vete. Kostot kapitale përfshijnë kostot që do të financojnë investimet nga burimet financiare të vet shoqërisë (kostot e amortizimit të llogaritura sipas normave rregullatore) dhe burimet financiare të jashtme (kostot vjetore të principalit të huave).

Struktura tarifore përbëhet nga tarifa fikse dhe tarifa volumetrike. Tarifa fikse/muaj përcaktohet për të gjithë klientët për të financuar disponibilitetin e shërbimit në çdo kohë dhe llogaritet për të mbuluar deri 30% të kostove operacionale. Kjo tarifë përditësohet në fund të periudhës rregullatore.

Tarifa volumetrike/m³ aplikohet vetëm për klientët aktiv, përcaktohet bazuar tek kostot e secilit shërbim dhe llogaritet për pjesën e mbetur të kostove. Plani tarifor për secilin shërbim aprovohet në fillim të periudhës rregullatore, por tarifa hyn në fuqi vetëm pas përditësimit të saj nga ERRU në fund të vitit. Tarifa volumetrike përditësohet çdo vit në fund të vitit për vitin e ardhshëm, pasi ERRU monitoron shoqërinë çdo vit, verifikon të dhënat e raportuara nëpërmjet sistemeve të informacionit që shoqëritë janë të detyruara të krijojnë dhe të mirëmbajnë, si edhe vlerëson realizimin e objektive të planifikuara.

ERRU në përditësimin tarifor konsideron:

- normën e inflacionit, e cila aplikohet mbi tarifën e aprovuar;
- efikasitetin e kostos së shoqërisë, krahasuar me efikasitetin e kostove të të gjithë sektorit, i cili aplikohet mbi normën e inflacionit;
- nivelin e realizimit të objektivave, të cilat konvertohen në penalitet ose bonus mbi tarifën e aprovuar.

Procesi për zbatimin dhe funksionimin e këtyre metodave përshkruhet në detaje në metodologjinë e re, të tarifave të miratuar nga ERRU me Vendimin nr. 539 datë 30.12.2021 të KKRR “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”.

ERRU, në metodologjinë e re i ka kushtuar një rëndësi të veçantë ngritjes së sistemeve të informacionit si një element kryesor për zbatimin e kësaj metodologjie duke kërkuar standarde për mbajtjen e të dhënave ku sipas metodologjisë shoqëria është e detyruar të ketë një procedurë dhe rregullore zyrtare për hedhjen, mirëmbajtjen dhe kontrollin e të dhënave, të cilat duhet patjetër të bazohen në dokumente që mund të kontrollohen.

ERRU për të nxitur zbatimin e këtij standardi e ka ndërlidhur cilësinë e informacionit të raportuar me llogaritjen e tarifave në mënyrë që të aplikohet një korrigjim financiar në rast se shoqëria nuk i përmbush kërkesat për krijimin e sistemeve të informacionit.

Raportimi i të dhënave është kthyer në një sfidë edhe për shoqëritë UK, të cilat përveç ERRU-së duhet të plotësojnë manualisht formate të ndryshme edhe për institucione të tjera, prandaj ERRU sugjeron ngritjen e sistemeve të përbashkëta të informacionit në mënyrë që edhe shoqëritë UK ta kenë me të lehtë raportimin, por edhe informacioni të jepet i saktë dhe i unifikuar për të gjithë aktorët e sektorit të ujit në Shqipëri.

Shoqëritë UK financohen, pra krijojnë të ardhurat e nevojshme nëpërmjet tarifave, prandaj ERRU mban përgjegjësi për llogaritjen e nevojave për të ardhura për këto shoqëri.

Tarifat e shërbimeve UK përveç se ndikohen nga rritja e çmimeve për mallra e shërbime, rritja e pagave minimale etj., ndikohen edhe nga investimet e reja. Investimet e kryera me financim të jashtëm rrisin kostot e principalit të huasë, por edhe kostot e amortizimit vjetor që janë kosto që njihen në përcaktimin e tarifave. Investimet e kryera nga financimi i brendshëm rrisin kostot e amortizimit vjetor, por edhe vlerën bazë të aseteve që rrjedhimisht ndikojnë me rritje në tarifë. Tarifa ndikohet gjithashtu nga humbjet e ujit në rrjet, pasi ajo llogaritet nga vëllimi i faturuar dhe jo nga ai i prodhuar, prandaj tarifa mbulon dhe kostot e ujit të humbur. Tarifa ndikohet edhe nga lëvizjet demografike apo shtimi i rrjetit, të cilat rrisin apo zvogëlojnë vëllimet e faturuara.

Tarifa është komplekse dhe ndikohet nga të gjitha variablat që llogarisin treguesit e performancës, prandaj monitorimi i të gjitha të dhënave nga ERRU është një element kyç në realizimin e të gjithë procesit tarifor dhe realizimit të performancës së mirë.

Ndryshimi i Tarifave për Shkaqe të Jashtëzakonshme

Ndryshimi i tarifave për shkaqe të jashtëzakonshme përbën risi në metodologjinë e re të tarifave në përshtatje me sfidat e kohës me të cilat po përballlet njerëzimi që kanë impakt të drejtpërdrejtë në rritjen e përgjithshme të çmimeve. Inflacioni është një fenomen global i nxitur fillimisht nga pandemia Covid-19 dhe më pas lufta në Ukrainë, të cilat sollën krizën energjitike shoqëruar me një rritje të paparashikueshme të çmimit të energjisë elektrike. Kjo krize ka patur pasojat e saj edhe në vendin tone, pasi çmimet e karburantit, energjisë elektrike, mallrave dhe shërbimeve janë rritur globalisht duke ulur aftësinë paguese

të konsumatorëve. Në sektorin UK në Shqipëri, rritja e çmimeve ka ndikuar në rritjen e kostove duke ndikuar kështu në përkeqësimin e treguesve financiarë të performancës.

Në metodologjinë e re të tarifave, kostot e pranuar operacionale janë rikonceptuar e paraqitur në mënyrë të detajuar dhe përbëhen nga: kostot e materialeve; kostot e shërbimeve nga jashtë; kosto për paga dhe sigurime; taksat; kosto të tjera. Pjesën më të madhe në totalin e kostove operacionale në sektor e përbëjnë kostot e punës dhe energjia elektrike, të cilat për shkak të ndryshimeve kanë dhënë ndikimin kryesor në uljen e mbulimit të kostove operative. Kosto e punës ka pësuar 2 herë rritje gjatë vitit, për shkak të ndryshimeve ligjore të pagës bazë minimale në shkallë vendi në periudhën prill 2022 dhe shtator 2022 (paga bazë minimale aplikohet nga të gjitha shoqëritë UK për disa pozicione). Kostot e energjisë elektrike dhe karburantit janë rritur në mënyrë të drejtpërdrejtë për shkak të krizës globale.

Metodologjia e re e tarifave i jep mundësinë shoqërive UK të kërkojnë ndryshimin e tarifës në rastet e ngjarjeve të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit dhe përgjegjësisë së tyre dhe që kanë efekt të konsiderueshëm në komponentët e miratuar tariforë. Shoqëritë UK brenda periudhës rregullatore me tarifa të miratuara nga ERRU mund të aplikojnë për tarifa të reja dhe të paraqesin ndryshimet në komponentët përkatës tarifor që janë ndikuar negativisht nga ngjarja e jashtëzakonshme (p.sh rritje e menjëhershme e inflacionit), ndërkohë që komponentët e tjerë nuk ndryshojnë.

Në çdo rast, ERRU duhet të zbatojë edhe kriterin e përbalueshmërisë dhe rritjes graduale të tarifave pasi kjo mund të ketë efekte negative në uljen e arkëtimeve.

III. Unifikimi Tarifor

Unifikimi tarifor është edhe një ndër sfidat kryesore me të cilën do të përballen shoqëritë UK Rajonale si rezultat i agregimit. Metodologjitë rregullatore të përcaktimit të tarifave përgjithësisht projektohen për tarifa të unifikuara, pasi format rregullatore sjellin struktura tarifore që priren të jenë uniformë, në mënyrë që të përmbushet parimi i mos diskriminimit dhe klientët me kosto më të larta shërbimi të ndër financohen nga klientë me kosto më të ulëta shërbimi.

Bashkimi i shoqërive UK me performancë të mirë me ato me cilësi të dobët shërbimi, pa kapacitete menaxhuese dhe në vështirësi financiare, pritet të sjellë zhvillim dhe rritje të performancës të sektorit UK, por që duhet të vijë gradualisht, duke qenë se periudha e bashkimit përkoi me periudhën e rritjes së çmimeve për shkak të krizës globale të energjisë, në të cilën kostot u rritën ndjeshëm.

Për disa nga shoqëritë e formuara rajonale, tarifat janë të përafërta nga zona në zonë, prandaj unifikimi tarifor është i mundshëm dhe ERRU do ta nxisë këtë proces meqenëse shoqëria është më e kontrollueshme dhe e monitorueshme sepse të dhënat për variablat i paraqet të përbashkëta.

Për disa shoqëri rajonale, unifikimi tarifor paraqet disa problematika duke qenë se diferencat e çmimeve të mbartura ndërmjet njësive ose zonave janë shumë të mëdha, për shkak të kostove mjaft të ndryshme të veprimtarisë, si edhe të cilësisë së shërbimit. Unifikimi i menjëhershëm i tarifave për këto shoqëri mund të sjellë një reagim të fortë nga konsumatorët që sjell më tej një ulje të normës së arkëtimit dhe ulje të aftësive likuiduese të shoqërisë. Duke qenë se, metodologjia ofron mundësinë e planifikimit tarifor me rritje graduale nga viti në vit, rekomandohet unifikimi i tyre në dy faza, fillimisht unifikim i zonave që kanë tarifë të përafërt dhe më pas gradualisht përafrimi i tarifave vit pas viti deri në unifikimin e plotë të tyre.

Përcaktimi i tarifave të diferencuara brenda zonës së shërbimit të një shoqërie rajonale UK kërkon nga ERRU trajtimin në mënyrë të veçantë për secilën nga zonat. Kjo nënkupton që, secila zonë duhet të ketë sistemet e veta të informacionit, të cilat do të trajtohen më vete në modelin e aplikimit dhe këto sisteme

të jenë të aksesueshme nga ERRU, me qëllim verifikimin e të gjitha të dhënave të paraqitura në aplikim. Kështu, nëse do të propozohen 2 tarifa variabël për furnizimin me ujë kjo do të thotë që shoqëria përveç sistemeve të informacionit KUN dhe ITUN të paraqitura më vete, duhet të mbajë edhe dy sisteme informacioni për furnizimin me ujë që paraqesin të dhënat për klientë, vëllimet, Opex, Capex dhe çdo të dhënë tjetër që lidhet me secilën zonë me vete.

Kjo mënyrë e paraqitjes së të dhënave është një kërkesë e detyrueshme nga ERRU, sepse tarifa e secilës zonë përcaktohet nga komponentët e vet tarifor dhe është e nevojshme për shkak të kontrollit të përvitshëm që ERRU do të bëjë ndaj komponentëve tarifor dhe jo vetëm, me qëllim përditësimin e tarifave çdo vit apo në fund të periudhës rregullatore.

Përfundime

- Shoqëritë UK Rajonale duhet të aplikojnë pranë ERRU-së me një plan të ri tarifor, i cili të synojë mbulimin e 100% të kostove O&M për të gjithë SKP, duke marrë në konsideratë uljen e kostove kryesore si kostoja e punës (ulja e numrit të punonjësve) dhe ulja e kostos së energjisë elektrike (rritja e efiçencës së energjisë, sistemet e pavarura alternative të rinovueshme).
- Shoqëritë duhet të synojnë rritjen e standardit/besueshmërisë së raportimit të të dhënave, duke realizuar sisteme të përbashkëta të informacionit si elementi kyç në përlllogaritjen e tarifave të reja që miratimi i tyre nga ERRU të mos penalizohet nga mekanizmi i vlerësimit në metodologjinë e re të tarifave (ndërthurja e cilësisë së informacionit, me korrigjime financiare në rast të mospërbushjes së kriterëve).
- Për disa Shoqëri të krijuara Rajonale ku unifikimi i tarifave për shkak të diferencave të mëdha ndërmjet zonave nuk është i mundur të realizohet menjëherë, në planin afatmesëm duhet të tentojnë unifikimin tarifor ndërmjet zonave përbërëse të SKP, duke pasur në konsideratë edhe unifikimin e nivelit të shërbimit të ofruar për të gjithë zonën.

6 Aneks: Të dhënat Kryesore të Sektorit

Aneks 1, Tabela 40. Situata e Gjendjes së Licencimit të Shoqërive UK – 2022 me ndarjen sipas reformës

Nr.	Ndarja e Shoqërive Rajonale	Shoqëritë UK Ekzistuese	Statuti i shoqërisë	Mbarimi i afatit të licencimit	Licencimi i Shoqërive UK ekzistuese/rajonale
1	Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a	Shkodër	Pa riorganizuar	27.12.2025	Me licencë
2		Fushë Arrëz		19.06.2023	Me licencë
3		Pukë		26.02.2023	Me licencë
4		Vau i Dejës		09.07.2023	Me licencë
5		Malësia e Madhe		29.12.2024	Me licencë
6	Shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a.	Kukës	Riorganizuar	19.10.2024	Me licencë
		Tropojë		31.05.2022	Pa licencë
		Has		19.08.2025	Me licencë
7	Shoqëria Rajonale UK Lezhë sh.a.*	Lezhë	Riorganizuar	01.12.2026	Me licencë
	Mirditë				
	Kurbin				
8	Shoqëria Rajonale UK Dibër sh.a	Dibër	Riorganizuar	04.07.2026	Me licencë
		Mat		19.08.2025	Me licencë
		Bulqizë		27.07.2024	Me licencë
		Klos			Pa licencë
9	Shoqëria Rajonale UK Durrës sh.a	Durrës	Riorganizuar	20.09.2025	Me licencë
		Krujë		08.07.2025	Me licencë
		Kavajë		05.09.2022	Pa licencë
		Rrogozhinë		29.03.2022	Pa licencë
10	Shoqëria Rajonale UK Tiranë sh.a	Tiranë	Pa riorganizuar	03.03.2023	Me licencë
11		Kamëz		27.02.2026	Me licencë
12		Vorë		10.11.2024	Me licencë
13	Shoqëria Rajonale UK Fier sh.a.	Fier	Riorganizuar	18.12.2023	Me licencë
		Patos		02.02.2021	Pa licencë
		Roskovec		10.11.2025	Me licencë
		Mallakastër		10.07.2023	Me licencë
14	Shoqëria Rajonale UK Lushnje sh.a.	Lushnje	Riorganizuar	03.03.2025	Me licencë
		Divjakë		02.04.2017	Pa licencë
15	Shoqëria Rajonale UK Elbasan sh.a.	Elbasan	Riorganizuar	27.10.2023	Me licencë
		Cërrik		10.11.2025	Me licencë
		Belsh		29.12.2024	Me licencë
		Librazhd - Prrerjas*		20.09.2025	Me licencë
		Gramsh		20.10.2025	Me licencë
		Peqin		30.05.2023	Me licencë
16	Shoqëria Rajonale UK Berat Sh.a.	Berat - Kuçovë	Riorganizuar	20.12.2025	Me licencë
		Ura Vajgurore		26.11.2024	Me licencë
		Polican		08.12.2025	Me licencë
		Skrapar		19.08.2025	Me licencë
17	Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a.*	Korçë	Riorganizuar	01.12.2024	Me licencë
		Devoll			
		Maliq			
		Kolonje			
		Pustec			
18	Shoqëria Rajonale UK Pogradec sh.a.	Pogradec	Riorganizuar	13.05.2025	Me licencë
		Librazhd – Prrerjas**		20.09.2025	Me licencë
19	Shoqëria Rajonale UK Gjirokastër sh.a.	Gjirokastër	Riorganizuar	13.05.2025	Me licencë
		Tepelene		10.11.2025	Me licencë
		Këlcyrë		27.02.2023	Me licencë
		Përmet		05.12.2022	Pa licencë
		Libohovë		01.03.2021	Në proces
		Dropull		05.09.2022	Pa licencë
		Memaliaj		20.12.2025	Me licencë
20	Shoqëria Rajonale UK Vlorë sh.a.	Vlorë	Pa riorganizuar	01.06.2026	Me licencë
21		Selenicë		08.07.2025	Me licencë
22		Himarë		19.09.2023	Me licencë
23	Shoqëria Rajonale UK Sarandë sh.a.	Sarandë	Riorganizuar	05.09.2022	Me licencë
		Finiq		31.05.2022	Me licencë
		Konispol		23.06.2026	Me licencë
		Delvine		19.08.2025	Me licencë

Burimi: ERRU

* Shoqëri të reja rajonale të licencuara sipas reformës në zbatim të VKM nr.302, datë 11.05.2022

** Shoqëria ekzistuese UK Librazhd – Prrerjas do të ndahet ndërmjet dy shoqërive Rajonale UK Elbasan dhe UK Pogradec, përkatësisht Bashkia Librazhd do të shërbehet nga shoqëria Rajonale UK Elbasan ndërsa Bashkia Prrerjas do të shërbehet nga shoqëria Rajonale UK Pogradec.

Aneksi 2, Tabela 41. Norma e Arkëtimit Korrente dhe e Përgjithshme, Vitet 2021-2022

Nr.	Aktiviteti	Shoqëritë	Norma e Arkëtimit Korrente		Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	
			Viti 2021	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2022
1	UK	Tiranë	79.71%	92.64%	89.37%	101.16%
2	UK	Durrës	76.36%	75.94%	90.17%	91.85%
3	UK	Vlorë	63.12%	66.49%	84.60%	91.29%
4	UK	Elbasan	68.28%	60.80%	120.24%	108.53%
5	UK	Fier	77.12%	74.07%	98.81%	95.02%
6	UK	Korçë	80.98%	85.16%	94.32%	97.62%
7	UK	Shkodër	68.01%	71.93%	87.98%	93.74%
8	UK	Berat Kuçovë	84.72%	92.56%	97.23%	111.36%
9	UK	Kavajë	74.86%	71.02%	113.64%	84.75%
10	UK	Kamëz	98.42%	67.70%	106.29%	95.04%
11	UK	Lushnje	84.15%	79.40%	92.49%	94.02%
12	UK	Sarandë	68.56%	52.71%	90.80%	90.48%
13	UK	Lezhë	91.68%	88.91%	93.89%	105.10%
14	UK	Pogradec	90.57%	91.48%	97.60%	98.09%
15	UK	Gjirokastër	71.03%	69.28%	91.91%	98.61%
16	UK	Dibër	65.85%	73.24%	82.19%	84.02%
17	UK	Maliq	91.66%	78.11%	100.10%	87.88%
18	UK	Devoll	67.59%	70.97%	96.08%	99.60%
19	UK	Cërrik	65.25%	57.39%	86.93%	83.38%
20	UK	Kurbin	67.35%	75.35%	77.36%	86.86%
21	UK	Belsh	72.25%	62.63%	102.88%	100.31%
22	UK	Kukës	50.47%	62.98%	76.70%	80.57%
23	UK	Librazhd	59.50%	83.98%	91.84%	87.81%
24	UK	Mat	88.85%	89.25%	100.28%	99.17%
25	UK	Divjakë	66.04%	72.59%	79.12%	107.59%
26	UK	Himarë	84.23%	86.87%	90.32%	105.82%
27	UK	Krujë	66.33%	40.61%	83.25%	75.19%
28	UK	Patos	79.28%	61.35%	96.61%	79.57%
29	UK	Malësi e Madhe	82.88%	76.11%	89.73%	89.24%
30	UK	Mallakastër	83.17%	81.46%	102.17%	97.03%
31	U	Gramsh	93.03%	95.43%	100.93%	104.34%
32	UK	Bulqizë	81.57%	84.87%	95.57%	99.98%
33	UK	Rrogozhinë	70.97%	68.71%	95.36%	104.25%
34	UK	Vorë	94.53%	94.19%	109.35%	109.12%
35	UK	Përmet	61.82%	73.70%	89.30%	87.04%
36	UK	Dropull	70.68%	76.07%	96.02%	97.95%
37	UK	Ura-Vajgurore	71.54%	66.99%	106.11%	102.76%
38	UK	Selenicë	60.33%	68.66%	60.93%	80.04%
39	UK	Kolonjë	75.62%	81.45%	76.16%	82.10%
40	UK	Skrapar	80.65%	83.49%	103.41%	97.53%
41	UK	Peqin	72.28%	79.85%	82.91%	93.94%
42	UK	Tropojë	65.37%	68.92%	71.33%	77.79%
43	UK	Roskovec	56.61%	70.02%	87.54%	81.39%
44	UK	Mirditë	85.36%	86.03%	100.77%	105.00%
45	UK	Delvinë	73.74%	80.13%	82.76%	83.11%
46	UK	Vau Dejës	62.79%	68.02%	100.08%	103.42%
47	UK	Tepelenë	55.99%	68.88%	94.35%	98.65%
48	UK	Poliçan	98.37%	88.68%	98.37%	96.14%
49	UK	Finiq	49.65%	48.32%	74.50%	73.18%
50	UK	Konispol	88.19%	77.34%	95.54%	93.77%
51	UK	Klos	62.23%	63.08%	79.55%	83.02%
52	U	Memaliaj	51.69%	69.77%	0.00%	91.44%
53	UK	Pukë	81.63%	82.39%	101.12%	96.29%
54	UK	Këlcyrë	65.04%	73.77%	94.82%	102.63%
55	UK	Has	54.86%	58.99%	85.90%	88.20%
56	UK	Libohovë	61.62%	57.92%	68.00%	63.27%
57	UK	Pustec	62.30%	64.94%	78.14%	76.85%
58	UK	Fushë Arrëz	77.60%	88.89%	86.45%	95.82%
		Totali	77.57%	81.44%	92.30%	97.29%

Burimi: ERU

Aneksi 3, Tabela 42. Rezultatet Financiare 2022 për Operatorët UK (000 Lekë)

Nr.	Aktiviteti	OPERATORËT	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	Kostot O&M	Kosto Totale	2022					Rezultati Financiar Vjetor 2022		
						Nevoja për Subvencione për mbulimin e kostove O&M	Në % Ndaj Totalit të kostove O&M	Subvencionet e marra 2022	Subvencionuar		Humbje	Fitim	Humbje në % ndaj Totalit
			1	2	3	4 (2-1)	5 (4/2)	6	7 (6-4)				
1	UK	Tiranë	4,060,248	2,608,025	3,489,790	-	0.0%	-	-	-	-	570,458	0.0%
2	UK	Durrës	1,232,016	2,221,437	2,477,952	989,420	44.5%	-	(989,420)	-	(1,245,936)	-	21.9%
3	UK	Vlorë	464,241	741,243	985,363	277,002	37.4%	-	(277,002)	-	(521,122)	-	9.2%
4	UK	Elbasan	358,976	531,419	675,006	172,443	32.4%	12,891	(159,552)	-	(316,030)	-	5.6%
5	UK	Fier	429,833	508,322	581,241	78,489	15.4%	-	(78,489)	-	(151,408)	-	2.7%
6	UK	Korçë	371,914	241,227	450,227	-	0.0%	30,000	-	30,000	(78,314)	-	1.4%
7	UK	Shkodër	281,493	450,269	721,674	168,776	37.5%	-	(168,776)	-	(440,181)	-	7.7%
8	UK	Berat-Kuqovë	256,624	183,682	275,313	-	0.0%	-	-	-	(18,689)	-	0.3%
9	UK	Kavajë	194,041	338,929	537,343	144,888	42.7%	17,815	(127,073)	-	(343,302)	-	6.0%
10	UK	Kamëz	280,104	421,681	974,727	141,577	33.6%	-	(141,577)	-	(694,623)	-	12.2%
11	UK	Lushnje	190,406	237,408	349,972	47,002	19.8%	15,056	(31,945)	-	(159,566)	-	2.8%
12	UK	Sarandë	247,568	245,087	344,709	-	0.0%	-	-	-	(97,141)	-	1.7%
13	UK	Lezhë	207,090	181,723	385,293	-	0.0%	-	-	-	(178,203)	-	3.1%
14	UK	Pogradec	168,360	163,224	347,288	-	0.0%	30,000	-	30,000	(178,927)	-	3.1%
Nëntotali			8,742,915	9,073,676	12,595,899	2,019,597	22.3%	105,762	(1,973,835)	60,000	(4,423,442)	570,458	78%
15	UK	Gjirokastrë	119,477	113,824	136,973	-	0.0%	3,342	-	3,342	(17,496)	-	0.3%
16	UK	Dibër	61,096	55,079	58,086	-	0.0%	14,724	-	14,724	-	3,010	0.0%
17	UK	Maliq	39,897	66,829	72,769	26,932	40.3%	-	(26,932)	-	(32,872)	-	0.6%
18	U	Devoll	38,605	41,158	45,331	2,553	6.2%	-	(2,553)	-	(6,726)	-	0.1%
19	UK	Cërrik	59,813	101,171	107,439	41,358	40.9%	3,838	(37,520)	-	(47,626)	-	0.8%
20	UK	Kurbini	43,273	128,149	170,041	84,876	66.2%	20,000	(64,876)	-	(126,768)	-	2.2%
21	UK	Belsh	44,379	93,808	99,368	49,429	52.7%	-	(49,429)	-	(54,989)	-	1.0%
22	UK	Kukës	61,054	56,306	86,319	-	0.0%	15,024	-	15,024	(25,265)	-	0.4%
23	UK	Librazhd	60,154	44,744	54,232	-	0.0%	-	-	-	-	5,922	0.0%
24	UK	Mat	41,387	44,297	55,307	2,910	6.6%	12,241	-	9,331	(13,920)	-	0.2%
25	U	Divjakë	26,833	64,138	66,725	37,305	58.2%	14,944	(22,361)	-	(39,892)	-	0.7%
26	UK	Himarë	50,781	44,572	58,180	-	0.0%	-	-	-	(7,399)	-	0.1%
27	UK	Krujë	53,334	76,269	84,381	22,936	30.1%	7,297	(15,639)	-	(31,048)	-	0.5%
28	UK	Patos	76,231	221,805	235,233	145,574	65.6%	30,000	(115,574)	-	(159,002)	-	2.8%
29	UK	Malësi e Madhe	50,466	47,358	67,214	-	0.0%	-	-	-	(16,748)	-	0.3%
30	UK	Mallakastër	47,558	101,178	121,111	53,620	53.0%	-	(53,620)	-	(73,553)	-	1.3%
31	U	Gramsh	34,003	48,637	57,744	14,634	30.1%	-	(14,634)	-	(23,741)	-	0.4%
32	UK	Bulqizë	41,697	48,733	56,430	7,036	14.4%	3,035	(4,001)	-	(14,733)	-	0.3%
33	UK	Rrogoshinë	24,490	41,796	43,435	17,306	41.4%	4,888	(12,418)	-	(18,945)	-	0.3%
34	UK	Vorë	63,056	84,767	88,001	21,711	25.6%	-	(21,711)	-	(24,945)	-	0.4%
35	UK	Përmet	47,232	52,921	69,282	5,689	10.8%	3,961	(1,728)	-	(22,050)	-	0.4%
36	UK	Dropull	17,325	27,480	41,591	10,155	37.0%	3,342	(6,813)	-	(24,266)	-	0.4%
37	UK	Ura Vajgurore	27,367	62,446	65,266	35,079	56.2%	4,945	(30,134)	-	(37,899)	-	0.7%
38	UK	Selenicë	36,005	46,161	47,512	10,156	22.0%	-	(10,156)	-	(11,507)	-	0.2%
39	UK	Ersekë	20,656	13,370	22,788	-	0.0%	-	-	-	(2,132)	-	0.0%
40	UK	Skrapar	23,706	40,130	42,385	16,424	40.9%	9,812	(6,612)	-	(18,678)	-	0.3%
41	UK	Peqin	50,683	111,610	125,850	60,927	54.6%	13,271	(47,656)	-	(75,167)	-	1.3%
42	UK	Tropojë	25,839	28,137	29,538	2,298	8.2%	6,961	-	4,663	(3,699)	-	0.1%
43	UK	Roskovec	32,096	39,150	73,211	7,054	18.0%	-	(7,054)	-	(41,115)	-	0.7%
44	UK	Mirditë	22,110	35,373	49,697	13,262	37.5%	10,000	(3,262)	-	(27,586)	-	0.5%
45	UK	Delvinë	24,280	30,476	72,285	6,196	20.3%	17,086	-	10,891	(48,005)	-	0.8%
Nëntotali			1,364,884	2,011,872	2,403,725	695,420	34.6%	198,710	(554,684)	57,974	(1,047,773)	8,933	18.4%
46	UK	Vau i Dejës	20,068	58,039	73,719	37,971	65.4%	-	(37,971)	-	(53,651)	-	0.9%
47	UK	Tepelena	23,569	34,719	40,118	11,150	32.1%	3,454	(7,696)	-	(16,549)	-	0.3%
48	UK	Poliçan	19,439	32,460	38,738	13,021	40.1%	15,243	-	2,222	(19,299)	-	0.3%
49	U	Finiq	20,273	20,703	23,547	429	2.1%	-	(429)	-	(3,274)	-	0.1%
50	U	Konispol	21,533	28,851	43,713	7,318	25.4%	12,914	-	5,596	(22,180)	-	0.4%
51	U	Klos	10,944	15,544	15,966	4,600	29.6%	-	(4,600)	-	(5,022)	-	0.1%
52	UK	Memaliaj	9,797	19,169	27,302	9,372	48.9%	3,707	(5,665)	-	(17,505)	-	0.3%
53	UK	Pukë	13,428	14,998	22,498	1,570	10.5%	-	(1,570)	-	(9,070)	-	0.2%
54	U	Këlcyrë	11,627	20,107	24,121	8,480	42.2%	5,235	(3,245)	-	(12,494)	-	0.2%
55	U	Has	10,805	26,868	40,444	16,063	59.8%	8,015	(8,048)	-	(29,639)	-	0.5%
56	U	Libohovë	11,677	20,044	21,411	8,367	41.7%	6,961	(1,406)	-	(9,735)	-	0.2%
57	UK	Pustec	4,065	8,901	9,131	4,836	54.3%	-	(4,836)	-	(5,066)	-	0.1%
58	UK	Fushë Arrëz	5,974	8,287	14,625	2,313	27.9%	-	(2,313)	-	(8,651)	-	0.2%
Nëntotali			183,199	308,689	395,333	125,490	40.7%	55,528	(77,781)	7,818	(212,134)	-	3.7%
TOTALI			10,290,998	11,394,237	15,394,956	2,840,507	24.9%	360,000	(2,606,299)	125,792	(5,683,349)	579,391	100%

Burimi: ERRU

Aneks 4, Tabela 43. Të ardhurat për Vitet 2021 dhe 2022

Nr.	Aktiviteti	Shoqëritë në Grupe sipas Numrit të Lidhjeve	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK		Diferenca (2022-2021)
			Viti 2021	Viti 2022	
1	UK	Tiranë	4,047,550	4,060,248	12,698
2	UK	Durrës	1,163,627	1,232,016	68,389
3	UK	Vlorë	449,509	464,241	14,732
4	UK	Elbasan	354,687	358,976	4,289
5	UK	Fier	405,344	429,833	24,489
6	UK	Korçë	362,040	371,914	9,874
7	UK	Shkodër	293,004	281,493	(11,511)
8	UK	Berat Kuçovë	261,949	256,624	(5,325)
9	UK	Kavajë	99,715	194,041	94,326
10	UK	Kamëz	252,960	280,104	27,144
11	UK	Lushnje	208,395	190,406	(17,989)
12	UK	Sarandë	226,315	247,568	21,253
13	UK	Lezhë	212,567	207,090	(5,477)
14	UK	Pogradec	170,865	168,360	(2,505)
Total Grupi I			8,508,528	8,742,915	234,387
15	UK	Gjirokastrë	112,596	119,477	6,881
16	UK	Dibër	56,726	61,096	4,370
17	UK	Maliq	42,660	39,897	(2,763)
18	UK	Devoll	39,614	38,605	(1,009)
19	UK	Cërrik	43,775	59,813	16,038
20	UK	Kurbín	40,441	43,273	2,832
21	UK	Belsh	46,658	44,379	(2,279)
22	UK	Kukës	51,420	61,054	9,634
23	UK	Librazhd	56,059	60,154	4,096
24	UK	Mat	46,742	41,387	(5,355)
25	UK	Divjakë	32,285	26,833	(5,452)
26	UK	Himarë	52,060	50,781	(1,279)
27	UK	Krujë	60,119	53,334	(6,785)
28	UK	Patos	53,636	76,231	22,595
29	UK	Malësi e Madhe	48,422	50,466	2,044
30	UK	Mallakastër	47,817	47,558	(259)
31	U	Gramsh	35,009	34,003	(1,006)
32	UK	Bulqizë	34,050	41,697	7,647
33	UK	Rrogozhinë	25,101	24,490	(611)
34	UK	Vorë	62,963	63,056	93
35	UK	Përmet	30,932	47,232	16,300
36	UK	Dropull	19,083	17,325	(1,758)
37	UK	Ura-Vajgurore	24,890	27,367	2,477
38	UK	Selenicë	32,834	36,005	3,172
39	UK	Kolonjë	23,861	20,656	(3,204)
40	UK	Skrapar	20,566	23,706	3,140
41	UK	Peqin	55,673	50,683	(4,990)
42	UK	Tropojë	26,683	25,839	(844)
43	UK	Roskovec	32,501	32,096	(405)
44	UK	Mirditë	20,153	22,110	1,957
45	UK	Delvinë	24,914	24,280	(634)
Total Grupi II			1,300,240	1,364,884	64,644
46	UK	Vau Dejës	20,505	20,068	(437)
47	UK	Tepelenë	22,630	23,569	939
48	UK	Poliçan	17,669	19,439	1,770
49	UK	Finiq	18,476	20,273	1,797
50	UK	Konispol	20,243	21,533	1,290
51	U	Klos	11,863	10,944	(918)
52	UK	Memaliaj	12,082	9,797	(2,286)
53	UK	Pukë	13,694	13,428	(266)
54	UK	Këlcyrë	10,724	11,627	903
55	U	Has	11,138	10,805	(333)
56	UK	Libohovë	11,708	11,677	(31)
57	UK	Pustec	4,257	4,065	(192)
58	UK	Fushë Arrëz	3,750	5,974	2,225
Total Grupi III			178,739	183,199	4,460
Totali			9,987,507	10,290,998	303,491

Burimi: ERRU

Aneks 5, Tabela 44. Tarifat Aktuale për Shërbimin e Furnizimit me Ujë dhe Largimin e Ujërave të Ndotura

Nr.	Lloji i Shoqërisë	Shoqëritë	Data e hyrjes në fuqi të vendimit	2022								
				Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm			Shërbimi i largimit të ujërave të ndotur			Tarifë fikse		
				Tarifë variabël			Tarifa variabël					
			Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat	
1	UK	Beish										
2	UK	Berat-Kuçovë	01.11.2019	50	130	130	14	24	24	100	200	200
	Nj. Administrative	Roshnik	01.11.2019	40	130	130	14	24	24	100	200	200
3	UK	Bulqizë	01.10.2022	25	75/55*	83.3	10	17	17	100	100	100
4	UK	Cërrik										
5	UK	Delvinë	01.05.2019	58	120	120	18	35	35	167	200	200
6	UK	Devoll	01.01.2012	38	100	110				50	50	50
7	UK	Dibër	01.01.2010	27	65	85						
8	Sha U	Divjakë										
9	UK	Dropull										
10	UK	Durrës	01.09.2017	70	120	130	50	60	60	150	150	150
11	UK	Elbasan	01.01.2023	40	130	130	9	30	30	200	400	400
12	UK	Fier	01.01.2021	52	105	125	13	18	20	200	200	200
13	UK	Finiq										
14	UK	Fushë Arrëz										
	UK	Gjirokastrë	01.04.2019	46	133	138	11	18	18	100	100	100
15	Nj. Administrative	Cepo, Antigonië, Lazarat, Lunxhëri, Odrje, Picar	01.04.2019	25	60	60	-	-	-	80	-	-
16	U	Gramsh	01.06.2018	32	90	90				60	150	180
17	U	Has										
18	UK	Himarë	01.12.2019	55	100	100	30	50	50	200	200	300
19	UK	Kamëz										
20	UK	Kavajë	01.07.2010	38	80	100	15	20	20			
21	U	Këlcyrë										
22	UK	Klos										
23	UK	Kolonjë	01.04.2015	38	100	110	10	13	18	100	100	100
	UK	Konispol										
24	Nj. Administrative	Konispol, Mursi, Vrine, Shëndëlli, Verve, Dishat, Markat, Ninat	01.10.2022	66.7	83.3	83.3						
	Nj. Administrative	Ciflik, Shkallë, Xarrë, Shales	01.10.2022	50	83.3	83.3						
	UK	Korçë	01.01.2018	72	117	140	42	64	64	140	140	140
	Nj. Administrative	Mollaj, Bulgarec	01.01.2018	38	110	100				100	100	100
25	Nj. Administrative	Voskop, Komuna Vithkuq, Bulgarec (të tjera)	01.01.2018	28	110	100				100	100	100
	Nj. Administrative	Drenovë	01.01.2018	28	110	100				100	100	100
	Nj. Administrative	Voskopojë	01.01.2018	28	110	100				100	100	100
26	UK	Krujë	01.12.2019	35	80	100	8	12	12	100	200	200
27	UK	Kukës	01.10.2022	30	80	100	10	20	30	50	100	100
28	UK	Kurbin	01.01.2011	30	80	120				50	50	50
29	UK	Lezhë	01.01.2014	58	135	145	18	22	27	200	200	200
30	UK	Libohovë										
	UK	Librazhd-Prenjas	01.12.2018	42	100	100	15	25	26	100	100	100
31	Nj. Administrative	Qukës, Rrajcë, Stravaj, Stebleve, Hotolisht, Lunik, Orenje, Polis, Qendër Librazhd	01.12.2018	26	60	60	-	-	-	100	100	100
	UK	Lushnje										
32	Nj. Administrative	Lushnje, Kolonjë, Fier-Shegan, Dushk	01.10.2019	62	130	130	17	21	24	100	200	200
	Nj. Administrative	Bubullime, Allkaj, Krutje, Golem, Ballagat, Hysgjokaj, Karbunarë	01.10.2019	62	110	110	17	21	24	100	100	100
33	UK	Malësi e Madhe	01.03.2018 01.08.2019	50	120	120	12	15	15	167	167	167
	UK	Maliq										
34	Nj. Administrative	Maliq, Libonik, Pojan, Vreshtas, Pirg (Zona Fushore)	01.03.2018	45	100	105				54/50 *	54/50 *	54/50 *
	Nj. Administrative	Maliq, Libonik, Pirg, Gore, Moglicë (Zona Malore)	01.03.2018	22.5	100	105				27	54	54
35	UK	Mallakastër	01.02.2022	50	100	120	10	10	10	100	200	200
36	UK	Mmat	01.01.2006	23	60	80	2	4	6			
37	UK	Mirditë	01.01.2012	30	100	115	10	15	15			
	Nj. Administrative	Rubik	01.10.2008	30	70	100	7	10	15			
38	UK	Patos	01.04.2021	70	135	135	20	20	20	200	200	200
39	UK	Peqin	01.12.2020	48	120	120	12	16	16	100	200	200
40	UK	Përmet	01.01.2013	40	110	120				100	100	200
	UK	Pogradec										
41	Nj. Administrative	Pogradec Buçimas	01.10.2020	60	111	111	30	40	40	200	300	300
	Nj. Administrative	Udenisht, Cerravë, Proptisht, Velçan, Trebinjë, Dardhas	01.10.2020	30	100	100	15	30	30	100	100	100
42	UK	Polçan	01.04.2019	50	100	110	12	15	15	100	100	100
43	UK	Pukë	01.01.2014	35	130	140	8	16	16	100	100	100
44	UK	Pustec										
45	UK	Roskovec	01.02.2020	52	105	125	15	20	20	100/50*	100/50*	100/50*
46	UK	Rrogozhinë	01.01.2013	48	90	100	10	12	12	50	100	100
47	UK	Sarandë	01.07.2021	60	140	140	25	45	45	200	200	200
48	UK	Selenicë	01.07.2010	30	80	100						
49	UK	Shkodër	01.01.2012	40	110	110	15	20	20	100	100	100
50	UK	Skrapar	01.06.2018	35	100	110	10	10	10	100	100	100
51	UK	Tepelenë	01.01.2014	33	100	120	12	20	20	90	400	250
52	UK	Tiranë	01.01.2018	65	140	155	11	30	35	200	200	200
	UK	Tropojë										
53	Nj. Administrative	Bajram Curri	01.08.2019	40	80	80	13	22	22	100	100	100
	Nj. Administrative	Bujan, Bytyc Fierzë, Llugaj, Margega, Tropojë, Lekbibaj	01.08.2019	30	80	80	-	-	-	100	100	100
54	UK	Ura Vajgurore	10.01.2007	40	90	100						
55	UK	Vau i Dejës	01.12.2018	42	120	120	7	20	20	83	167	167
56	UK	Vlorë	01.12.2019	45	100	100	15	25	25	100	150	150
57	UK	Vorë	01.02.2020	65	140	155	15	30	35	200	200	200

Burimi: ERRU

Shoqëritë që nuk kanë tarifa të miratuara nga ERRU
* Janë tarifa fikse të ndara për ujë dhe kanalizime

Aneks 6, Tabela 45. Performanca, Renditja e Përgjithshme, Viti 2022

Nr.	Shoqëritë	Renditja				
		Uji Pa të Ardhura	Mbulimi i O&M	Norma Korrente e Arkëtimit	Orët e FU	Mesatare
1	UK Korçë	3	3	12	1	4.75
2	UK Lezhë	10	6	7	2	6.25
3	UK Kolonjë	2	2	18	21	10.75
4	UK Pogradec	12	12	5	14	10.75
5	U Gramsh	13	30	1	4	12
6	UK Berat - Kuçovë	28	4	4	13	12.25
7	U Librazhd	25	5	14	5	12.25
8	UK Bulqizë	11	20	13	6	12.5
9	UK Devoll	9	15	35	3	15.5
10	UK Përmet	6	19	30	7	15.5
11	UK Poliçan	5	39	9	9	15.5
12	UK Fushë Arrëz	20	28	8	10	16.5
13	UK Tiranë	35	1	3	32	17.75
14	UK Konispol	1	26	23	25	18.75
15	UK Mat	27	16	6	28	19.25
16	UK Malësi e Madhe	19	10	24	27	20
17	UK Himarë	42	7	10	29	22
18	UK Delvinë	23	24	19	24	22.5
19	UK Tepelenë	4	32	40	22	24.5
20	UK Pukë	53	18	16	12	24.75
21	UK Dibër	22	8	31	39	25
22	UK Gjirokastrë	16	11	38	38	25.75
23	UK Mirditë	48	38	11	8	26.25
24	UK Maliq	15	40	22	31	27
25	UK Tropojë	30	17	39	26	28
26	UK Fier	49	21	28	15	28.25
27	UK Skrapar	26	42	15	33	29
28	UK Memaliaj	8	48	37	30	30.75
29	UK Kukës	24	9	49	43	31.25
30	UK Pustec	17	51	47	11	31.5
31	UK Vorë	47	27	2	51	31.75
32	UK Roskovec	14	22	36	56	32
33	UK Sarandë	21	13	56	41	32.75
34	UK Dropull	18	35	25	55	33.25
35	UK Shkodër	44	37	33	19	33.25
36	UK Lushnje	45	23	21	46	33.75
37	UK Peqin	40	52	20	23	33.75
38	UK Finiq	52	14	57	20	35.75
39	UK Mallakastër	33	50	17	44	36
40	UK Këlcyrë	56	45	29	18	37
41	UK Cërrik	38	41	55	16	37.5
42	U Belsh	7	49	50	50	39
43	U Klos	31	29	48	48	39
44	UK Kavajë	37	46	34	45	40.5
45	UK Libohovë	50	44	54	17	41.25
46	UK Durrës	57	47	26	37	41.75
47	UK Elbasan	46	33	52	36	41.75
48	UK Ura Vajgurore	29	53	45	42	42.25
49	UK Rrogozhinë	36	43	41	53	43.25
50	UK Vau i Dejës	39	56	43	35	43.25
51	U Selenicë	54	25	42	54	43.75
52	UK Divjakë	41	54	32	49	44
53	UK Patos	34	57	51	34	44
54	UK Vlorë	55	36	46	40	44.25
55	UK Krujë	43	31	58	47	44.75
56	UK Kamëz	51	34	44	57	46.5
57	UK Has	32	55	53	52	48
58	UK Kurbin	58	58	27	58	50.25

Burimi: ERRU

Aneks 7, Tabela 46. Performanca - Renditja Sipas III Grupeve të Shoqërive UK, Viti 2022

Nr.	Shoqëritë	Renditja				
		Uji Pa të Ardhura	Mbulimi i O&M	Norma Korrente e Arkëtimit	Orët e FU	Mesatare
1	UK Korçë	3	3	12	1	4.75
2	UK Lezhë	10	6	7	2	6.25
3	UK Pogradec	12	12	5	14	10.75
4	UK Berat - Kuçovë	28	4	4	13	12.25
5	UK Tiranë	35	1	3	32	17.75
6	UK Fier	49	21	28	15	28.25
7	UK Sarandë	21	13	56	41	32.75
8	UK Shkodër	44	37	33	19	33.25
9	UK Lushnje	45	23	21	46	33.75
10	UK Kavajë	37	46	34	45	40.5
11	UK Durrës	57	47	26	37	41.75
12	UK Elbasan	46	33	52	36	41.75
13	UK Vlorë	55	36	46	40	44.25
14	UK Kamëz	51	34	44	57	46.5
15	UK Kolonjë	2	2	18	21	10.75
16	U Gramsh	13	30	1	4	12
17	U Librazhd	25	5	14	5	12.25
18	UK Bulqizë	11	20	13	6	12.5
19	UK Devoll	9	15	35	3	15.5
20	UK Përmet	6	19	30	7	15.5
21	UK Mat	27	16	6	28	19.25
22	UK Malësi e Madhe	19	10	24	27	20
23	UK Himarë	42	7	10	29	22
24	UK Delvinë	23	24	19	24	22.5
25	UK Dibër	22	8	31	39	25
26	UK Gjirokastër	16	11	38	38	25.75
27	UK Mirditë	48	38	11	8	26.25
28	UK Maliq	15	40	22	31	27
29	UK Tropojë	30	17	39	26	28
30	UK Skrapar	26	42	15	33	29
31	UK Kukës	24	9	49	43	31.25
32	UK Vorë	47	27	2	51	31.75
33	UK Roskovec	14	22	36	56	32
34	UK Dropull	18	35	25	55	33.25
35	UK Peqin	40	52	20	23	33.75
